

Mbrojtja

Viti i 89-të i botimit
Shkurt 2021/ Nr. 2



Niko Peleshi në krye të Ministrisë së Mbrojtjes
Ministri Peleshi: Objektivi im,
një bazë ushtarake detare
e NATO-s në Pashaliman



Agjencia e NATO-s
Baza Ajrore e Kuçovës,
realizimi i projektit-afati
i fundit viti 2023



Gjeneralmajor Begaj-gjeneralmajor Federici
KFOR-i një aktor kyç në
sigurinë dhe ruajtjen e
paqes në Ballkan



Ministri Peleshi pret ambasadoren e SHBA në Tiranë Yuri Kim
Shqipëri-SHBA: Konfirmohen marrëdhëniet
e shkëlqyera në fushën e mbrojtjes

Përmbajtja

Numri 2

KONTINGJENTI I 8-TË EOD NISËT PËR LETONI

- 9** Ministri Peleshi: Kontingjenti ynë do të kontribuojë në mbrojtjen kolektive të Aleancës

“RESOLUTE SUPPORT MISSION”

- 10** Kontingjenti ushtarak nisët me mision në Camp Arena në Herat të Afganistanit

MINISTRI PELESHI AMBASADORJA BARSACQ

- 11** Ministri Peleshi: Mirënjohje Francës për modernizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë

ANALIZË

- 14** NATO dhe sfida 5G

HISTORI

- 48** Dëshmorët e ditës së parë të pushtimit dhe ditës së parë të LANÇ-it

STAFI

DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA
Hajrie DEDAJ

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:

Suela HODA



2 CEREMONIA

Ministri Peleshi: Objektivi im, një bazë ushtarake detare e NATO-s në Pashaliman

Pas dekretimit nga Presidenti i Republikës, njëkohësisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, zoti Ilir Meta, më datë 31 dhjetor 2020, pas miratimit nga...



6 PËRMBYTJET

Yuri Kim: Ne jemi krenarë që vazhdojmë të qëndrojmë krah për krah me ju

Forcat e Armatosura të Shqipërisë do të jenë më të mirëpajisura për të përballuar situatën e krijuar nga reshjet e shiut. Qeveria e SHBA-së...



8 TAKIMI

Shqipëri-SHBA: Konfirmohen marrëdhëniet e shkëlqyera në fushën e mbrojtjes

Marrëdhëniet e shkëlqyera në fushën e Mbrojtjes mes Shqipërisë dhe SHBA u konfirmuan edhe njëherë në takimin që ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi pati me...



10 BASHKËPUNIMI

Baza Ajrore e Kuçovës, realizimi i projektit-afati i fundit viti 2023

Dy vite më parë Aleanca e Atlantikut të Veriut miratoi vendimin për të ndërtuar në Shqipëri bazën e parë ajrore të Ballkanit Perëndimor...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja



Botues:
Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:
Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 89-të i botimit
Nr. 2/ 2021

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimsi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:
<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja>



Pas dekretimit nga Presidenti i Republikës, njëkohësisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, zoti Ilir Meta, më datë 31 dhjetor 2020, pas miratimit nga Parlamenti më datë 4 janar 2021 dhe betimit para Presidentit në mbrëmjen e datës 4 janar 2021, z. Niko Peleshi, ditën e martë më 5 janar 2021, është ulur në karrigen e ministrit të Mbrojtjes. Z. Niko Peleshi mori detyrën e ministrit të Mbrojtjes nga paraardhësja e tij znj. Olta Xhaçka, e cila do të shërbejë në detyrën e ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ministri i ri u prit ditën e martë, më 5 janar 2021, me ceremoni zyrtare nga Truproja e Nderit dhe Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura. Pas nderimit të Himnit të Flamurit, zonja Xhaçka falënderoi bashkëpunëtorët e saj gjatë drejtimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe vlerësoi reformat në vitet e fundit në Forcat e Armatosura. Nga ana e tij, ministri Peleshi vlerësoi kontributin e burrave dhe grave që shërbejnë në FA dhe bëri thirrje për të bashkuar forcat e të frymëzohemi nga e ardhmja evropiane e shqiptarëve, nga fëmijët tanë, për të çuar përpara misionin tonë për një Shqipëri të sigurt, demokratike e anëtare të denjë të BE-së. Në përfundim, zonja Xhaçka i prezantoi ministrit Peleshi drejtorët e Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe komandantët e Forcave të Armatosura.

Në fjalën e tij me marrjen e detyrës, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u shpreh se: "detyra e ministrit të Mbrojtjes është një përgjegjësi e veçantë ndaj atdheut tonë të dashur dhe popullit tonë". Ai në vijim tha se: "Të përmbushësh me nder këtë përgjegjësi do të thotë t'i kontribuosh paqes, sigurisë dhe mbrojtjes së pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit; do të thotë të mbrosh dhe promovosh lirinë, vlerat qytetare demokratike dhe rendin tonë kushtetues si edhe të përmbushësh gjithnjë e më tepër, gjithnjë e më mirë detyrimet dhe rolin tonë si vend aleat i NATO-s. Ndihem i obliguar të justifikoj besimin që më dha kryeministri e mazhoranca, duke e kryer këtë detyrë me devocion dhe atdhedashuri.

Ministri Peleshi: Objektivi im, një bazë ushtarake detare e NATO-s në Pashaliman

Në rrugëtimin tonë jemi përkrah aleatëve edhe unë dua të veçoj SHBA-në për ndihmën e vyer e të pakursyer që i japin Forcave tona të Armatosura

Përsëritës me mirënjohje të gjithë djemtë e vajzat, burrat e gratë në uniformë, që janë aset me i madh i Forcave të Armatosura. Viti i fundit ka qenë shumë i vështirë, por gjatë këtij viti sprove, që nga tërmeti e deri tek pandemia, ju keni ditur të tregoni që Forcat e Armatosura kanë sot një nivel profesionalizmi e modernizimi të admirueshëm, të denjë për një vend anëtar i NATO-s,

aleancës më të fuqishme politike e ushtarake në botë.

Dua t'ju bëj një përsëritje të veçantë, të gjithë atyre efektivëve, rreth 200, që sot shërbejnë në misionet e NATO dhe BE, nga Afganistani në Kosovë e Afrikë, duke kontribuar në garantimin e sigurisë kolektive. Ata janë prova më e mirë e progresit që kanë bërë FA. Ata janë edhe kartëvizita më e mirë me



të cilën Shqipëria prezantohet para aleatëve e partnerëve.

Sot përulëm me respektin më të madh para ushtarakëve, që dhanë jetën në krye të detyrës në misionet tona paqeruajtëse, si dhe i shpreh mirënjohjen më të veçantë familjarëve të tyre. Në rrugëtimin tonë jemi përkrah aleatëve edhe unë ashtu si Olta dua të veçoj SHBA-në për ndihmën e vyer e të pakursyer që i japin Forcave tona të Armatosura. Dua t'i garantoj aleatët e partnerët tanë, që Shqipëria do të vazhdojë të jetë jo thjesht një faktor stabiliteti në rajon, por edhe një eksportues sigurie duke marrë pjesë në operacione ushtarake e humanitare kudo ku NATO, por edhe OKB dhe BE do të kenë nevojë për angazhimin tonë.

Edukimi dhe trajnimi i FA duhet të marrë një vëmendje të veçantë ndaj dua të vlerësoj sot si një arritje të shkëlqyer të ministres dhe bashkëpunëtorëve të saj në këtë ministri, hapjen e Akademisë së Forcave të Armatosura. Angazhohem t'i jap gjithë mbështetjen time rritjes dhe konsolidimit të këtij institucioni unik të Arsimit të Lartë.

Fillimi së afërmi i punimeve për Bazën e Kuçovës është një ngjarje me rëndësi të veçantë strategjike, por edhe një sfidë e jashtëzakonshme, që do të kërkojë dedikim maksimal nga të gjithë ne. Jam gjithashtu në dijeni se ka filluar dialogu me NATO-n për Bazën e Pashalimanit. Ky projekt duhet ndjekur me këmbëngulje për ta kthyer në realitet.

Ngjitja e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile do të na bëjë më të aftë për të përmbushur

përgjegjësinë e shtuar të Mbrojtjes Civile duke u përgjigjur më mirë, në kohë e me profesionalizëm para emergjencave civile për të garantuar jetën, mirëqenien dhe pasurinë e shqiptarëve.

Ky dikaster ka një të veçantë, sepse është tashmë i integruar plotësisht në strukturat euroatlantike. Është një institucion, performanca dhe puna e të cilit matet me standardet e NATO-s. Është bërë një punë jo e vogël për të na afruar sa më shumë me këto standarde. Por kemi ende punë për të bërë. Le të bashkojmë forcat e të frymëzohemi nga e ardhmja evropiane e shqiptarëve, nga fëmijët tanë, për të çuar përpara misionin tonë për një Shqipëri të sigurt, demokratike e anëtare të denjë të BE-së”.

ME DORËN MBI KUSHTETUTË

Ministri Niko Peleshi betohet para Presidentit Ilir Meta

Më datë 4 Janar 2021, në Institucionin e Presidentit të Republikës u zhvillua pasdite ceremonia e betimit të z.Niko Peleshi, Ministër i Mbrojtjes. Pas ekzekutimit të himnit kombëtar, Ministri Peleshi u betuan me dorën mbi Kushtetutë para Kreut të Shtetit: “Betohem në nderin tim, se do të zbatoj me përpikëri Kushtetutën dhe ligjet, si dhe do të kryej me përgjegjësi detyrën shumë të rëndësishme që më është besuar, të anëtarit të Këshillit të Ministrave”. Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta i dorëzoi dekretin përkatës të emërimit ministrit Peleshi, duke i uruar suksese në detyrën e tij të re dhe të rëndësishme. Në ceremoninë e betimit ishin të pranishëm Sekretari i Përgjithshëm i kryeministrit, z.Engjëll Agaçi si dhe anëtarë të Kabinetit të Presidentit.

JETËSHKRIMI

Z. Niko Peleshi, prej datës 5 Janar 2021, mban funksionin e ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Niko Peleshi ka lindur në Korçë, më 11 nëntor 1970. Ka kryer studimet e larta për Inxhinieri Elektronike në Universitetin Politeknik të Tiranës me rezultate të shkëlqyera duke marrë titullin inxhinier elektronik.

Në vitin 1989 ka përfunduar Shkolllën e Mesme të Përgjithshme “Raqi Qirinxhi” në Korçë me medalje të artë. Z. Peleshi ka pasur një angazhim të gjatë në fushën e biznesit privat në qytetin e Korçës: në vitet 2001 - 2004 ka drejtuar me sukses Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Korçë. Karriera politike e z. Peleshi fillon në tetor të vitit 2004, kur emërohet prefekt i qarkut Korçë dhe e ushtron këtë funksion për një vit. Në vitin 2005, zgjidhet kryetar i Partisë Socialiste të qytetit të Korçës. Në zgjedhjet lokale të shkurtit 2007 zgjidhet kryetar bashkie i Korçës, për t'u rikonfirmuar edhe njëherë si kryetar bashkie në zgjedhjet lokale të vitit 2011. Prej vitit 2012 është anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste. Prej shtatorit të vitit 2013 z. Peleshi emërohet zëvendëskryeministër, pozicion të cilin e mban deri në maj 2017. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, ai zgjidhet deputet në qarkun e Korçës duke kryesuar listën e Partisë Socialiste. Shtator 2017-janar 2019 mban postin e ministrit të Bujqësisë. Në janar 2021 emërohet ministër i Mbrojtjes. Z. Peleshi zotëron shumë mirë gjuhën angleze, si dhe flet rrjedhshëm gjermanisht dhe greqisht. Ai është i martuar dhe ka tre fëmijë.



SHBA ndihmon FA për të përballuar përmbytjet

Yuri Kim: Ne jemi krenarë që vazhdojmë të qëndrojmë krah për krah me ju

Ndihma amerikane përfshin gomone, gjeneratorë, pajisje për heqjen e lagështisë dhe të ujit, thasë rëre, radio për komunikim në raste përmbytjesh, pajisje të ndihmës së shpejtë dhe ventilatorë të lëvizshëm

Forcat e Armatosura të Shqipërisë do të jenë më të mirëpajisura për të përballuar situatën e krijuar nga reshjet e shiut. Qeveria e SHBA-së dhuroi për FA pajisje të reja dhe moderne për përballimin sa më efikas të përmbytjeve.

Pajisjet e reja u dorëzuan ditën e enjte, më 14 janar 2021, nga ambasadorja e SHBA-së në Tiranë Yuri Kim, në prani të ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Bajram Begaj dhe komandantit të Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndrëçim Sallaku.

Ministri Peleshi falënderoi SHBA për donacionin e radhës dhe theksoi se këto pajisje të reja do të rrisin kapacitetet

reaguese të FA-së ndaj fatkeqësive natyrore. "Është një dhuratë e rëndësishme për ne dhe për qytetarët e Shqipërisë, të cilët janë duke u përballur me një situatë të vështirë, të krijuar nga reshjet intensive të shiut. Këto pajisje do të rrisin aftësitë e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Komandës Mbështetëse duke ndihmuar ekipet e kërkim-shpëtimit për t'iu përgjigjur në mënyrë më efektive një numri gjithnjë e më të madh emergjencash dhe gjithashtu do të ndihmojnë në mbrojtjen e jetës së personelit të Forcave të Armatosura, ndërsa ata vazhdojnë punën e tyre të rëndësishme, shpëtuese. Shpreh mirënjohjen dhe falënderimet e mia dhe të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, për Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e përher-





shme, bujare dhe të pakufizuar për Shqipërinë dhe Forcat e Armatosura.” - theksoi ministri Peleshi.

Ambasadorja e SHBA-së në vendin tonë Yuri Kim vlerësoi punën e FA shqiptare gjatë përmbytjeve dhe vlerësoi bashkëpunimin mes dy vendeve. Në fjalën e saj Ambasadorja Yuri Kim tha se: “Amerikanët dhe shqiptarët ndajnë së bashku shumë vlera dhe një nga më të thjeshtat, por edhe më e rëndësishmja është kjo: Miku njihet që është mik, në nevojë e në rrezik. Si miq, partnerë dhe aleatë të NATO-s, amerikanët dhe shqiptarët kanë qenë në krah të njëri-tjetrit, veçanërisht në kohë të vështira, si sot. Javët e fundit kemi parë reshje dramatike këtu në Shqipëri dhe kemi dëshmuar shkatërrimin që vjen prej këtyre reshjeve të mëdha të shiut. Rrugë dhe ndërtesa të dëmtuara, fusha dhe qytete të përmbytura, qytetarë në nevojë për evakuim. Ushtria shqiptare ka punuar gjatë gjithë kohës për të ofruar ndihmë urgjente dhe e ka bërë atë në mënyrë të admirueshme.

Sot, Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara dëshiron t’u dhurojë Forcave të Armatosura

të Shqipërisë pajisje për lehtësimin e pasojave të përmbytjeve. Që prej vitit 1999, Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara ka siguruar mbi 13 milionë dollarë ndihmë humanitare për Shqipërinë. Shumë



projekte domethënëse në të gjithë vendin, nga rinovimi i shkollave dhe klinikave mjekësore, te dhurimi i pajisjeve kritike të nevojshme për t’u përgjigjur tërmetejeve, zjarreve në pyje dhe përmbytjeve, janë dhurata nga populli i Amerikës për popullin e Shqipërisë dhe ato përfaqësojnë angazhimin e Shteteve të Bash-

kuara për aleatën tonë shqiptare të NATO-s. Ky dhurim i fundit i pajisjeve vjen në një kohë kritike dhe ne jemi të lumtur që artikujt e dhuruar sot do të vihen menjëherë në përdorim për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Kjo është ajo që aleatët bëjnë për njëri-tjetrin, ata qëndrojnë gati për të ndihmuar kur kjo u kërkohet. Në të njëjtën mënyrë Shqipëria i është përgjigjur vazhdimisht thirrjes nga Shtetet e Bashkuara, në të gjithë botën. Ne jemi krenarë që vazhdojmë të qëndrojmë krah për krah me ju.

Ndër të gjitha punët e rëndësishme në të cilat merr pjesë Ambasada e Shteteve të Bashkuara, këto projekte të ndihmës humanitare janë për mua ndër më shpërblyeset. Do të doja të falënderoja Komandën Evropiane të SHBA-së e cila, përmes Zyrës së Bashkëpunimit Ushtarak, punoi për përshpejtimin e këtij projekti. Në fund, do të doja të theksoja përkushtimin e personelit tonë shqiptar në Zyrën e Bashkëpunimit Ushtarak, të cilët krenohen shumë që mund t’i japin diçka mbrapsht vendit të tyre përmes këtyre përpjekjeve”. Pajisjet e reja

janë kryesisht materiale dhe pajisje kërkim-shpëtimi ujqor në raste emergjencash. Ndihma përfshin gomone, gjeneratorë, pajisje për heqjen e lagështisë dhe të ujit, thasë rëre, radio për komunikim në raste përmbytjesh, pajisje të ndihmës së shpejtë dhe ventilatorë të lëvizshëm.

Ministri Peleshi pret ambasadoren e SHBA në Tiranë Yuri Kim

Shqipëri-SHBA: Konfirmohen marrëdhëniet e shkëlqyera në fushën e mbrojtjes

Ambasadorja Kim:
“Defender Europe
2021”, me 6000
trupa amerikanë
është stërvitja më
e madhe ushtarake
e zhvilluar ndon-
jëherë në Shqipëri
së bashku edhe me
aleatë të tjerë të
NATO-s

Marrëdhëniet
e shkëlqyera
në fushën e
Mbrojtjes
mes Shq-
ipërisë dhe
SHBA u konfirmuan edhe
njëherë në takim që ministri
i Mbrojtjes Niko Peleshi pati
me ambasadoren amerikane
në vendin tonë Yuri Kim, më
11 janar 2021.

Ministri Peleshi dhe am-
basadorja Kim biseduan për të forcuar
dhe çuar përpara projektet madhore të
përbashkëta dhe fuqizimin e partneritetit
strategjik në fushën e Mbrojtjes dhe
Sigurisë.

Përzgjedhja e Shqipërisë për të
realizuar stërvitjen “Defender Europe
2021” ku mbi 6000 trupa amerikanë
do të kryejnë stërvitjen më të madhe
ndërkombëtare në Shqipëri, u cilësua nga
ministri Peleshi si një tjetër element që



tregon mbështetjen e SHBA në fuqizimin
dhe modernizimin e Forcave tona të Ar-
matosura.

Ambasadorja Kim rikonfirmoi rëndësi-
në e marrëdhënies dypalëshe në fushën
e Mbrojtjes dhe shprehu angazhimin e
saj për të rritur bashkëpunimin përpara
“Defender Europe 2021”, stërvitjes më
të madhe ushtarake të zhvilluar ndon-
jëherë në Shqipëri së bashku me Forcat
e Armatosura të SHBA dhe aleatë të
tjerë të NATO.





KONTINGJENTI I 8-TË EOD NISËT PËR LETONI

Ministri Peleshi: Kontingjenti ynë do të kontribuojë në mbrojtjen kolektive të Aleancës

Në mjediset e Batalionit të Xhenios (bXh) të Komandës Mbështetëse (KM) u zhvillua ditën e premte, më 8 janar 2021, ceremonia e nisjes së Kontingjentit të 8-të EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence - eFP) të NATO, si pjesë e grup-batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze të dislokuara në Letoni. Në ceremoninë e përcjelljes së kontingjentit të radhës mori pjesë edhe ministri i ri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili shoqërohej nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Bajram Begaj dhe komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndrçim Sallaku.

Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndrçim Sallaku, i cili i uroi mirëseardhjen ministrit të Mbrojtjes z. Niko Peleshi në bxh, si një nga repartet elitë të Komandës Mbështetëse e njëkohësisht dhe të Forcave të Armatosura. Gjatë fjalës së tij gjeneral brigade Sallaku theksoi edhe një herë vlerat dhe aftësitë e spikatura nga eksperiencat e mëparshme të këtij misioni dhe shprehu besimin se edhe ky angazhim do të përballohet me sukses, konform masave anti-COVID kësaj sfide botërore, për ti shërbyer



Grup-batalioni i NATO-s në Letoni përbëhet nga mbi njëmijë trupa nga Shqipëria, Kanadaja, Republika Çeke, Islanda, Italia, Mali i Zi, Polonia, Sllovakia, Sllovenia dhe Spanja

rritjes së aftësive ndërvepruese e bashkëpunuese sipas procedurave të NATO-s. Në fjalën e tij ministri Peleshi u shprehu kënaqësinë që takimin e parë me efektivet e FA-së e bëri me trupat, që do të shërbejnë në një mision ndërkombëtar.

Më tej, zoti Peleshi theksoi rolin e Shqipërisë si faktor stabiliteti dhe vlerësi përgatitjen dhe profesionalizmin e trupave shqiptarë për të shërbyer në misionet të tilla. "Republika e Shqipërisë në vijimësi ka dëshmuar se është jo vetëm faktor paqeje dhe stabiliteti rajonal e më gjerë, por edhe një aleat serioz, i cili merr përsipër dhe mban barrën e detyrimeve në kuadër të mbrojtjes kolektive të Aleancës. Jam i bindur se me përgatitjen, përkushtimin dhe profesionalizmin tuaj ju do të përmbushni me dinjitet dhe korrektesë të gjitha detyrat duke kontribuar në këtë mënyrë në suksesin e Aleancës." - u shpreh ai.

Ministri Peleshi nuk harroi të falënderojë mbështetësit kryesorë të kompanisë EOD dhe familjarët e efektiveve që u nisën në mision. "Një falënderim i veçantë shkon për ale-

atin tonë strategjik, SHBA-në, për kontributin dhe mbështetjen e vazhdueshme në ngritjen e kapacitetit të rëndësishëm të Pajisjeve dhe Municioneve Shpërthyes. Dëshiroj të falënderoj fëmijët, bashkëshortet, prindërit dhe familjarët tuaj për mbështetjen e përhershme dhe të pakursyer që ju kanë dhënë"- iu drejtua ai trupave të rreshtuar, të cilët i siguroi për mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes. Në përfundim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor Bajram Begaj i dorëzoi flamurin kombëtar komandantit të kontingjentit major Eduart Kaloshi.

Kontingjenti i 8-të EOD përbëhet nga 21 ushtarakë të mirëtrajnuar për asgjësimin e municioneve të rrezikshme dhe do të shërbejë për rreth 6 muaj në Camp Adazi.

Grup-batalioni i NATO-s në Letoni përbëhet nga mbi njëmijë trupa nga Shqipëria, Kanadaja, Republika Çeke, Islanda, Italia, Mali i Zi, Polonia, Sllovakia, Sllovenia dhe Spanja. Batalioni ka mision parandalimin dhe, nëse është e nevojshme, mbrojtjen e Letonisë nga çdo agresion i mundshëm.

Kontingjenti ushtarak nisët me mision në Camp Arena në Herat të Afganistanit

Peleshi: Shqipëria mbetet e vendosur për të përmbushur detyrimet e saj ndaj Aleancës dhe trupat tanë të gatshëm për të shërbyer kudo ku thirren



Një tjetër kontingjent i Policisë Ushtarake është nisur më 31 janar 2021, me mision në Camp Arena në Herat të Afganistanit. Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi iu ka uruar ushtarakëve mision të mbarë, ndërsa thekson se Shqipëria mbetet e vendosur për të përmbushur detyrimet e saj ndaj Aleancës.

“Kontingjenti i radhës që sapo përcollëm do të zëvendësojë kolegët e tyre të Policisë Ushtarake për të shërbyer në Camp Arena në Herat, në misionin Resolute Support. Shqipëria mbetet e vendosur për të përmbushur detyrimet e saj ndaj Aleancës dhe trupat tanë të gatshëm për të shërbyer kudo ku thirren”, shprehët ministri.



Forca Detare

Mbështetje për modernizimin e Forcës Detare

Praditen e datës 14 janar 2021, ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Bajram Begaj dhe anëtarë të kabinetit, zhvilloi një vizitë njohëse në Komandën e Forcës Detare. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me Forcën Detare, organizimin e saj, planet për zhvillim dhe problematikën kryesore me të cilat përballen shtabi dhe efektivet e kësaj force gjatë punës së përditshme.

Fillimisht ministri i Mbrojtjes, zoti Peleshi u prit nga komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia. Më tej ministri Peleshi u njoh nëpërmjet prezantimit më në detaje me strukturën organizative, misionin dhe detyrat e Forcës Detare. Ndër të tjera ministri i Mbrojtjes shprehu gatishmërinë për të vijuar mbështetjen në prioritetet dhe modernizimin e Forcës Detare.

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj dhe anëtarë të kabinetit, zhvilloi një vizitë njohëse në Komandën e Forcës Detare





MINISTRI PELESHI TAKON AMBASADOREN FRANCEZE ZNJ.ELISABETH BARSACQ

Ministri Peleshi: Mirënjohje Francës për modernizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë

Ministri i Mbrojtjes z.Niko Peleshi ka zhvilluar më 19 janar 2021, një takim miqësor me ambasadorën franceze në Shqipëri, Znj.Elisabeth Barsacq. "Mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme në modernizimin dhe edukimin e Forcave të Armatosura", shkruan ministri Peleshi, në facebook.

Franca ka luajtur rol të rëndësishëm në modernizimin e Forcave Ajrore Shqiptare. Një moment i veçantë është pajisja e Forcave Ajrore Shqiptare me helikopterin tip "Cougar" në versionin SAR, MEDEVAC dhe Transport Trupash. Marrëveshja, e cila konsistonte në blerjen e 5 helikopterëve transportues nga kompania franceze "Eurocopter", u firmos nga qeveria shqiptare në vitin 2009 dhe në vitin 2012 ka mbrtur në Rinas helikopteri i parë "Cougar" për të vazhduar me të tjerë. Në zbatim të kontratës për blerjen e helikopterëve modernë e shumëfunksionalë një zë i veçantë ishte edhe trajnimi i pilotëve dhe teknikëve shqiptarë që do të përdorin këtë teknikë.



Ministri i Mbrojtjes z.Niko Peleshi ka zhvilluar, një takim miqësor me ambasadorën franceze në Shqipëri, Znj.Elisabeth Barsacq



Duke folur për angazhimet e Francës në mbështetje të Shqipërisë, ambasadorja franceze, Znj. Elisabeth Barsacq, deklaroi në nëntor 2020 se: "Do të bëj ç'është e mundur që Shqipëria një ditë të jetë anëtare e BE-së. Dhe kjo është fare normale sepse Shqipëria është një vend evropian. Ky është një proces pune i cili po zhvillohet dhe Shqipëria i ka të gjitha mundësitë që një ditë të jetë anëtare e BE-së".

Ambasadorja Elisabeth Barsacq ka pak muaj në vendin tonë. Ajo ka dorëzuar më 27 tetor 2020 letrat

kredenciale pranë Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z.Illir Meta. Po kush është Elisabeth Barsacq, Ambasadorja e Francës në Shqipëri?

Elisabeth Barsacq është formuar si specialiste për Europën lindore dhe qendrore. Ajo është diplomuar në Institutin e studimeve politike të Parisit, diplomuar në studime të thelluara, ka diplomën e lartë nga Instituti kombëtar i gjuhëve dhe qytetërimeve lindore. Ajo ka punuar si diplomate në Poloni, Hungari, Turqi, Rusi dhe në Mongoli, por edhe si Përfaqësuese e Përhershme e Francës pranë Organizatës Detare Ndërkombëtare. Gjatë viteve të fundit, ajo ka qenë Konsulle e Përgjithshme në Shën-Petersburg, etj. Është ministre e plotfuqishme e klasit të parë. Ka marrë titullin Kalorëse e Legjionit të Nderit, Oficere e Urdhrit Kombëtar të Meritës, Medalje Nderi e Punëve të Jashtme (bronzi).

Baza Ajrore e Kuçovës, realizimi i projektit-afati i fundit viti 2023

Dy vite më parë Aleanca e Atlantikut të Veriut miratoi vendimin për të ndërtuar në Shqipëri bazën e parë ajrore të Ballkanit Perëndimor. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, tha, më 26 janar 2021, në intervistën për RTSH, se projekti i bazës ajrore të Kuçovës po jetësohet dhe do të jetë gati në fund të muajit tetor.

“Baza e Kuçovës është një projekt që tani po jetësohet. Deri në fund të marsit do të përfundojë prokurimi nga njësi prokurore e NATO-s dhe do të kontraktohet kompania apo kompanitë që do të zbatojnë projektin. Është një projekt “projekto dhe ndërto”, i cili parashikohet që deri nga fundi i tetorit të këtij viti ketë përfunduar dhe të nisë me shpresë implementimi i tij. Realizimi i projektit ka si afat të synuar fundin e vitit 2023. Nuk është më një ambicie.” - tha Peleshi.

Kësaj i ka paraprirë edhe baza ligjore. Kështu, më 22 tetor 2020, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar projektligjin “Marrëveshja për mbështetje teknike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s për realizimin e Projekteve të Kuçovës, të financuara nga Programi i Investimeve të NATO-s për Sigurinë, vitet 2019-2022”

Kjo bazë, ku do të investohen 50 milionë euro, e vendos Shqipërinë në hartën e interesave strategjike të NATO-s. Vendi merr një rëndësi strategjike që nuk e ka pasur më prej shumë e shumë dekadash. Ky është jo vetëm investimi më i madh, por edhe e vetmja bazë ajrore e NATO-s në rajonin tonë. Në terma ushtarakë, Baza e Kuçovës do të jetë një Bazë Taktike e Dislokueshme, që do të ketë të gjithë infrastrukturën dhe kapacitetet e nevojshme për

Deri në fund të marsit do të përfundojë prokurimi nga Agjencia e NATO-s për Mbështetje dhe Prokurime

të mbështetur 24 orë në 7 ditë të javës, misionet e NATO-s, qofshin këto misione stërvitore në kohë paqeje, apo misione luftarake në kohë krize. Më konkretisht baza do të mbështesë dislokimin e 6 avion-

ëve luftarakë taktikë dhe të avionëve të transportit. Funkcionimi i Bazës së Kuçovës do të ketë një ndikim të rëndësishëm përse i përket modernizimit dhe fuqizimit të Forcave Ajrore Shqiptare.

Interesi i kompanive të huaja ka qënë i lartë. Agjencia e NATO-s për Mbështetje dhe Prokurime, e cila realizon procedurat tenderuese, prezantoi në fillim të muajit dhjetor 2020, procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm, që duhet të



përmbushin firmat kontraktore, përpara se të aplikojnë për kryerjen e punimeve për modernizimin e Bazës së Kuçovës dhe kthimin e saj në Bazë Ajrore Taktike të NATO-s. Në këtë Konferencë morën pjesë pjesë pjesë 60 përfaqësues të kontraktorëve potencialë nga 36 kompani të ndryshme, nga të cilat 22 të huaja dhe 14 shqiptare.

Për rëndësinë e Bazës Ajrore të Kuçovës është shprehur edhe shtypi ndërkombëtar. Më 5 gusht 2018, gazeta prestigjioze amerikane "Washington Post", i ka dedikuar një artikull bazës ajrore që pritet të ndërtohet. "Baza ajrore ka qenë atje për dekada të tëra. Baza do t'i shërbejë Shqipërisë dhe gjithashtu do të mbështesë operacionet e furnizimit me ajër të NATO-s, mbështetjen e logjistikës, policinë ajrore dhe stërvitjet. Kryeministri tha gjithashtu se zyrtarët po diskutojnë me Shtetet Bashkuara mbi modernizimin e mëtejshëm të kapaciteteve ajrore shqiptare", shkruhet në artikullin e "Washington Post".

Baza Ajrore e Taktike e Kuçovës, do të shërbejë për trajnimin e personelit për operacione në një spektër të gjerë luftarak të imbar-kim-zbarkimit, kërkim-shpëtimit, emergjencave civile dhe atyre humanitare.



DO TË FILLOJNË INVESTIMET E NATO-S

Investimet e NATO-s largojnë turqit nga Baza Ajrore Kuçovë

Misioni i palës turke mbyllet sepse do të fillojnë punimet për rinovimin e Aeroportit të Kuçovës me investime të NATO-s

Në Bazën Ajrore Kuçovë në praninë e komandantit të bazës, major Arqile Olldashi dhe atasheut ushtarak të Republikës së Turqisë në vendin tonë, kolonel Muhammet Kelami Kablay si dhe oficerit koordinator të palës Turke në Bazën Ajrore Kuçovë e stafeve respektive, u zhvillua më 30 janar 2021, ceremonia e mbarimit të misionit të palës Turke nga Baza Ajrore Kuçovë.

Major Olldashi falënderoi kolonel Kablay për bashkëpunimin bi-



lateral të filluar qysh në vitin 2000 si dhe adresoi falënderimet e veçanta për palën turke për kontributin e dhënë për aerodromin dhe Bazën Ajrore Kuçovë. Ai theksoi se, misioni po mbyllet me mirëkuptimin e të dy palëve, për shkak të fillimit të punimeve për rinovimin e Aeroportit të Kuçovës me investime të NATO-s.

Komandanti i Bazës Ajrore theksoi gjithashtu se, në përfundim të këtyre punimeve dhe në varësi të nevojave që do të kemi, do të jemi të hapur përsëri për bashkëpunim bilateral në të ardhmen. Atasheu ushtarak turk vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm dhe u shpreh pozitivisht për bashkëpunimin edhe në të ardhmen. Më pas, me një solemnitet të ekipeve respektive u realizua ulja e flamurit turk nga kolonel Kablay duke vijuar kështu me dorëzimin e objektit, çelësave dhe dokumenteve përkatëse. Ceremonia u mbyll me foton e përbashkët përpara komandës së Bazës Ajrore Kuçovë.

Niko Peleshi: Situata nën kontroll, 1450 trupa ushtarake në gatishmëri

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është në bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha shtabet e ngritura nga pushteti vendor

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ka inspektuar më 9 janar 2021, që prej orëve të para të mëngjesit punën e bërë në zonat e prekura nga përmbytjet e fundit në Shkodër e Lezhë. Në Kallmet të Lezhës, ministri vuri në dukje përmirësimin e situatës krahasuar me një ditë më parë për shkak edhe të ndalimit të reshjeve, por edhe punës së mirë të bërë në këto vite nga institucionet.

"Kjo tërheqje e nivelit të ujit dhe ky përmirësim i situatës së përmbytjes duhet ta them që vjen nga puna e bërë shumë mirë në këto vitet e fundit për pastrimin e kanaleve ujitëse e kulluese. Pra, tërheqja e shpejtë e ujit, kur reshjet pushojnë tregon që këto investime funksionojnë dhe dua të përsëritës pushtetin vendor, bashkinë, kryetarin e bashkisë dhe prefektin që po punojnë shumë mirë.", - u shpreh ministri Peleshi, në një komunikim me medien lokale.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është në bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha shtabet e ngritura nga pushteti vendor për të parandaluar çdo situatë, që mund të krijohet edhe nga shtimi i reshjeve të cilat, siç tha ministri Peleshi, mund

të arrijnë pikun në datën 11 janar, në bazë të parashikimeve të IGJEU-M. Më pas, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ishte në Obot, ku tha se është bërë një menaxhim i mirë i kaskadës së Drinit, gjë që mund të parandalojë rëndimin e situatës. Në Njësinë Administrative Ana e Malit nuk ka tërheqje të ujit për shkak edhe të kushteve natyrore të zonës, por e rëndësishme, sipas ministrit është që nuk ka rrezik për jetët e njerëzve. "Dje kemi pasur dy-tre ngjarje evakuimi në Lezhë. Një në qytet dhe dy në zonat e përmbytura, zonë rurale. Edhe në

Shkodër kemi pasur disa evakuime. Kemi 260 trupa speciale vetëm nga FA, të specializuar në gatishmëri. Kemi mbi 1200 trupa të angazhuara. Kemi rritur gatishmërinë, kemi kaluar një nivel më lart, pra kemi dyfishuar gatishmërinë që para tre ditësh, gjithashtu në rast se flasim në nivel kombëtar të gjitha bashkitë kanë angazhuar dhe mobilizuar 1500 trupa të gatshëm", - deklaroi ministri i Mbrojtjes. Ministri informoi se edhe situata në jug të vendit është në kontroll dhe prurjet e lumit Vjosa janë në rënie që prej mëngjesit.



Lumi Erzen është tërhequr në shtratin e tij, por shumë shtëpi mbeten ende nën ujë në njësinë administrative Katund i Ri në bashkinë e Durrësit. Për të parë situatën nga afër, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ishte vetë ditën e mërkurë, më 27 janar 2021, në zonën e përmbytur, ku shoqërohej nga ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Milva Ekonomi dhe kryetarja e bashkisë së Durrësit Emiriana Sako. Ministri Peleshi bisedoi me banorët për situatën e krijuar dhe përgjegjësitë që duhet të marrë gjithësecili që këto ngjarje të mos përsëriten më. Zoti ministër takoi edhe efektivet e Forcave të Armatosura, të cilët prej 3 ditësh kanë ndihmuar në evakuimin e disa familjeve dhe transportin e tyre.

Ministri i Mbrojtjes konstatoi përmirësimin e situatës, siguroi gatishmërinë e FA dhe vuri theksin te mësimet që duhen nxjerrë me qëllim që reshjet e dendura dhe dalja nga shtrati i lumit Erzen të kenë sa më pak pasoja. "Le të themi e kemi kaluar pikun, situata sot është duke u përmirësuar, reshjet kanë mbaruar, uji po tërhiqet por ka ende familje nën ujë. Unë dua të falënderoj forcat tona të ushtrisë që kanë qenë në gatishmëri që ditën e parë, kanë evakuuar disa familje që janë strehuar në Konvalishencë, një pjesë tjetër te familjarët e tyre, një pjesë që nuk kanë pranuar të dalin, por që nuk kanë qenë në rrezik, sepse kur ka rrezik pranon apo nuk pranon familja evakuimi është i detyruar. Do vazhdojmë të jemi këtu në gatishmëri, ndonëse pritjet që dy ditët në vazhdim të ketë mot të mirë. Jemi të pajisur, kemi mjete kalueshmërie të lartë, kemi mjete të vogla lundruese, gjeneratorë dhe gjithçka tjetër që nevojitet, forca njerëzore, forcat e ushtrisë. Duhet thënë që, kur ka raste të tilla duhet të nxjerrim dhe mësim. Emergjencat kërkon një reagim multiinstitucional dhe të gjithë shoqërisë. Ajo që shohim këtu fillon nga zënia dhe



Ministri Peleshi në zonat e përmbytura në Durrës

FA janë në terren, por duhen nxjerrë mësim



FA është e angazhuar edhe në shpërndarjen e pakove ushqimore nga Rezervat e Shtetit për banorët e prekur nga përmbytjet

blokimi i kanaleve, shkarkimeve nga dinamika informale e ndërtimeve në vite, të cilës tani nuk i kthehemi më dot pas. Madje e kemi përballur me shumë guxim, me legalizime. Këtu procesi legalizimeve ka ecur mirë. Bashkë me legalizimin duhet të kemi vëmendje ndaj urbanizimit. Ne marrim detyra tona, komuniteti duhet të marrë detyrat e veta, kemi patur edhe debate me disa banorë, nuk mund t'i kërkojmë llogari bashkisë kur kanalin shkarkues e bllokoi për të bërë një copë rrugë." - u shpreh ai.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Milva Ekonomi kërkoi bashkëpunim nga banorët e zonës për të liruar dhe zhblokuar kanalet e niveleve të treta. Kryetarja e bashkisë së Durrësit Emiriana Sako

falënderoi Forcat e Armatosura për angazhimin në terren dhe njoftoi se me përmirësimin e situatës do të nisë edhe vlerësimi i dëmeve. Gjatë ditëve të fundit, Forcat e Armatosura kanë evakuuar disa familje në Katundin e Ri, një pjesë prej të cilave janë strehuar në Konvalishencën e Durrësit. Në Shkodër vijon prej tre javësh transporti i banorëve të Obotit, ndërkohë që ditën e djeshme janë evakuuar edhe disa krerë bagëti.

Gjithashtu, efektivet e FA me katër pompa të fuqishme thithëse, po ndihmojnë për shkarkimin e rezervuarit në fshatin Plan të bashkisë Tropojë. Nga ana tjetër, FA është e angazhuar edhe në shpërndarjen e pakove ushqimore nga Rezervat e Shtetit për banorët e prekur nga përmbytjet.

MINISTRI PELESHI NË KONVALESHENCË, DURRËS

Mjete dhe pako ushqimore nga rezervat e shtetit aty ku ka nevojë

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi deklaroi, të martën më 26 janar 2021, se do vazhdojë mbështetja e shtabeve të bashkive që kanë probleme me përmbytjet për shkak të reshjeve të dendura me të gjitha mjetet. Ministri Peleshi ishte te Konvaleshencia në Durrës ku janë strehuar disa nga familjet e evakuara. Në një prononcim për mediat, Peleshi tha se disa trupa nga Forcat e Armatosura ndodhen në mbështetje të Emergjencave në Sukth, Katundin e Ri në Shijak. "Fatmirësisht janë bërë në kohë evakuimet. Në fakt disa familje nuk kanë pranuar të evakohen, por duhet ta bëjnë patjetër sa herë marrin paralajmërime nga shtabet e bashkisë nga Shtabet e Emergjencave", -vijoi Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes theksoi se "jemi të gatshëm t'u gjendemi kujtdo qoftë për evakuime, apo për të shpëtuar prodhimet e ndryshme bujqësore apo gjënë e gjallë. Kemi disa qindra hektarë nën ujë, por lajmi i mirë është se reshjet kanë pushuar dhe nuk parashikohet të ketë reshje me intensitet të lartë në ditën në

vazhdim".

"Së bashku me shefin e Shtabit të Përgjithshëm, me drejtorin e Emergjencave Civile jemi në gatishmëri dhe në mbështetje nga veriu në jug. Në Tropojë kemi një situatë emergjente me një rezervuar, kemi dërguar katër pompa që në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe pushtetin lokal do të punojmë për të shmangur ndonjë situatë emergjente të mundshme. Kemi në Shkodër në Obot, në njësinë administrative Ana e Malit. Aty situata është më e rënduar pasi u bënë mbi 10 ditë që ka prezencë uji. Kemi çuar mjete të tjera të kalueshmërisë së lartë për të kryer lëvizjen, transportin e njerëzve. Edhe në Lezhë kemi toka të përm-

bytura por siç e thashë situata do të jetë më e mirë, pasi do të ketë tërheqje të përmbytjes dhe për pak ditë do shkojmë drejt normalizimit", -tha ai.

Po ashtu, Peleshi theksoi se ne do të vazhdojmë të mbështesim të gjitha shtabet e bashkive, të prefekturave me Forcat tona të Armatosura, me mjete dhe pako ushqimore nga rezervat e shtetit kudo që do ketë nevojë. "Po e shfrytëzoj këtë moment për t'iu kërkuar edhe kryetarëve të bashkive që janë në emergjencë edhe Prefektëve të mos ngurrojnë të na kontaktojnë në kohë, sepse i kemi gati, nuk na ka zënë të papërgatitur, por të përgatitur, edhe në këtë valë përmbytjesh", -tha Peleshi.



Komandanti i Batalionit në Vau të Dejës, Ali Mali

Në Obot kemi angazhuar tre mjete transporti dhe dy motobarka

Duke parë situatën në teren, ditë pas dite, ditën e hënë, më 11 janar 2021, intensiteti i reshjeve, pas tre ditësh është ulur, por sipërfaqe të mëdha toke në Shkodër ishin ende nën ujë. Prefektura e Qarkut raporton për 1 mijë e 893 hektarë tokë të përmytura. Niveli i lartë i ujit kishte bllokuar aksin Shirgj-Darragjat. Situata ishte përmirësuar në rrugën e Obotit, e cila gjithsesi ishte e kalueshme vetëm me mjete të larta.

Banorët e këtij fshati thonë se prodhimet bujqësore u janë dëmtuar. Problematikë mbeten rrjedha e lumit Drin dhe Kir, të cilët në disa vende po vazhdonin gërryerjen në tokat bujqësore, e po ashtu liqeni i Shkodrës që kishte rritje të nivelit të ujit dhe ndodhet pranë pikës maksimale. Por sipas shefit të Forcave të Armatosura, në Batalionin e Vaut të Dejës, Ali Mali, situata është nën kontroll.

“Në Obot kemi angazhuar tre mjete të transportit të kalueshmërisë së lartë dhe dy mjete me motobarka”, thotë shefi i Forcave të Armatosura, në Batalionin e Vaut të Dejës, Ali Mali. Në qarkun e Lezhës ishin 4300 hektarë tokë nën ujë. Problemi kryesor mbetet



rrëshqitja e dheut, sidomos në njësinë e Ungrejt. Për shkak të prezencës së ujit në banesa janë evakuuar 28 familje.

Probleme ka pasur edhe në Divjakë, pasi dalja e Shkumbinit përmyti mbi 50 ha tokë. Autoritetet u kanë bërë thirrje banorëve, që jetojnë përgjatë brigjeve të lumit, të largohen pasi prurjet janë të mëdha. Si rrjedhojë e shirave në shumë akse rrugore, si në zonën e Kukësit, Dibres, Burrelit ka pasur rrëshqitje të dherave duke krijuar

vështirësi në lëvizjen e automjeteve. Rruga Burrel-Tiranë u bllokua për 5 orë me radhë për shkak të rrëshqitjes së dherave në afërsi të Urës së Ulzës. Dibra po përballet edhe me ngricat që kanë shkaktuar probleme në disa zona. Ndërsa në Bashkinë e Durrësit situata është përmirësuar ndjeshëm. Tre njësitë administrative Sukth, Katund i Ri dhe Ishëm prej nga u raportua në ditët e para për 400 ha tokë të përmytur, ditën e hënë më 11 janar 2021, kishin mbetur nën ujë vetëm 100 hektarë.

Komanda Mbështetëse

Me mjete speciale në krye të detyrës nga Tropoja në Brataj të Vlorës

Efektivët e Komandës Mbështetëse me forca dhe mjete special vijojnë të jenë në krye të detyrës në këto ditë të reshjesh të pazakonta në Tropojë, Shkodër (Bogë dhe Dajc), Durrës, Korcë, Vlorë dhe Valias, në ndihmë të komunitetit të dëmtuar.

Më konkretisht, batalioni Mështetjes Rajonale Rajonale (BMR) vijon punën në Shkodër me hapjen e segmentit rrugor Bogë-Theth nga dëbora. Gjithashtu, në Njësinë Administrative Dajc dhe Ana e Malit nga BMR është nisur me mjetet barka dhe gomone për evakuimin e banorëve të mbetur të bllokuar nga përmytjet.

Në drejtim të Luzhës, Tropojë, BMR po punohet për thithjen e shkarkimin e rezervuarit të zonës, i cili rrezikon përmytjen e fshatit.

Ndërkohë në Durrës mbështetja për banorët e Shijakut të cilët janë bllokuar nga përmytjet ka filluar me evakuimin me barka të 30 personave. BMR vijon të qëndrojë në gatishmëri në këtë zonë. Nga depot e Rezervave të Shtetit në Lundër, Tiranë, Efektivët e BMR ka vijuar mbështetjen për komunitetin me paketim dhe nëpërmjet batalionit të Transportit janë dërguar një sasi e konsiderueshme pakosh ushqimore në drejtim të Shijakut dhe Durrësit për familjet e prekura nga përmytjet.

bytjet.

Gjithashtu, DMR Korcë me mjetin borëpastruese ndodhen në gatishmëri në mbështetje të kësaj prefekturë për zhblokumin e akseve rrugore nga dëbora.

Nga ana tjetër, forcat xhenjere ndodhen në mbështetje të komunitetit në Vlorë, në Njësinë Administrative Brataj, për thërmimin e masivit shkëmbor rënë si pasojë e rrëshqitjes së dherave, ndërsa një pjesë e efektivit ndodhet në dispozicion të IKMT-së për prishjen e kontrolluar të një objekti 5-katësh. Efektivët e Komandës Mbështetëse ndodhen në gatishmëri për tu përgjigjur cdo situatë të krijuar nga reshjet.

Që prej datës 8 janar efektive dhe mjete të Forcës Tokësore dhe Komandës Mbështetëse vazhdojnë të jenë të angazhuar në zonat e prekura nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet e dendura që vijnë të bien. Të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura vazhdojnë të jenë në gatishmëri të plotë për përballimin e kësaj situatë duke vënë në dispozicion trupa dhe mjete të kalueshmërisë së lartë në shërbim të autoriteteve të pushtetit vendor dhe lokal me qëllim transportin e materialeve dhe evakuimin e personave të prekur nga përmbytjet si dhe shpërndarjen e materialeve ushqimore/veshmbathje dhe hapjen e rrugëve të bllokuara nga rrëshqitjet e dheut dhe dëborës.

Më konkretisht Forcat e Armatosura po operojnë në: Bajram Curr, Shkodër, Lezhë, Pukë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë

Përmbytjet: 445 trupa dhe 143 mjete të angazhuara në terren



dhe Vlorë ku në total janë angazhuar 445 trupa dhe 143 mjete. Përveç trupave të angazhuara drejtpërdrejt në operacion, trupa të tjera qëndrojnë në gatishmëri në reparte për t'iu përgjigjur çdo situatë. Strukturat e Forcave të Armatosura vazhdojnë

të mbajnë nën monitorim të vazhdueshëm situatën, në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor dhe me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me qëllim marrjen e masave të nevojshme në kohën më të shkurtër dhe eliminimin e pasojave

Xhenierët e Komandës Mbështetëse

Në shtratin e lumit Mat, në afërsi të Klosit u konstatua e paplasur një predhë mortaje. Ishte një banor i zonës i cili e pikasi dhe menjëherë njoftoi policinë e cila shkoi në vendin e ngjarjes. Predha ishte e mbështjellë me një leckë, ndërsa rezultoi që të ishte në të edhe djegorja e cila rrezikonte shpërthimin.

Policia dhe strukturat Vendore të Mbrojtjes Civile në Klos njoftuan menjëherë Ministrinë e Mbrojtjes, e cila dërgoi një grup të repartit të xhenios. Me të mbërritur në vendin e ngjarjes forcat xheniere kanë bërë edhe një krehje tjetër të zonës ku kanë konstatuar edhe dy predha të tjera. Ata bënë shpërthim të kontrolluar duke shmangur rrezikun për banorët. Përgjegjësi i Zyrës së Mbrojtjes Civile në Bashkinë Klos, Nerim Dema ju bëri apel banorëve që zbresin në shtratin e lumit Mat, të bëjnë kujdes, pasi mund të ketë

Predha luftarake në lumin Mat, bëhet shpërthimi i kontrolluar



edhe predha të tjera.

Predhat dyshohet se mund të jenë mbetje nga tunelet e municioneve luftarake tek ish pazari i vjetër, tunele të cilat janë çer-

tifikuar të pastra në vitin 2017. Por nuk përjashtohet mundësia që ato të jenë hedhur nga banorë të cilët në vitin 1997 morën municione luftarake nga këto tunele.

Xhenierët ndërtojnë dy ura “bailey” në Memaliaj dhe Pukë

Në Arrëz të Madhe në Mamaliaj ndërtohet ura “bailey”, 15 metër e gjatë me peshëmbajtje mbi 40 ton dhe në bashkinë e Pukës ura “bailey”, me gjatësi 9 metër

Viti i ri i gjeti me dy ura të reja banorët e disa fshatrave në Memaliaj dhe Pukë. Forcat e Armatosura ndërtuan dy ura tip “bailey”, të cilat lehtësojnë ndjeshëm lëvizjen e njerëzve dhe mjeteve. Në bashkinë Memaliaj, xhenierët e Komandës Mbështetëse ndërtuan një urë 15 m të gjatë dhe me peshëmbajtje mbi 40 ton në fshatin Arrëz e Madhe të njësisë administrative Luftinjë. Ura në këtë fshat lidh fshatrat Arrëz e Madhe, Arrëz e Vogël, Buz, Maricaj, dhe Vagalat me qendrën shëndetësore, shkollën 9-vjeçare, si dhe me rrugën nacionale dhe bashkinë Memaliaj.

Ura e dytë tip “bailey” e ndërtuar në bashkinë e Pukës, është e gjatë 9 metër, por ka një rëndësi shumë të madhe për zonën. Pas dëmeve të shkaktuara në infrastrukturën rurale nga përmytjet e ditëve të fundit, efektivet e Batalionit të Xhenios (BXh) janë angazhuar për rindërtimin e tre urave në Lezhë dhe Krujë.

Xhenierët kryen rikonicionin e urës së Kalivaçit në Lezhë, e cila u dëmtua rëndë si pasojë e rrëshqitjes së dheut nga reshjet e dendura. Ura është e gjatë 21 m dhe e një rëndësie vitale për komunitetin pasi lidh rreth 1500 banorë të zonës. Ura lidh fshatrat Kalivaç, Ungrej, Kashnjet dhe Vig me pesë shkolla 9-vjeçare. Një tjetër rikonicion është bërë në urën mbi lumin Drroj në fshatin Brret në bashkinë e Krujës. Ura ekzistuese ka pësuar zhytje në njërin nga këmbët e mesit, dhe parashikohet ndërtimi i një ure tip bailey 21m të gjatë mbi bazamentin ekzistues. Kjo urë lidh rreth 500 banorë të zonës përreth.

Po në bashkinë e Krujës, u bë edhe rikonicioni i urës mbi lumin Tërkuzë, ku pasi të betonohen këmbët e urës, parashikohet të ndërtohet një urë tip “bailey” 27 m e gjatë.

Kjo urë ka një rëndësi të madhe pasi lidh Niklën me fshatin Rinas dhe Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” dhe do të shërbejë gjithashtu si rrugë nacionale.



Komanda Mbështetëse në zonat e përmytura

Xhenierët po punojnë për ndërtimin e urës në Kalivaç-Lezhë



Xhenierët e Komandës Mbështetëse nisën menjëherë punën për ndërtimin e urës së Kalivaçit në bashkinë e Lezhës. Ura u shemb nga prurjet e shumta të ditëve të fundit duke izoluar rreth 1500 banorë të fshatrave Kalivaç, Ungrej, Kashnjet, Vig e Kastër. Menjëherë pas mbushjes së krahut të dëmtuar, xhenierët e FA kanë filluar montimin e urës tip bailey. Ura do të jetë 21m e gjatë dhe veç të tjerash, frekuentohet nga nxënësit e 5 shkollave 9-vjeçare në zonë.

Xhenierët hapin rrugën Golem-Picar, bllokuar nga rrëshqitja e dheut

Si pasojë e reshjeve të tepërta të stinës, efektivët xhenierë të Komandës Mbështetëse, prej më shumë se një javë, kanë marrë detyrën për hapjen e segmentit rrugor Golem-Picar në bashkinë e Gjirokastrës, të bllokuar totalisht nga rrëshqitjet e dheut.

Më konkretisht, xhenierët e KM-së me mjetet e tyre speciale kanë punuar intensivisht për hapjen e aksit rrugor Golem-Picar (prej 7,3 km) dhe kanë bërë të mundur përfundimin e operacionit, me rezultat hapjen e qarkullimit për këtë aks e kthimin në normalitet të lëvizjes së automjeteve e popullsisë së zonës.

Punimet u inspektuan nga ministri i Brendshëm z. Blendi Çuçi, prefekti i qarkut Gjirokastrë, kryetari i bashkisë dhe kryetari i njësisë administrative Picar, të cilët falënderuan Ministrinë e Mbrojtjes për mbështetjen dhe lavdëruan efektivët për punën e palodhur, në kohë e me cilësi. Në këto kushte të vështira atmosferike, efektivët e Komandës



Mbështetëse, me forcat e mjetet në dispozicion, janë vënë në gatishmëri për të ndërhyrë në çdo rast nevojë,

kur pushteti lokal nuk e përballon me kapacitetet e veta, në rast emergjencash civile.

Anijet e Rojës Bregdetare

Mbrëmjen e datës 8 janar, Forca Detare (Rojë Bregdetare) u informua për një gomone me 55 emigrantë, midis tyre gra dhe fëmijë, në grykëderdhjen e lumit Vjosë, e cila ishte në rrezik mbytjeje. Pas vlerësimit të informacionit dhe situatës, Forca Detare koordinoi punën për realizimin e operacionit të kërkim-shpëtimit dhe menjëherë në vendngjarje u dërguan dy anije të Flotës Detare. Operacioni për bllokimin e mjetit lundrues dhe evakuimin e personave në bord, u krye në kushte të vështira atmosferike dhe me det me forcë mbi 5 ball. Personat në bord u evakuuan nga dy anijet luftarake të Rojës Bregdetare dhe u transportuan në drejtim të Triportit të Vlorës dhe ju dorëzuan autoriteteve të policisë së shtetit, ku një pjesë e tyre u dërguan në

Operacion në grykëderdhjen e Vjosës, shpëtohen 55 emigrantë



spitalin rajonal të Vlorës për trajtim shëndetësor. Strukturat hetimore të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë dhe ato të Policisë Kufitare, nën drejtimin e Prokurorisë, po vi-

jojnë veprimet për zbardhjen e plotë të kësaj tentative për kontrabandim të emigrantëve në rrugë detare dhe vënien para drejtësisë të personave përgjegjës.

Gjeneralmajor Begaj: FA është e angazhuar në misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës

Shefat e Shtabeve të vendeve të Aleancës u “mblodhën” virtualisht ditën e mercurit, më 27 janar 2021, në sesionin e 185-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s, në nivel shefash shtabi të përgjithshëm të vendeve anëtare të NATO. Takimi u hap nga z. Jens Stoltenberg, sekretari i Përgjithshëm i NATO, ndërsa seancat u drejtuan nga Air Chief Marshal Sir Stuart Peach, kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s, mbështetur nga komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë (SACEUR), gjeneral Tod Wolters dhe komandanti Suprem i Aleancës për Transformimin (SACT), gjeneral André Lanata.

“NATO duhet të qëndrojë e përgatitur me qëllim përballimin e sfidave të cilat rrjedhin nga një ambient sigurie i paparashikueshëm në shkallë botërore dhe konkurrues midis vendeve” - theksoi z. Stoltenberg. Gjithashtu, sekretari i Përgjithshëm i NATO vlerësoi rolin e Forcave të Armatosura për mënjanimin e transformimit të krizës shëndetësore në një krizë të sigurisë globale. COVID 19 nga ana tjetër nuk i ka eliminuar sfidat e sigurisë që Aleanca dhe vendet anëtare janë duke u përballur, ndaj roli i NATO mbetet i rëndësishëm në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në zonën euroatlantike e me gjerë.

Gjatë axhendës një ditore, shefat e shtabi të përgjithshëm të vendeve të NATO diskutuan për një sërë çështjesh që lidhen me angazhimet operacionale aktuale të NATO: misioni “Resolute Support” në Afganistan; misionin e NATO në Irak, misionin e KFOR në Kosovë, për konceptin e Shkurajimit dhe Mbrojtjes të hapësirës euroatlantike, konceptin e luftimit “CAPSTONE”, planeve në përgjigje të krizës shëndetësore të



Komiteti Ushtarak i NATO në nivel shefash shtabi të përgjithshëm mblidhet dy herë në vit në Shtabin e NATO në Bruksel



krijuar nga pandemia COVID - 19. Njëzëri të gjithë shefat rikonfirmuar qëndrimin e vendeve anëtare për vijueshmërinë e mbështetjes për misionet dhe operacionet në bazë të vendimmarrjeve politike.

Gjeneralmajor, Begaj rikonfirmoi vijimin e kontributeve të Shqipërisë në misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës. Në veçanti vlerësoi misionin e NATO në Kosovë

si suksesin më të madh të NATO, që prej krijimit të saj, në fushën e operacioneve. Komiteti Ushtarak i NATO në nivel shefash shtabi të përgjithshëm mblidhet dy herë në vit në Shtabin e NATO në Bruksel dhe, një takim me rotacion, një herë në vit në një nga vendet anëtare të Aleancës. Takimi i radhës do të jetë në Greqi në shtator 2021.



KFOR-i një aktor kyç në sigurinë dhe ruajtjen e paqes në Ballkan

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici, zhvilloi ditën e martë, më 12 janar 2021, një vizitë zyrtare në vendin tonë në kuadër të bashkëpunimit të FARSH-it me Komandën e KFOR-it, ku u prit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-it, gjeneralmajor Bajram Begaj.

Gjatë fjalës së tij në takim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-it, pasi uroi gjeneralmajor Federicin për marrjen e Komandës së KFOR-it, në nëntor të vitit të kaluar, shprehu bindjen se me eksperiencën e tij në NATO, BE dhe Kombet e Bashkuara, ai do të jetë një vlerë e shtuar për misionin e KFOR-it. Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj shprehu mirënjohjen ndaj burrave dhe grave nën uniformë që shërbejnë në KFOR, ku edhe Shqipëria është pjesë e këtij misioni. Nga ana e tij, gjeneralmajor Federici vlerësoi maksimalisht performancën e personelit ushtarak shqiptar që shërbejnë në KFOR.

Në takim u vlerësua roli i KFOR-it si një ndër aktorët kyç në sigurinë dhe ruajtjen e paqes në rajonin e Ballkanit. Të dy liderët ushtarakë ndanë të njëjtat vlerësime dhe qasje mbi sfidat aktuale të sigurisë me të cilat përballet rajoni duke u fokusuar në impaktin e krijuar ndaj aktivitetit të forcave ushtarake nga kriza e pandemisë. Gjeneralmajor Begaj informoi komandantin e KFOR-it se, pavarësisht pandemisë, FARSH kanë mbajtur gatishmërinë e tyre operacionale duke kontribuar në përballimin e pandemisë krahas institucioneve të tjera kombëtare.

Në përfundim të dy bashkëbiseduesit theksuan rolin e NATO-s në përballimin e sfidave si dhe forcimin e bashkëpunimit mes FARSH-it dhe KFOR-it edhe në të ardhmen. Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici, u prit dhe zhvilloi një takim kortezie edhe me ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi.

Gjeneralmajor Bajram Begaj dhe gjeneralmajor Franco Federici theksuan rolin e NATO-s në përballimin e sfidave si dhe forcimin e bashkëpunimit mes FARSH-it dhe KFOR-it edhe në të ardhmen



Gjeneral brigade Albert Mullai

Përgatitja e oficerit të shtabit në funksion të misionit të FA

Vetëm një ushtarak i mirë arsimuar dhe i qartë në atë se çfarë do të arrijë në të ardhmen do të çojë përpara standardet e kërkuara

Me datë 15 janar 2021 në ambientet e auditoriumit të Garnizonit "Skënderbej" u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të KTHOSH. Kursi filloi në shkurt 2020 dhe përfundoi janar të 2021. Për shkak të pandemisë u ndërpre për një periudhë kohore. Programi mësimor u realizua me sukses në kushtet e zhvillimit të mësimin on line.

Në ceremoni morën pjesë Komandanti i AFA Gjeneral brigade Albert Mullai, drejtorët e drejtorive, pedagogë dhe kursantët e KTHOSH-it.



Në fjalën e tij, Komandanti i AFA Gjeneral brigade Albert Mullai ndër të tjera tha; "Përgatitja e oficerit të shtabit të batalionit për përmbushjen e kërkesave të drejtimit, koordinimit, planëzimit dhe stërvitjes në nivel taktik do të shërbejë rritjes tuaj profesionale për realizimin e detyrave në përmbushje të misionit që kanë Forcat e Armatosura. Vetëm një ushtarak i mirë arsimuar dhe i qartë në

atë se çfarë do të arrijë në të ardhmen do të çojë përpara standardet e kërkuara. Komunikimin, bashkëpunimin që keni arritur të ndërtoni me njëri tjetrin mos e ndërprisni, vetëm kështu ju do të arrini nivelet më të larta të karrierës ushtarake". Në përfundim të ceremonisë u bë shpërndarja e certifikatave për kursantët që përfunduan KTHOSH-in.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj mori pjesë në analizat vjetore të zhvilluara nga komandat e forcave dhe njësite kryesore mbi punën e bërë nga ana e tyre gjatë vitit 2020. Analizat u zhvilluan ditën e mërkurë, më 6 janar 2021, nëpërmjet platformave online në kuadër të masave anti-COVID 19.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm vlerësoi punën e bërë nga komandat e Forcës Tokësore, Detare dhe Ajrore, Komanda Mbështetëse, Akademia e Forcave të Armatosura dhe njësitë autonome, duke theksuar faktin se edhe pse ishte një vit i vështirë i kushtëzuar nga pandemia, FARSH ia dolën të realizojnë me sukses objektivat e vëna për vitin 2020.

Përveç përmbushjes së misionit kushtetues dhe ligjor, gjatë vitit 2020 Forcat e Armatosura luajtën një rol të rëndësishëm krahas institucioneve të tjera shtetërore në përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 si dhe në zbatimin e planit të masave kundër pandemisë. Gjithashtu, ato përmbushën me sukses detyrat në mbështetje të misioneve të NATO-s, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara dhe iniciativave rajonale e koalicioneve ndërkombëtare. Flamuri shqiptar është valëvitur me krenari në Afganistan, Kosovë, Bosnjë Hercegovinë, Letoni e deri në Sudanin e Jugut.

Gjithashtu, gjeneralmajor prof. asoc. Begaj u njoh me analizën e problematikës kryesore të hasur nga komandat gjatë kryerjes së detyrave, mësimet e nxjerra, si dhe objektivat dhe prioritetet e planëzuara për rritjen e kapaciteteve operacionale për vitin 2021. Gjeneralmajor Begaj vuri theksin në stërvitjen shumëkombëshe "Defender 21", e cila do të jetë një ndër stërvitjet më të mëdha të realizuara ndonjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo stërvitje do të jetë një platformë ideale për rritjen e ndërveprueshmërisë si dhe testimin e kapaciteteve operacionale të njësite kryesore të FA. Në përfundim të analizave, shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj i uroi komandave suksese të mëtejshme për realizimin e objektiveve për vitin 2021.

Stërvitja "Defender 21", ndër më të mëdhatë e realizuara në Shqipëri



Zhvillohet analizat vjetore mbi punën e bërë nga komandat dhe njësitë kryesore të FARSH për vitin 2020



Gjeneral brigade Arben Kingji takon efektive të Forcës Tokësore

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi takim njohës me të efektivin oficer, nëntoger, toger, kapiten që shërbejnë në repartet dhe nënrepartet e Forcës Tokësore. Komandanti i FT uroi të gjithë pjesëmarrësve një vit sa më të mbarë për ta dhe familjet e tyre. Gjatë këtyre takimeve u trajtuan temat mbi disiplinën, stërvitjen, kujdesin ndaj efektivit që drejtojnë, si dhe problematikat që hasin në lidhje me punën e tyre të përditshme.



Në përfundim gjeneral brigade Kingji theksoi: "Ju si oficerë do të përballenit çdo ditë me sfida të reja dhe të vjetra. E rëndësishme është të mësoni nga gabimet, të tregoheni korrekt dhe gjithmonë drejtoni me shembull personal, stërvitini vartësit tuaj, kujdesuni për ata, ruani integritetin, mirëmbani pajisjet dhe vetë zhvillohuni profesionalisht."

Zhvillohet stërvitja komplekse 72 orëshe e kursit XVII “Komando”

Pjesë e programit është marshimi në këmbë me të gjitha pajimet personale në distancën 25 kilometra dhe sigurimi i ushqimit në natyrë (mbijetesa)

Më datë 28 janar 2021, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji i shoqëruar nga komandanti i batalionit “Komando” kolonel Edmond Doda ka inspektuar nga afër kryerjen e stërvitjes komplekse 72 orëshe të kursit të XVII-të “Komando”. Kjo stërvitje u realizua në poligonin kombëtar të Bizës dhe është një nga pjesët më të vështira të kursit “Komando” pasi ka në programin e saj marshim në këmbë me të gjitha pajimet personale në distancat 25 kilometra dhe sigurimin e ushqimit në natyrë (mbijetesa).

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji gjatë inspektimit nga afër të kësaj stërvitjeje përgëzoi efektivin e Instrukturëve për nivelin e lartë të përgjegjësisë dhe seriozitetit të kryerjes së këtij kursi si dhe falënderoj kursantët e kursit të XVII-të “Komando” për vendosmërinë dhe shpirtin e sakrificës që ata po tregojnë. Çdo gjë është e mundur kur ka frymë grupi dhe një objektiv të qartë për tu arritur. “Unë shpresoj që periudha që ju po kaloni gjatë kësaj



stërvitje, t'ju shërbejë për tu rritur edhe më tepër profesionalisht, për të treguar se kur punojmë së bashku çdo gjë është e mundur. Por, besoj gjithashtu që ju do të vazhdoni të rriteni edhe më tepër nga ana profesionale, kur të përfundoni me sukses kursin “Komando” dhe të merrni beretën e kaltër” - tha ai.

Stërvitja komplekse 72 orëshe

e kursit “Komando” kishte për qëllim testimin e aftësive ekstreme fizike dhe psikike duke i bërë të aftë kursantët të përshatën me mjedisin që i rrethon për të kryer me sukses çdo detyrë luftarake që mund t'i ngarkohet.

Gjatë kësaj stërvitje u kryhen këto tema: marrshim në

këmbë, taktikat e njëjësive të vogla, alpinizëm, prita, goditje objekti, luftim i afërt, mbijetesa, traversa topografike. E veçanta e kësaj stërvitje është se përveçse ngarkesës së madhe fizike dhe psikologjike janë zbatuar me sukses edhe të gjitha masat e rrepta mbrojtëse nga COVID-19.

Në mjediset e Batalionit Komando

Stërvitje 3 mujore: Përfundon Kursi XVII-të “Komando”

Me 8 janar 2021, në mjediset e Batalionit Komando, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit XVII Komando. Në këtë ceremoni morën pjesë: komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, atashu ushtarak i Republikës së Kosovës kolonel Bashkim Shillova, shefi i Shtabit të Forcës Tokësore kolonel Ilirjan Dauti, komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel David Rroku si dhe komandantë të reparteve varëse të Forcës Tokësore. Aktiviteti nisi me demonstrime stërvitore, ku të ftuarit patën rastin të shikonin veprimet e kursantëve të këtij kursi të ndarë në disa stacione si: mbijetesa, prita, reagimi i Skuadrës Komando në patrullimin në kontakt

me kundërshtarin, çlirim pengjesh, goditje objekti, qitje precizioni, si dhe luftim trup me trup.

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, në fjalën e tij përshëndetëse përgëzoi të sapocertifikuarit për mbylljen me sukses të këtij kursi, kaq të rëndësishëm në karrierën e tyre ushtarake. “Me përfundimin e këtij kursi nuk do të thotë, që përfundon dhe ambicia juaj në këtë rrugë që keni zgjedhur. Nga ju kërkohet vazhdimisht ruajtja, përmirësimi dhe rritja e vazhdueshme e standardeve nëpërmjet dëshirës për vetëzhvil-

lim profesional dhe mbi të gjitha disiplinës në kryerjen e detyrës që ju ngarkohet në këtë profesion sa sfidues, aq dhe fisnik”, - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Kingji.

Kursi XVII Komando zgjati 3 muaj, ku për herë të parë në këtë kurs morën pjesë 14 efektivë nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Pas betimit “Komando”, ceremonia u mbyll me ndarjen e certifikatave të përfundimit të kursit për kursantët dhe instruktorët në shenjë falënderimi për kontributin dhe punën mjaft të mirë të bërë për realizimin me sukses të Kursit XVII Komando.

Bashkëpunim për kërkim-shpëtimin

QKKSH, strukturë kryesore e menaxhimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit

Qëllimi i aktivitetit ishte bashkëpunimi dhe koordinimi me strukturat ushtarake, entet shtetërore dhe ato private, të cilat disponojnë kapacitete SAR, njohja e përgjegjësive dhe detyrimeve nga ana e tyre.

VAIT GOLIKJA
Specialist për Operacionet SAR

Direktiva e Mbrojtjes 2021: Të forcohet roli i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit (QKKSH) si struktura kryesore e menaxhimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit dhe ndërveprimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit në përputhje me kërkesat e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit.

Udhëzimi i SHSHPFA nr 01, datë 1.11.2021: Gjatë vitit 2021, të planëzohet stërvitje për rritjen e aftësive operacionale të strukturave prioritare operacionale dhe mbështetëse, strukturave të cilat mund të angazhohen në operacionet aktuale kombëtare (Kërkim - Shpëtim; Emergjencat Civile/ Fatkeqësi Natyrore...)

Në zbatim të Planit të Koordinimit dhe Bashkëpunimit të QKKSH me strukturat e FA-së, institucionet shtetërore, pushtetin vendor dhe entet private për kërkim-shpëtim, një ekip i QKKSH-së, i kryesuar nga kolonel Fiqiri Hoxha, me detyrë kryetar i QKKSH-së, zhvilluan një aktivitet koordinimi dhe bashkëpunimi në fushën e kërkim-shpëtimit me Forcën Detare, QNOD, Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe Policinë Kufitare e të Migracionit në Durrës.

Qëllimi i aktivitetit ishte bashkëpunimi dhe koordinimi me strukturat ushtarake, entet shtetërore dhe ato private, të cilat disponojnë kapacitete SAR, njohja e përgjegjësive dhe detyrimeve nga ana e tyre, si dhe marrja e masave për përmirësimin e bashkëpunimit për përdorimin e strukturave operacionale të përbashkëta në përgjigje të situatave dhe zhvillimin e operacioneve SAR.

Në kuadër të aktivitetit u zhvilluan 2



takime, në ambientet e KFD-së dhe QNOD-së. Në KFD ekipi i QKKSH-së u takua me Komandantin e FD-së, general brigade Ilir Xhebexhia dhe shtabin e KFD-së, ndërsa në QNOD ekipi u takua me drejtorin e QNOD-së, zotin Petrit Boduni, përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare Durrës zotin Tomor Harizi, përfaqësuesit e Policisë Kufitare dhe Migracionit, zotërinjtë, Drejtues Ndue Doçi, drejtor i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës si dhe Kryekomisar Kastriot Lemnusha me detyrë koordinator i PKM-së në QNOD.

Nga QKKSH-ja në të dy takimet u prezantua shërbimi i kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit ku u ndalua te baza ligjore e shërbimit SAR në RSH, institucionet përgjegjëse, zonat e përgjegjësive, misioni/detyra dhe struktura e QKKSH-së, stërvitja dhe trajnimi i efektivëve, si dhe detyrimet e palëve për zbatimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit dhe Planit të Veprimit të tij.

Në takime u vu re një frymë bashkëpunimi dhe kohezioni për të zbatuar legjislacionin në fuqi dhe koordinuar më mirë në operacionet SAR në terren. Takimet shërbyen për të diskutuar dhe problematika në lidhje me qartësinë "kush bën çfarë" dhe njëkohësisht detyrimet e përbashkëta për të zbatuar Planin Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit dhe Planin e Veprimit të tij.

Me mjaft interes ishin diskutimet rreth masave të Planit të Veprimit për zbatimin e Planit Kombëtar dhe përfshirja e tyre në planëzimin vjetor të këtyre institucioneve duke marrë masa konkrete për zbatimin e tyre.

Diskutime dhe konsulta u bënë për përgatitjen e marrëveshjeve dypalëshe me këto institucione dhe përcaktimi i detyrimeve reciproke në kuadër të zhvillimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit në det.

Në takime u diskutua edhe për përgatitjen dhe miratimin e një VKM-je për procedurën dhe masën e kompensimit të mjeteve private

kur ato përdoren për qëllime të kërkim-shpëtimit.

Në përfundim u bë shkëmbimi i ndërsjellë i të dhënave të përditësuara për pikat e kontaktit dhe për koordinimin e veprimeve në rast emergjencash SAR.

Gjatë takimeve u evidentuan dhe u theksua fort rritja e rolit të Qendrës Kombëtare e Kërkim Shpëtimit, si struktura kryesore e menaxhimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe kjo më e theksuar tek strukturat e pushtetit vendor. Në këtë kuadër u kërkua rritja e mëtejshme e bashkëpunimit me këto institucione.

Gjithashtu me prioritet u diskutua njohja dhe zbatimi në praktikë i Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit, si dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij. Në FD ka filluar një punë e mirë për zberthimin e tij,

planëzimin e realizimin e detyrimeve që ka kjo forcë për shërbimin e kërkim shpëtimit në det.

Në takim u ngrit si problem nevoja e rishikimit të akteve ligjore e nënligjore për shërbimin e kërkim-shpëtimit, pasi ka disa paqartësi dhe dublime kompetencash, misionesh dhe detyrash. Aktet ligjore e nënligjore për QKKSH, Rojën Bregdetare dhe QNOD duhet të harmonizohen dhe për këtë duhet të punojnë grupe pune të përbashkëta.

Nga diskutimet në QNOD doli e nevojshme hapja e një numri të gjelbër telefonik për shërbimin e kërkim-shpëtimit, ashtu siç është për emergjencat civile, emergjencat detare, emergjencat shëndetësore, zjarrfikëset etj, me të cilat edhe në ramë dakord dhe do të fillojmë procedurat për çeljen dhe



publikimin e këtij numri.

Mjaft të domosdoshme diskutantët vlerësuan edhe zhvillimin e një stërvitje kombëtare SAR, me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve shtetërore ushtarake dhe civile përgjegjëse për shërbimin e kërkim-shpëtimit. Kjo stërvitje të planëzohet e drejtohet nga Koordinatori Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit.

Nga diskutimet doli se duhet të zhvillohen aktivitete bashkëpunimi me vendet fqinje si vizita familjarizuese, trajnime e stërvitje të përbashkëta. Në përfundim të aktivitetit palët ranë dakord për një bashkëpunim të mëtejshëm në përmbushje të misionit dhe detyrave të përbashkëta.



Qendra Stërvitore e Forcës Ajrore Kuçovë

Teknikë helikopteri: Përfundon kursin bazë të nënoficerit, faza e dytë

Më 8 janar 2021, në mjediset e Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore, të dislokuar në Kuçovë u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit bazë të nënoficerit, faza e dytë, në specialitetin "Forcë Ajrore".

Në këtë aktivitet mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj, shefi i Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore major Ervin Demo, komandanti i Bazës Ajrore Kuçovë major Arqile Olldashi, kursantët e sapo certifikuar si dhe stafi e instruktorët e kësaj qendre.

Kolonel Ylli Pulaj, në fjalën e tij përshëndetëse përgëzoi nënoficerët për seriozitetin e përkushtimin e treguar gjatë kësaj faze arsimimi duke theksuar se, ky

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, Kolonel Ylli Pulaj merr pjesë në ceremoninë e përfundimit të Kursit Bazë të Nënoficerit, në Qendrën Stërvitore të Forcës Ajrore Kuçovë

kurs institucional është i rëndësishëm jo vetëm për konkurrimin e promovimin në gradën e tetarit, por gjithashtu përmirëson dijet profesionale të nënoficerëve të Forcës Ajrore, që do të shërbejnë si teknikë helikopteri si edhe hap rrugën për ndjekjen e kurseve të tjera funksionale, të cilat vlejné për një karrierë më të gjatë e të merituar në Forcën Ajrore.

Më pas zëvendëskomandanti adresoi një falënderim për drejtuesit dhe instruktorët e Qendrës Stërvitore të cilët zhvilluan me sukses

programin e këtij kursi duke bërë të mundur pajisjen me njohuri të përgjithshme e të specialitetit të nënoficerëve të Forcës Ajrore.

Kolonel Pulaj në përfundim të fjalës përshëndetëse, uroi një vit të mbarë duke inkurajuar stafin dhe nënoficerët të punojnë me optimizëm për realizimin e objektivave dhe përballimin e sfidave të përbashkëta. Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët me kursantët, zëvendëskomandantin e Forcës Ajrore dhe stafin e Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore Kuçovë.

Me kadetët e bachelor-it dhe kursantët e KPO-së, rihapet viti online

Pas tetë javëve stërvitjeje intensive në QAPU Bunavi, më 12 janar 2021 janë rikthyer në AFA kadetët e bachelor-it dhe kursantët e KPO-së. Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtrisë (QAPU) Bunavi, në zbatim të urdhrave të Rektorit të Akademisë së Forcave të Armatosura "Për fillimin e studimeve në programin bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura" dhe urdhrin "Për Zhvillimin e Kursit të Përgatitjes së Oficerit të Ri", për periudhën 2 nëntor deri më 24 dhjetor 2020 u zhvillua mësim me grupet në përputhje me modulet e miratuara për fazën/semestrin e parë 2.11.2020-15.01.2021. Në total në programin bachelor vazhdojnë ndjekjen e programit 58 studentë. Në KPO vazhdojnë ndjekjen e programit 62 kadetë. Me rastin e rihapjes së vitit të ri akademik, Komandanti i AFA-së Gjeneral brigade Albert Mullai duke iu uruar mirëseardhjen në ambientet e AFA-së, vlerësoi punën e bërë nga i gjithë personeli, pedagog, komandues, mbështetës, studentët e

Pas tetë javëve stërvitjeje intensive në QAPU Bunavi, më 12 janar 2021 janë rikthyer në AFA kadetët e bachelor-it dhe kursantët e KPO-së



bachelor-it dhe kursantët e KPO-së në realizimin me sukses të programit mësimor në QAPU Bunavi. "Edhe pse kushtet janë të kufizuara në respektim të masave anti-Covid, jeni ju që do të bëni të gjallërohen auditorët dhe sheshi i AFA-së, me

lejoni t'ju uroj suksese dhe shëndet të plotë në familjet tuaja", -theksoi Gjeneral Mullai. Në zbatim të udhëzimeve të dala për zhvillimin e procesit mësimor në institucionet arsimore, mësimi do të vazhdojë online deri në një urdher të dytë.

Qendra e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve

Pas periudhës 8-javore përfundon Kursi 46-të Bazë i Nënoficerëve

Më datë 15.01.2021 në ambientet e Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit 46-të Bazë të Nënoficerëve. Në këtë ceremoni mori pjesë, Komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, Zv/komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, Komandanti i Kurseve, si dhe personeli pedagog dhe mbështetës i QAPN-së.

Fjalën e hapjes në këtë ceremoni e mbajti Instruktori Përgjegjës i Kursit Bazë, i cili theksoi se përfundimi i këtij kursi nga të gjithë dëshmoi punën e mirë të bërë nga vetë kursantët, duke realizuar me sukses programin mësimor. Gjatë kursit angazhimi i kursantëve për përvetësimin e programit mësimor ka qenë në nivel të mirë dhe në rritje të vazhdueshme.

Pas tij fjalën e mori N/Tetar Elton Lami i cili falënderoi trupën mësimdhënëse të QAPN-së: "Doja të falënderoja pa masë instruktorët tanë që me shumë profesionalizëm, këmbëngulje dhe durim na mësuat, stërvitën dhe na bënë që të ndjehemi më të sigurtë në detyrat që do të na besohen në të ardhmen". Në përfundim të kësaj ceremonie fjalën e mbajti Komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, i cili në fjalën e tij përsëritte për kursantët ndër të tjera tha: "Personalisht jam i informuar dhe kam ndjekur me interesim të veçantë të gjithë aktivitetin gjatë procesit të arsimimit dhe trajnimit, duke patur një interes

të veçantë në përvetësimin e plotë nga ju të gjithë programit"

Kursi Bazë i Nënoficerit (Faza I), u zhvillua në QAPN për një periudhë 8-javore dhe ka patur si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të tetarit si drejtues në rol të komandantit të skuadrës dhe detyra të njësuara me të, edukimin dhe përgjegjësinë ndaj detyrës dhe gatishmërisë luftarake, në zbatimin e urdhrave dhe forcimin e disiplinës vetjake. Përvetësimi i njohurive të marra në modulet: Lidership, Rregullorë/Ligjshmëri, Taktikë, SHLT, Përgatitje zjarri, Përgatitje fizike, luajtën rol kryesor në formimin e tyre si komandantë të ardhshëm skuadre.

100-Vjetori i Krijimit të Armës së Xhenios

Xhenierët mbajnë lart emrin e nderuar të ushtrisë shqiptare

Xhenierët e Forcave të Armatosura do punojnë me përkushtim dhe me përgjegjësi për realizimin e misionit kushtetues dhe detyrave që do tu ngarkohen duke e ngritur edhe me lart emrin e nderuar të ushtrisë shqiptare

Në ceremoninë e zhvilluar ditën e martë, më 20 janar 2021, me rastin e 100-Vjetorit të Krijimit të Armës së Xhenios, në Batalionin e Xhenios të Komandës Mbështetëse, morën pjesë ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor prof. asc. Bajram Begaj, komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneralbrigade Ndrëhim Sallaku si dhe disa veteranë xhenierë, që kanë shërbyer ndër vite në këtë armë.

Në fjalën e mirëseardhjes, komandanti i Batalionit të Xhenios kolonel Hajdar Gurra bëri për të pranishmit një përshkrim të shkurtër historik të kësaj arme ndër vite që nga moment i krijimit të saj në 20 janarin e vitit 1921 e deri në ditët e sotme. Kolonel Gurra theksoi angazhimin e gjerë në spektër pune dhe shpërndarje gjeografike, të cilët dhe sot në Festën e 100-Vjetorit të Krijimit ndodhen në krye të detyrës për hapjen e rrugës së bllokuar nga bora në njësinë administrative Shkrel të Malësisë së Madhe, për ndërtimin e një ure në Fier, për hapjen e rrugës së dëmtuar nga reshjet në Golem të Gjirokastrës, shpërthimin e kontrolluar të masivit shkëmbor rënë



në Elbasan etj.

Ai përshëndeti efektivat e misionit të "eFP" në kuadër të NATO në

Letoni dhe përkujtoi me respekt e mirënjohje dëshmorët xhenierë, që dhanë jetën për një vend të pastër



nga minat dhe municionet vdekjeprurëse që nga dëshmori i parë xhenier kapiten Panajot Haxhimihali, rënë në çminimin e bregdetit e deri tek dëshmorët e fundit, major Klodian Tanushi e nëntetar Zarife Hasanaj që dhënë jetën në misionin e NATO-s "eFP" në Letoni, në vitin 2019.

Në emër të xhenierëve, të cilët si rrallëherë ishin tepër të paktë në pjesëmarrje për shkak të pandemisë Covid 2019, përshëndeti nënkoloneli në rezervë Zabit Cuku. Xhenieri 70-të vjeçar me një karrierë 45-së vjeçare mbi supe, i cili me krenari të përlligjur theksoi rëndësinë e Armës së Xhenios dhe elementët e saj të përdorur me mjeshtëri në beteja, që nga koha e Gjergj Kastriot Skënderbeut e në periudha të ndryshme të historisë si dhe kontributin e vyer të xhenios në ndihmë të komunitetit në nevojë.

Më pas fjalën e mori ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, i cili pershkoi rrugën 100 vjeçare të kësaj arme përmes punës, sakrificave në shërbim të jetës dhe sigurisë së popullit e me rubrika të pafundme kontributi të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së banorëve tanë. "Me urimin për të qenë gjithmonë në krye të zbatimit të detyrave me cilësi dhe në kohën e duhur, si Ministër i Mbrojtjes falënderoj xhenierët e Forcave tona të Armatosura dhe shpreh bindjen se ata do të vazhdojnë të punojnë me përkushtim dhe me përgjegjësi të plotë për realizimin e misionit kushetues dhe detyrave që do tu ngarkohen duke e ngritur edhe me lart emrin e nderuar të ushtrisë shqiptare"-përfundoi ai. Kjo ceremoni sa dinjitoze aq dhe modeste për shkak të pandemisë COVID 2019 ishte një moment i veçantë gëzimi dhe krenarie për të gjithë xhenierët e FARSH aktivë dhe jo aktivë për kontributin e dhënë dhe arritjet e xhenierëve në realizimin e misionit e në mbështetje të popullsisë në rast nevojë.



QENDRA E ARSIMIMIT PROFESIONAL TË NËNOFICERËVE

Fillon kursi i 47-të Bazë i Nënoficerit

Kursi 47-të Bazë i Nënoficerit, përbëhet nga 36 kursantë ku 3 prej tyre femra

Një tjetër kurs Bazë filloi në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve. Në datën 25. 1.2020 u hap kursi 47-të Bazë i Nënoficerit, i përbërë nga 36 kursantë ku 3 prej tyre femra.

Kursi Bazë i Nënoficerit (Faza I), zhvillohet në QAPN gjatë një harku kohor 8-javor dhe ka si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të tetarit si drejtues në rol të komandantit të skuadrës dhe detyra të njësuara me të, edukimin dhe përgjegjësinë ndaj detyrës dhe gatishmërisë luftarake, në zbatimin e urdhrave dhe forcimin e disiplinës vetjake. Gjatë këtij kursi kursantët do të thellojnë njohuritë dhe intelektin e tyre në modulet e mëposhtme: Liderhip, Rregullore/Ligjshmëri, Taktikë, SHLT, Përgatitje zjarri, Përgatitje fizike.

NË QENDRËN E ARSIMIMIT PROFESIONAL TË NËNOFICERËVE

13 kursantë zhvillojnë Kursin e 8-të të Kryekapterit

Kursantët kanë ndjekur këtë kurs për një periudhë 4 javore

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve ka filluar, më 12 janar 2021, kursi i tetë i kryekapterit, i përbërë nga 13 kursantë, ku 4 prej tyre janë femra. Kursantët e kanë ndjekin këtë kurs për një periudhë 4 javore. Kursi kishte si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të kryekapterit, si këshilltar i komandantit të forcës dhe njësisë dhe detyra të njësuara me të. Në këtë kurs moren pjesë nënoficerë me gradën "Kapter". Për këtë kurs u morën të gjitha masat e duhura për zhvillimin normal të programit mësimor, në përputhje me të gjitha udhëzimet e dala për masat anti-covid.

Një botim i rëndësishëm i Arkivit Qendror të FA

Faqe e re në historinë e arkivave ushtarake shqiptare

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj


Traditë që po krijohet...

Arkivi është kujtesa e shkruar e kombit, ku rëndësia e ruajtjes së dokumenteve dhe dorëshkrimeve me vlerë historike lidhet ngushtë me ekzistencën e shtetit. Zanafil-lën arkivi e ka nisur me themelimin e shtetit shqiptar, ku ishte një zyrë sekretarie e cila funksiononte pranë Shtabit Madhor.

Në nëntor të vitit 1944, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare u bë shtëpia e parë e dokumenteve zyrtare të shtetit. Dokumentet e qeverisë, ministrive, bashkive, kuesturave e të ushtrive kuislinge u bënë baza të Fondit Arkivor Kombëtar. Në vitin 1949 u krijua Arkivi i Shtetit dhe në vitin 1950, në Ministrinë e Mbrojtjes u ngrit kartoteka e historisë, e cila funksionoi deri në vitin 1960. Në vitin 1964 u zyrtarizua Arkivi i Ushtrisë dhe sot Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura.

Rrugëtimi i Buletinit Arkivor Ushtarak, organ teoriko-arkivor i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura e nisi në marsin e vitit 2011, modest dhe i thjeshtë, duke pasqyruar ecurinë e arkivistikës shqiptare dhe të arkivit ushtarak si pjesë e rëndësishme e pasurisë kombëtare, ku ruhen dokumente me vlera historike. Që nga ajo kohë buletini ka pasqyruar në vijimësi historinë shekullore të Forcave të Armatosura shqiptare.

Në vitet e fundit duke filluar nga viti 2017, buletini filloi publikimin e



dokumenteve arkivore, ku vend të rëndësishëm ka zënë një përmbledhje me dokumente nga Fondi i Komandës Gjermane në Shqipëri në vitet 1940-1944. Në vitin 2018 në faqet e buletinit u publikuan partizanët italianë në Ushtrinë Nacionalçlirimtare Shqiptare në periudhën shtator 1943-maj 1945. Ndërsa në vitin 2019 u publikuan përmbledhje me dokumente nga shtypi periodik "Mundimi" dhe "Liria e Shqipnis" në vitet 1944-1945.

Ndërsa në fundvitin 2020 buletini pasqyroj përmbledhje dokumentesh të periudhës së Luftës së Dytë Botërore (1939-1944) dhe të Luftës së Ftohtë (1947-1990). Të

gjitha këto dokumentet janë pjesë e fondeve të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, në Ministrinë e Mbrojtjes. Risia e re e këtyre dokumenteve është se publikohen për herë të parë dhe ju vijnë në ndihmë studuesve ushtarak, por dhe materiale që pasqyrojnë dhe evokojnë një periudhë e cila ja vlen të studiohet dhe të thellohet më tej në aspektin ushtarak.

Dokumente të Luftës së Dytë Botërore 1939-1944

Këto dokumente e njohin lexuesin dhe studuesin me të dhëna për dislokimin e trupave ushtarake italiane e gjermane në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Interesante është dokumenti me listën emërore të delegacionit kuisling shqiptar të kryesuar nga Kryeministri Shefqet Vërlaci, i cili më 16 prill 1939, shkoi në Romë dhe i dorëzoi Mbretit Viktor Emanueli III, kurorën e Skënderbeut. Një dokument i rëndësishëm është dhe përqendrimi i trupave italianë në Shqipëri në vitet 1939-1943. Botohet për herë të parë sipas origjinalit Rezolucioni i Këshillit të Përkohshëm Nacionalçlirimtar, për çlirimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, mbajtur në Pezë, më 16 shtator 1942. Aty gjenden raporte të marra nga fondit i komandës gjermane, të dhëna të detajuara për gjendjen politiko-ushtarake në

Shqipëri në fundin e vitit 1944.

Vend të veçantë zënë dhe mjaft artikuj të shtypit, lajme të radiove e agjencive të huaja, për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, për periudhën 1939-1944. Një material interesant dhe me vlera është dhe materiali për Konferencën e zhvilluar në Kolegjin e San Antonit, në Oksford të Britanisë së Madhe në dhjetorin e vitit 1962, me temë "Britania dhe Rezistenca Evropiane në vitet 1939-1945", ku një pjesë e punimeve trajton rezistencën në Shqipëri dhe rolin e britanikëve.

Në faqet e buletinit zë vend dhe një listë emërore e dëshmorëve të vrarë në kampin gjerman të Prishtinës, si dhe lista emërore e shqiptarëve të vdekur në një fushë përqendrimi në Gjermani.

Gjithashtu nëpërmjet një dokumenti njihemi me forcat gjermane të përqendruara në Shqipëri, ku jepet dhe një raport i detajuar i ushtrisë gjermane mbi gjendjen ushtarake e politike të saj. Vëmendje paraqet dhe dokumenti për orientimin nacionalçlirimtar, qëndrimin e Ballit Kombëtar, të zogistëve, grupin pro italian dhe të Kosovës. Në vëmendje është dhe një letër e Kryetarit të Shtatmadhorisë drejtuar familjes së dëshmores Ramize Gjebreja, dhe një dokument ku përshkruhet rënia e nënkolonel Mustafa Gjinishi dëshmor i luftës për liri.

Dokumente të Luftës së Ftohtë 1945-1990

Periodha e Luftës së Ftohtë 1947-1990 paraqet dokumente që pasqyrojnë ngritjen e burgjeve ushtarake. Më tej pasqyrohet dhe qëndrimi që mbajtën organizatat e PKSH në terren dhe në ushtri ndaj Sejfulla Malëshovës në maj 1947, dënimi i veprimtarisë armiqësore të deputetëve në qershor 1947, lufta kundër klasës së kulakëve dhe orientimet përkatëse në tetor 1950. Mjaft dokumente përmbajnë luftën kundër organizatës "Komiteti Shqipëria e Lirë" të imperialisteve amerikanë, anglezë, si dhe të Beogradit e të Romës.

Paraqet interes informacioni i datës 12 shtator 1968, ku Kryeministrit Mehmet Shehu, i dërgon Enver Hoxhës përgatitjen dhe organizimin ushtarak të Shqipërisë për një luftë të mundshme me BRSS, në frontin tokësor, detar dhe ajror të kërkuar prej tij. Disa dokumente pasqyrojnë fortifikimin e vendit, si dhe vizitën e Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Enver Hoxha në vendkomandën nr. I (Bunk/Arti sot) më 24 qershor 1978, që mbyll dhe ciklin me dokumente të botimit të buletinit arkivor ushtarak për vitin 2020.

Në buletin pasqyrohet dhe një letër e Komitetit Qendror të Partisë Punës së Shqipërisë e qershorit 1974, drejtuar gjithë komiteteteve qarkore të PPSH dhe gjithë organizatave të partisë në ushtri, si dhe Drejtorisë Politike në dënimin e veprimtarisë armiqësore të deputetëve kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, detyrat që u dalin organizatave të partisë për mobilizimin e komunistëve dhe për një luftë më të ashpër e të pamëshirshme kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm.

Botimi i Buletinit Arkivor-Ushtarak përmbush një detyrë e mision arkivor për hapje të dokumenteve arkivore, të pabotuara më parë, si për studiuesit, por dhe për opinionin mbarëkombëtar. Në botimin e dokumenteve i cili i ka qëndruar rigorozisht gjuhës së dokumentit duke e pasqyruar atë dhe në origjinal. Në mjaft raste dokumenti është i shoqëruar me faksimile për të evidentuar dhe për të nxjerrë origjinalitetin e tij.

Puna për të ardhmen

Për Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura prioritet mbetet modernizimi dhe përmirësimi i ambienteve, mirëadministrimit i dokumenteve, si dhe një shërbim më cilësor dhe profesional për qytetarët, për studiuesit e brendshëm dhe të huaj si dhe për institucionet. Një vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet sistemimit dhe digjitalizimit të

fondeve arkivore ushtarake të cilat janë mjaft të pasura në cilësi dhe në sasi. Arkivi duke qenë pjesë e kujtesës historike të Atdheut, ka një sprovë të madhe në hapjen dhe shërbimin e informacionit për publikun, duke respektuar ligjin në kuadrin e një shoqërie demokratike me frymë perëndimore.

E shkuara historike nuk është thjesht një e shkruar, nuk është thjesht një ngjarje dhe një dokument, por kjo na ndihmon të shikojmë realisht të tashmen dhe na ndihmon për të shikuar të ardhmen, nëpërmjet këtyre dokumenteve. Analiza historike e dokumenteve na ndihmon të gjejim dhe të vendosim për njohuri dhe analiza më të plota për të ardhmen, pasi nuk duhet të bëhen gabimet e së kaluarës dhe të rrugëtimit me zig-zake të forcës ushtarake të shtetit.

Koha digjitale e rrjeteve sociale na mundëson për një komunikim me përdoruesit, na jep një liri informacioni, qarkullim të lirë të ideve, por sjell dhe dyshime për cilësinë dhe vërtetësinë e përmbajtjes të informacionit të shpërndarë. Arkivi është qendra e kërkimit të së vërtetës dhe këtë shumë mirë po e loz dhe buletini i cili tashmë ka nisur një rrugëtim, ku është burim i privilegjuar, duke qenë rojtar i rëndësishëm i kujtesës historike kolektive të një shoqërie të caktuar.

Duke qenë se arkivi mbart kujtimet e një periudhe të caktuar historike të vendit, krijon dhe një mundësi për të komunikuar pozitivisht me studiuesit dhe me publikun, duke nxjerrë në pah cilësitë morale dhe njerëzore, disiplinën dhe përgatitjen, ndjenjën e fortë që ka karakterizuar pasionin për të bërë një forcë të armatosur për të ecur përpara. Sfidat që qëndrojnë sot për arkivin kërkojnë nxitjen e këtij proces, përdorimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, duke e kthyer në një qendër dhe burim të njohurive dhe të krijimtarisë të FA-së. Ky rrugëtim i Buletinit Arkivo-Ushtarak tashmë është i përcaktuar qartë dhe FA krenohen me një institucion të tillë.

Meteor i dijes ushtarake që nuk shuhet

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI
Prof. Asoc. Dr. Bernard ZOTAJ

**“Sukses është puna,
asaj i besoni...”**

Agim Sula ka qenë dhe do mbetet shoku ynë përjetësisht dhe pse “zemereku” i jetës u ndal padrejtësisht për të në moshën 58 vjeçare. Askush prej shokëve, miqve e kolegve nuk e prisnin një largim kaq të hidhur dhe të dhimbshëm nga virusi vrashtar: Forcat e Armatosura e kishin për nder që e kishin pjesë të armatës, fjalëpeshë, të dashur dhe të çmuar në shoqëri, kolonelin korrekt, ushtarakun model dhe të apasionuar pas mësimdhënies, pedagogun dhe punonjësin shkencor të përkushtuar ndaj shkencës ushtarake. Akademia e Forcave të Armatosura humbi një shef dhe pedagog me nivel, me kompetencë në dije, i cili arriti ta fuste auditorin në rrjedhën normale, si dhe të zotëronte edhe situatën më të vështirë. Me sjelljen e tij “të butë”, që frymëzonte dhe e bënte të dashur lëndën, thjeshtëzonte kompleksitetin dhe “vuajtjet”, për të rritur nivelin e dijeve të qëndrueshme tek studentët ushtarak të Akademisë së Forcave të Armatosura.

“Shef Gimi” siç i thërrisnin, punoi jo vetëm në shkollat ushtarake, por dhe në hapësirën administrative ushtarake shqiptare, duke shoqëruar kurse të ndryshme të AFA-së nga Jugu në Veri në praktika dhe stërvitje të ndryshme stërvitore. Ai ishte i njohur për “shakatë” dhe rromuzet, por dhe dinte ti priste ato, duke lëvizur punën dhe mendimin më përpara në forma dhe metoda akademike e pedagogjike. Ai ishte përpunues i mendimit, shkruante, debatonte, kërkues ndaj vetes dhe të tjerëve, intelektual, njerëzor, e njeri tepër shoqëror. Ai krijoi një familje model dhe përballoi me din-



Kushtuar Kolonel Prof. Asoc. Dr. Agim Qamil Sula (3.7.1962-24.1.2021), ish-Dekan i FMS-së në AFA, që u shua nga Covid-19, do përkujtohet përherë si një meteor që ndriçon, sepse misionarët e dijes nuk shuhën asnjëherë



Shkëlqeu në përvetësimin e dijes ushtarake

jitet sfidat e kohës, e së bashku me bashkëshorten Lira, lindën, rritën edukuan dhe i apasionuan pas studimeve, djemtë Deni dhe Dioni.

Agim Sula shkallët e karrierës i ngjiti gradualisht nga komandant toge në Shkollën “Skënderbej” në vitin 1985, deri në dekan dhe punoi me përkushtim për 36 vite me radhë. Agim Sula njihet nga të gjithë brezat e ushtarakëve si mësimdhënës i pandërprerë, instruktor dhe pedagog në institucionet e sistemit të arsimit ushtarak të Forcave të Armatosura duke dhënë e shpjeguar lëndët “Forcat e Armatosura dhe shteti ligjor”, “E drejta ndërkombëtare humanitare”, etj. Te kolegët dhe studentët ka ngelur mesazhi se “burimi i pashtershëm i suksesit është puna, asaj i besoni”. Këtë mësim Agimi e kishte nga përvoja si nxënës, student, oficer në gjithë nivelet e karrierës ushtarake dhe se “fjalën ja jepte të parës punës”.

Agim Sula u lind në Selitën e Malit në Tiranë, më 3 korrik 1962. Shkollën fillore dhe tetëvjeçare i ndoqi në fshatin e lindjes. Më tej, nga dashuria për profesionin e oficerit ndoqi studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej” në vitet 1977-1981. Shkëlqeu në të gjitha vitet, u aktivizua me organizatën e rinisë, duke qenë dhe sekretar i saj, si dhe anëtar i rrethit shkencor në shkollë. Përfundimi me rezultate të larta i shkollës së mesme, i bëri krenarë prindërit dhe gjithë rrethin familjar. Në vitet 1981-1982 kryeperiudhën e stazhit pas shkollës së mesme në Ksamil të Sarandës.

Duke qenë një nxënës premtues nis studimet më 1 shtator 1982 në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe për tre vite u dallua në të gjitha disiplinat ushtarake dhe në fund të shkollës doli ndër studentët

më të shkëlqyer të shkollës. Ai mbrojti temën e diplomës "Kompania e këmbësorisë në mësymje", privilegj për studentët e dalluar. U titullua oficer më 25 korrik 1985 dhe vendi i tij ishte "i rezervuar" në Tiranë, sepse studentët e shkëlqyer e kishin vendin në shkollat ushtarake. Nisi rrugëtimin ushtarak, komandant toge në shkollën "Skënderbej". Studimet e nivelit universitar i mbylli në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Drejtësisë, Dega Jurisike më 3 korrik 1996. Agim Sula vijoi studimet në Akademinë e Mbrojtjes në vitet 2001-2002, ndërsa në vitet 2012-2013 kryen Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Akademinë e Forcave të Armatosura, si dhe mjaft kurse e kualifikime të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Në vitet 2003-2006 në institucionin e Akademisë së Mbrojtjes "Spiro Moisiu", punoi për temën doktorature "Përmbushja e misionit të FA në përputhje me Ligjin e Konfliktit të Armatosur dhe rregullat e angazhimit në përdorimin e forcës", duke fituar gradën shkencore "Doktor i shkencave ushtarake" me nr. 4427, datë 10.7.2006. Ndërsa në vitin 2013, komisioni i posacëm i vlerësimit të titujve akademike për punën dhe kontributin e tij i akordon titullin akademik "Profesor i Asociuar" me vendimi nr. 37 dhe me nr. regj. 389, në Ministrinë e Arsimit.

Kontributi në jetën akademike

Të shumta janë materialet akademike që ka lënë Kolonel Prof. Agim Sula. Kështu mund të përmendim "Ligji i Konfliktit të Armatosur" (2009), "Libri i arsimimit dhe fushën e udhëheqjes ushtarake dhe shkencave shoqërore", me bashkëautorësi (2015), "Doktrina Ushtarake e FARSH DP-1" (2013), "55 vjet Akademi e Forcave të Armatosura 10 maj 1958-10 maj 2013" (2013), etj. Ai ka qenë në bordin e konferencës: "International Scientific Conference "100 years Albanian State-100 years Albanian Armed Forces/The declaration of Independence of Albania and the international environment", December 2012.

Agim Sula ka publikuar gjithashtu me autorësi "Senior Course on Security & Defence Studies - 2012", (Lessons book), published by: Albanian Armed Forces Academy, Tirana,

2012; "Promoting Regional Peace and Security/4-th Senior Course on Security and Defence Studies SCSDS", Published by: Training and Doctrine Command, Albanian Armed Forces Academy, Tiranë, Albania, 2012; "Ligje për Forcat e Armatosura/Libri i Ligjeve 2006", me bashkëautorësi, anëtar i grupit të punës për "Rregullore e Brendshme të Ministrisë së Mbrojtjes" (2005), "Ligje për Forcat e Armatosura/Libri i Ligjeve 2004", (2004), "Manual i Personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", (2004) etj.

Prof. Agim Sula ka publikuar tema, analiza, studime e artikuj të shumtë në revista ushtarake shkencore nga të cilët mund të përmendim: "Rruga 55-vjeçare e Akademisë së Forcave të Armatosura dhe vizioni për të ardhmen" (2013), "Personeli i kualifikuar i AFA-së, përgjigje për arritjet dhe rezultatet" (2013), "Çështja e Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë" (2012), "Koncepti dhe realizimi i sigurisë në hapësirën shqiptare deri në prag të shpalljes së Pavarësisë dhe krijimit të shtetit të parë modern shqiptar", bashkëautor (2013), "Albanian space protection, up to the Declaration of Independence", Military Review, First Edition, January 2013, "Mbrojtja e hapësirës shqiptare deri në shpalljen e Pavarësisë" (2012), "Aspekte ligjore të ndërhyrjes ushtarake në Libi" (2012), "Arrestimi dhe gjykimi i Mlladiçit-drejtësi e vonuar" (2011), "Mbi zhvillimet e nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit në shek. XXI, për aktivizimin e mbrojtjes kolektive të Aleancës", bashkëautorësi (2011), "Ligji i konfliktit të Armatosur si proces i përmirësimit historik të tij" (2006), "Lufta ndaj terrorizmit dhe drejtime të plotësimit e të përsosjes së kuadrit ligjor" (2003), "Të njëjtat krime si 100 vjet më parë" (1999), etj.

Prof. Agim Sula ka qenë pjesëmarrës me referim në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në seminare, kongrese, konferenca, ku mund të përmendim në Lithuan: "The European Security and Defence Policy and Transatlantic Relation", a paper presented at "Proceedings of the Syndicate Studies of the International Staff Officers Orientation Course ISSOOC 2001.2", The Netherlands Defence

College, Rijswijk, the Netherlands, the 4-th of July 2001. Published by: Netherlands Defence College, me bashkëautorësi; "Customary International Humanitarian Law", paper presented (and speaker) at the International Seminar, "The Law of Armed Conflict", at the Partnership for Peace Training Center, Ankara, Turqi, 2007, "Albanian space protection, up to the Declaration of Independence", a paper presented (and speakers) at the International Scientific Conference "11 years Albanian State-100 years Albanian armed Forces/The declaration of independence of Albania and the international environment", Organized by: Albania Ministry of Defence, si dhe në publikimin e Proceeding Book: "Declaration of independence of Albania and the International Environment-International Scientific Conference", Publication of The Armed Forces Academy in the Training and Doctrine Command of Albania, Tirana, December 2012, "On the efforts to improving security and stability in the Western Balkans, Energy Security as a new dimension of security", a paper presented (and speakers) at "15-th International Conference of ACA/Cooperating for Security in the Western Balkans", ACA; si dhe ka qenë kontribuues dhe anëtar i grupit organizator në Konferenca e 6-të Ndërkombëtare Ligjore të NATO-s, Tiranë, 2012, organizuar nga Komanda e NATO-s për Transformim (ACT) dhe Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA të RSH-së. Në muajt e fundit të jetës së tij mori pjesë me kumtesë në Konferencën Kombëtare të organizuar në Vlorë më 3 shtator 2020, në 100 vjetorin e Luftës së Vlorës.

Kolonel Prof. Asoc. Dr. Agim Sula ishte i lidhur fort me Departamentin e Liderimit dhe Shkencave Shoqërore, ku ka dhënë modulet "E drejtë ndërkombëtare", "E drejta e konfliktit të armatosur" dhe "E drejtë kushtetuese", duke fituar zemrën dhe admirimin e studentëve ushtarakë për dekada të tëra. Jeta dhe vepra e tij janë një pasuri që e la trashëgimi për shkollat ushtarake, prandaj do kujtohet përherë si një njeri i ditur dhe i respektuar. Asim Sula rrezatoi vlera dhe la emrin e mirë të një meteori të dijes, meteori që nuk mund të shuhet.



Ndarja nga jeta e majori Xhevahir Jazaj në Afganistan

“Largimi nga jeta i një ushtaraku, ngjarje e dhimbshme për të gjithë”

Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura njoftojnë se ditën e martë me 19 janar 2021, në orën 22:40 ora lokale në Afganistan, ka humbur jetën major Xhevahir Jazaj. Në njoftimin zyrtar, thuhet se “autoritetet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA po bashkëpunojnë me komandën e operacionit për të bërë hetimin e plotë të rrethanave në të cilat ka ndodhur ngjarja. Ministri i Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA sigurojnë personelin në mision dhe familjet e tyre se do vijojnë të mbështesin e t’u gjenden pranë për të përmbushur me sukses misionin. Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm dhe gjithë personeli i Forcave të Armatosura i shprehin ngushëllimet më të ndjera familjes për ndarjen e parakohshme nga jeta të njeriut tyre të dashur”.
Ndërkohë Ministri i Mbrojtjes,



Ministri Peleshi, ka zhvilluar komunikim të drejtpërdrejtë me kontingentin shqiptar në Herat e Kabul

Niko Peleshi i shprehu ditën e mërkurë më 20 janar 2021, ngushëllimet më të sinqerta familjes së majorit Xhevahir Jazaj, i cili u nda nga jeta gjatë një misioni në Afganistan. Peleshi u shpreh se, “largimi nga jeta i një ushtaraku, aq më tepër në mision larg atdheut, është një ngjarje e dhimbshme për të gjithë. I shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta familjes së majorit Xhevahir Jazaj”. Peleshi zhvilloi edhe një komunikim të drejtpërdrejtë me kontingentin shqiptar që shërben në Herat dhe Kabul me të cilët ndau ngushëllimet për humbjen e shokut të tyre dhe i siguroi se gjithë shqiptarët janë me mendje e me zemër pranë tyre.

“Para pak çastesh pata një komunikim të drejtpërdrejtë me

kontingentin shqiptar që shërben në Herat dhe Kabul. Ndava me ta ngushëllimet për humbjen e shokut të tyre dhe i sigurova se gjithë shqiptarët janë me mendje e me zemër pranë tyre”, tha Peleshi. Ai u shpreh se “ata janë krenaria jone në raport me aleatet në NATO e partnerët tanë strategjike SHBA dhe BE me të cilët ndajmë sfida të përbashkëta të mbrojtjes kolektive, paqes dhe sigurisë”.


Xhevahir Jazaj është ushtaraku i dytë shqiptar humb jetën në Afganistan, pasi në shkurt 2012 u vra kapiten Feti Vogli në një pritë me armë në një fshat të Kandaharit dhe i katërti në misionet e NATO-s. Në 2019 ranë në krye të detyrës gjatë misionit në Letoni, major Klodian Tanushi dhe ushtarja Zarife Hasanaj.

COVID-19 apo lufta në dimensionin e VI-të

Kolonel Hysni Gjergji

Mjediset e sigurisë duke ndryshuar kanë diktuar që luftrat dhe konfliktet të zhvillohen në "fushë beteja" të ndryshme në varësi të hapësirës, terrenit si dhe të kërcënimeve të sigurisë që ndryshojnë. Fillimisht toka dhe më pas me shpikjen e anijeve, të avionit, të anijes kozmike dhe në dekadën e fundit të hapësirës kibernetike; luftrat dhe konfliktet u zhvendosën duke kërkuar edhe ndryshimin dhe evoluimin e doktrinave për këtë qëllim. Deri në dimensionin e 4-ërt, atë kozmik, tiparet e luftimit ishin më reale, më të dukshme dhe me përmasa të matshme dhe të perceptueshme. Në vitin 2017, SHBA dhe UK krijuan për herë të parë në histori strukturën e forcave hapësinore. Shtetet e Bashkuara dhe Britania ishin të parat që sinjalizuan të gjithë vendet anëtare të NATO-s që satelitët ushtarakë, civilë dhe teknologjikë, janë të kërcënuar nga ndërhyrjet e Rusisë dhe të Kinës. Në 2018 u krijuan njësitë e para të mbrojtjes kibernetike në varësi të Forcës Ajrore, kjo pas shumë ndërhyrjeve të vërtetuara në sistemet kompjuterike në shumë vende të perëndimit duke synuar, politikën, mbrojtjen, ekonominë dhe teknologjinë. Ndërsa dimensionet, tokësore, detare dhe ajrore deshën shumë kohë për tu kapërcyer; dimensionin hapësinor dhe ai kibernetik (online) kërkuar vetën rreth 2 vite. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Stoltenberg, më 23 tetor 2020, deklaroi "hapësirën si një fushë operacionale për NATO-n. Sot ne bëmë një hap tjetër të rëndësishëm". NATO është e vendosur të ruajë avantazhin e saj në të gjitha fushat duke përfshirë tokën, detin, ajrin, fushën kibernetike dhe hapësirën". NATO nuk ka interes në "militarizimin" e hapësirës, por arsyeja është fakti se kërcënimet ndaj satelitëve të NATO-s dhe sistemeve hapësinore janë reale, pasi Rusia dhe Kina tani po zhvillojnë aftësi që mund të verbojnë, shkatërrojnë dhe manipulojnë satelitët, të cilat do të kenë një ndikim të rëndësishëm për ushtrinë ashtu edhe aktivitetet civile në terren. Tashmë lufta hapësinore është një "fushë beteje" e pranuar dhe dimensionin 4-ërt i luftës.

NATO duke analizuar mjedisin e ri të sigurisë, vazhdon procesin e transformimit



dhe adaptimit me kërcënimin e ri, duke inkurajuar edhe shtetet anëtare të krijojnë kapacitete mbrojtëse dhe kundërsulmuese në hapësirën më të re të zhvillimit të luftës moderne, atë kibernetike. U duk sikur ky ishte kulmi dhe dimensionin më i lartë i luftës, i cili u quajt edhe dimensionin i 5-të ai i "luftës në hapësirës kibernetike", si një realitet "fiction" apo fantastiko shkencor.

A ka ndryshuar mjedisi i sigurisë dhe a është COVID-19 një kërcënim i ri asimetrik? A ka ngjashmëri lufta asimetrike në dimensionin më të ri, atë biologjik? A është bioterrorizmi një "bioluftë" apo lufta e re e cila zhvillohet në dimensionin e 6-të?

Në përkufizimin e luftës deri tani mungojnë palët në konflikt, pasi COVID-19 është akoma pa posedues, dhe armë në duart e të panjohurës. Duke qenë se së paku deri tani ka vepruar në të gjithë botën, duke mos kursyer asnjë shtet (të paktën kjo dihet deri tani) kjo "luftë e re" ngjan me konfliktin bërthamor ku si rezultat i përdorimit të ADM nuk ka të fituar pavarësisht palës që i përdor.

Mendoj që shumë tipare dalluese të luftës asimetrike dhe vecanërisht të terrorizmit biologjik, mbart edhe pandemia që po vret njerëz, bllokoi lëvizjen e lirë, shkatërron ekonominë, përhap panikun, rrit frikën dhe pasigurinë për jetën si dhe ka gjuhëzuar botën prej gati një vit. Në një deklaram të fundit lidhur me pandeminë, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg, deklaroi se: "Bota po ndryshon kështu që edhe NATO duhet të ndryshojë" duke lënë të kuptohet kështu një adaptim të ri të NATO-s, në përshatje të ambjentit të ri të sigurisë të krijuar dhe të doktrinave dhe të strukturave të shteteve që e përbëjnë

atë. Duke studiuar llojet e terrorizmit, bioterrorizmi është formë e terrorizmit e cila përdor si armë agjentët biologjikë, viruse, bakterie dhe mikrobe për arritjen e qëllimit të tij. Përveç agjentëve biologjikë të zakonshëm organizatat terroriste mund të modifikojnë dhe të ndërhyjnë tek ndërtimi i tyre, me qëllim për ti bërë ato më të rrezikshme dhe të pa zbulueshme. Agjentët biologjikë duke vuarë njerëz të pafajshëm, kafshë apo edhe duke zhdukur bimësi, arrijnë objektivin e tyre duke krijuar perceptimin e kaosit, frikës, ankthit dhe pasigurisë.

Shumica e agjentëve biologjikë gjenden në natyrë, por mund të prodhohen edhe në laboratorë, duke bërë të mundur transmetimin nga personi në person si dhe duke rritur kohën e shfaqjes së simptomave nga disa orë në disa ditë. Në këtë mënyrë ndërhyrja me vonesë për tu mbrojtur dhe kundërvepruar, bëhet më e vështirë, ndërkohë që vatra e infeksionit është zmadhuar në më shumë bartës dhe transmetues të sëmundjes vdekjeprurëse.

Një organizatë apo një luftëtar terrorist ka disa tipare që e dallojnë nga një luftëtar tradicional; Terroristi tipik operonte i padukshëm, i pa dallueshëm, pa tipare të kapshme nga shqisat e thjeshta. Në një ambient të zakonshëm ai (terroristi) shkrihej me turmën, nuk mbante uniformë dhe shenja dalluese si luftëtarët tradicionalë që ne ishim mësuar të identifikonim deri atëherë. Terroristi apo "luftëtar i asimetrik" mund të ishte "kudo" dhe "askund" në të njëjtën kohë. I ngjashëm paraqitet sot edhe "terroristi biologjik" një mbartës apo posedues i virusit corona, i cili mund të jetë "kudo"

por edhe "askund" shton pasigurinë, ankth, stresin dhe frikën, njëloj sikur të jemi para një situatë kërcënimi terrorist. Një terrorist mund të jetë "kushdo" dhe "askush" pasi nuk kishte shenjë dalluese dhe nuk mbante armatim të dukshëm, por një armë të pa identifikueshme, që mund të shkaktojë shumë viktima. I ngjashëm është edhe një bartësi i Covid-19, i cili nuk dallohet, nuk ka tipare apo cilësi që ta bëjnë të dallueshëm, por ai zotëron, ose është vetë një armë e aftë të vrasë shumë persona përmes infektimit, megjithëse në shumicën e rasteve jo qëllimisht. Më e keqja është se, mund të ndodhë teorikisht dhe shkencërisht që një shtet, organizatë terroriste apo individ, mund të ruajë dhe përdorë për infektim, materialin biologjik të COVID në kushte laboratorike të përshtatshme duke e kthyer atë në armë të mirëfilltë biologjike. Globalizmi, e drejta e lëvizjes dhe bota pa kufinj, vlerësohet të jetë një nga lehtësirat e demokracisë që është keqpërdorur nga organizatat terroriste në të shkuarën dhe të tashmen për të kryer sulme në cdo cep të botës. Virus Corona po përhapet gjithashtu i transportuar nga persona që lëvizin nga një shtet në tjetrin dhe nga një rajon në tjetrin.

Shënjestrat dhe viktimat e terrorizmit janë pikat nevrlogjike të ekonomisë, sikurise dhe politikës, pasi kështu arrihet efekt dhe frikësim maksimal i shoqërisë, si dhe mosbesim tek strukturat shtetërore dhe të sigurisë. Qëllimi i çdo lufte, përfshirë edhe luftën asimetrike është nxjerrja jashtë luftimit e lidershit dhe dobësimi i infrastrukturës jetike të kundërshtarit. Zgjedhja e këtyre objektivave ka për qëllim, lënien e kundërshtarit pa drejtim strategjik dhe pa burime të mjaftueshme logjistike për të përballuar luftën. Nuk do kishte shënjestër më të rëndësishme për një kundërshtar, psh. nxjerrja "jashtë luftimit", ofhtë për pak kohë e SHSHP-së të ushtrisë italiane, në mars të vitit të kaluar; apo e dhjetra e qindra ushtarakëve në gjithë operacionet me aleancën; largimi nga shtëpia e bardhë e presidentit të SHBA-së për disa ditë, rrezikimi i jetës së kryeministrit të UK-së, si dhe mbyllja e shumë kompanive dhe korporatave duke shkakuar rënie ekonomike në shkallë botërore.

Agjencitë e inteligjencës në luftën asimetrike dhe tradicionale, kanë rolin dhe detyrën parësore të informojnë dhe paralajmërojnë në kohë lidershpin politik dhe ushtarak për kërcënimet dhe rreziqet që përballet jeta e qytetarëve të cdo vendi. Në kushtet e një pandemie, si pjesë e kërcënimeve bioterroriste kombëtare të cdo vendi, agjencitë kryesore të inteligjencës kanë për detyrë që duke përdorur burimet e tyre njerëzore, teknike dhe të tjera ligjore informative, të ndjekin dhe përcaktojnë vendin nga ku është filluar zhvillimi i pandemisë, shkaktrë, qëllimet dhe personat mbartës të saj. A kanë paralajmëruar agjencitë e inteligjencës për një pandemi të mundshme që do të merrte jetën e mbi 1,5 milionë njerëzve dhe infektimin e mbi 45 milionë të tjerëve për më pak se një vit? Siç është publikuar deri tani këto agjenci, kryesisht amerikane, kanë paralajmëruar për kërcënimin që paraqet një pandemi e panjohur më parë, në bashkësinë e kërcënimeve dhe rreziqeve që do të përballet SHBA-të në

të ardhmen. Në janar 2019 drejtori i sigurisë kombëtare Dan Coats i raporton kongresit, se: "Epidemia e sapozbuluar në Kinë mund të kthehet në pandemi botërore dhe ka të ngjarë të shkaktojë një numër të madh vdekjesh, pasoja të rënda në ekonomi, zvogëlimin e rezervave botërore dhe rritjen e nevojës për ndërhyrje të Kombeve të Bashkuara për ndihmë dhe mbështetje".

-Informacioni në kohë sa më të shpejtë për një sulm të mundshëm terrorist, është parësor për të fituar këtë luftë. Duke ndjekur këshillat e specialistëve epidemiologë, ngjashmërisht rezultoi të jetë edhe në luftën kundër pandemisë pasi gjetja e personit zero, apo e personit që mund të zotërojë materialin biologjik të infektuar të prekur; të vatrës së infeksionit dhe të kohës sa më të shpejtë, është shumë e domosdoshme për të karantinuar zonën, izoluar poseduesit dhe të prekurit, duke këputur në kohë zinxhirin e përhapjes dhe minimizuar pasojat.

Në komunitetin e inteligjencës MEDINT (medical intelligence) është njëra nga agjencitë e zbulimit e cila megjithëse është më pak e njohur deri në kohën kur shpërthen një epidemi apo sëmundje tjetër infektive. Inteligjenca mjekësore MEDINT si pjesë e J2, përkufizohet bashkë me Inteligjencën njerëzore HUMINT, Sinjalore SIGINT, Imazhore IMINT, OSINT etj., si një kategori zbulimi e cila merret me grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe interpretimin ndaj sistemit të mjekësisë së kundërshtarit. MEDINT kërkon, zbulon dhe informon departamentin e mbrojtjes për arritjet e shkencës dhe kërkimeve biologjike të rrezikshme të armikut, si dhe informacionin mjekësor, i cili ka interes në planifikimin strategjik dhe mjekësor operacional ushtarak. Ky informacion i përgatitur nga MEDINT ka qëllim mbrojtjen e popullatës, të forcave dhe formacioneve luftuese të aleancës; si dhe përgatitjen e vlerësimeve lidhur me kapacitetet biologjike dëmtuese kërkimore shkencore dhe mjekësore të kundërshtarit, si në aspektin civil ashtu edhe në atë ushtarak.

Ky përcaktim i NATO-s për MEDINT i referohet vlerësimeve analitike të kapaciteteve mjekësore të një shteti kundërshtar dhe me qëndrim armiqësor ndaj NATO-s. Ky vlerësim përfshin (strukturën dhe infrastrukturën): analizat dinamike shëndetësore në vazhdimësi, mundësitë e shpërthimit të mundshëm të sëmundjeve, epidemive dhe pandemisë si dhe mundësitë që një shtet kundërshtar i aleancës ka për të zhvilluar armë biologjike. Qëllimi është që duke informuar në kohë lidershpin ushtarak dhe politik, të merren masa mjekësore parandaluese ndaj pasojave të armëve biologjike, epidemive, sëmundjeve etj. Përveç komunitetit të zbulimit në SHBA, ka edhe një sistem kompleks të grumbullimit të informacionit lidhur me shëndetin dhe kujdesin mjekësor të bashkuara këto në qendrën e parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve. Ky sistem është i përbërë në rreth 100 sisteme vëzhgimi dhe hetimi të shëndetit, përfshirë këtu grumbullimin e informacionit nga zyra lokale për sëmundjet veçanërisht të rëndësishme të tilla si antrax, kolera, ebola dhe këtë vit COVID-19. OBSH është organizata lider në rrjetin ndërkombëtar të sistemit të

vëzhgimit dhe investigimit të sëmundjeve dhe shëndetit botëror e cila e realizon misionin e saj përmes rrjetit të kundërpërgjigjes dhe alarmit të përhapjes së epidemisë. Në 2018 është publikuar nga OBSH edhe një listë e sëmundjeve të rrezikshme, duke përfshirë "sëmundjen x" e cila paraqiste të dhëna të mjaftueshme për një epidemi botërore e shkakuar nga një patogjen, aktualisht i panjohur, i cili nëse nuk parandalohet në kohë, do të shkaktojë shumë viktima njerëzore.

Sfida kryesore e inteligjencës në kushtet e një lufte të mundshme biologjike do të jetë "Çfarë do të ndodhë në vijimësi?"

Ekspertët virologë dhe ato të inteligjencës janë të shqetësuar nga mundësia laboratorike e ruajtjes së materialit biologjik të infektuar me COVID-19, në kushte optimale duke ruajtur virulencën e lartë për një kohë të gjatë. Nëse ky material biologjik i infektuar me COVID-19 do të bjerë në dorën e shteteve, grupeve, organizatave terroriste apo individëve me qëllime kriminale, vlerësohet se COVID-19 do të përdorej dhe do të shërbente si armë e mirëfilltë biologjike. Efektshmëria e saj do të zgjatej deri në daljen e vaksinës, por që ndërkohë do të kishte sjellë dëm të jashtëzakonshme. Kjo armë tashmë në duart e një aktori shtetëror ose jo, nuk do të kishte më objektiva rastësore, por do t'i përzgjidhte ato në vartësi të qëllimit të përdoruesit.

Situata në të cilën ndodhet siguria e qytetarëve të botës, të sigurisë kolektive, të rivlerësimit të kërcënimeve dhe rreziqeve që përballet NATO, apo çdo shtet anëtar i saj; është një lëksion që duhet lexuar nga të gjithë dhe të nxirren mësimet e duhura për përballimin. NATO ka kapacitete MEDINT por në kushtet e krijuara do t'idehet të përdorë asetet e vendeve anëtare duke bërë më të domosdoshme ngritjen dhe rritjen e këtyre kapaciteteve edhe në vendin tonë. Spitalet COVID në të gjithë botën por edhe në vendin tonë, nuk janë vetëm institucione ku merret mjekim dhe luftohet kjo sëmundje. Këto ambiente duhet të monitorohen dhe ruhen rreptësisht nga dalja, vjedhja apo moskujdesi në trajtimin e mbetjeve biologjike të infektuara. SHBA dhe shumica e vendeve perëndimore janë duke vlerësuar që në këto spitale realisht "mbahen" armë të mundshme biologjike. Në fushën e legjisllacionit, mbrojtjes, rendit publik dhe të Inteligjencës, një i infektuar bartës i virusit, duhet të trajtohet si një armë biologjike e mundshme (e qëllimshme ose jo). Po kështu edhe një specialist virolog apo kimist i cili zhvillon kërkime apo ruan në kushte laboratorike të përshtatshme një material biologjik të virusuar, duhet të trajtohet si një terrorist potencial. Fokusimi më i madh në virologji, siç duket do të jetë profil i ri të cilin do të marrë inteligjenca duke u fokusuar dhe mbështetur më shumë Inteligjencën Mjekësore MEDINT. Shembulli i SHBA-së, ku ka një numër të madh institucionesh dhe një degë të veçantë që merret me MEDINT, tregon se të gjitha vendet nuk duhet të bëjnë përjashtim për të nxjerrë mësimet dhe adaptuar sistemet e sigurisë kombëtare. Deri në vërtetimin të efektivitetit të kundër-armës, vaksinës së Covid-19, lufta vazhdon.



Për herë të parë FSK do t'i bashkohet ushtrisë amerikane në misione paqeruajtëse. Ministri në detyrë i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Anton Quni shpjegon detajet e angazhimit të FSK-së jashtë e sfidat e saj.

Forca e Sigurisë së Kosovës, FSK përkatësisht një njësi e saj do të marrë pjesë në misione paqeruajtëse jashtë vendit krahas ushtrisë amerikane. Kjo marrëveshje u ratifikua ditë më parë në parlamentin e Kosovës dhe shënon për herë të parë angazhimin e trupave të FSK-së në një aktivitet ushtarak jashtë territorit të Kosovës.

Ministri në detyrë i Forcës së Sigurisë së Kosovës Anton Quni, në një intervistëshpjegon detajet e angazhimit të FSK-së në misione paqeruajtëse. "Kosova ka marrëveshje bilaterale me shtete veç e veç dhe deri tash kemi 14 marrëveshje ushtarake. Një ndër to është edhe marrëveshja me SHBA-në përkatësisht me gardën e shtetit të IOWA-s në SHBA. Një ndër projektet e shumta që kemi me këtë gardë është edhe projekti që të marrim pjesë në misione paqeruajtëse me gardën e IOWA-s. Kështu që ne kemi marrë një kërkesë që në misionin e radhës së gardës së IOWA-s ne të jemi pjesë e këtij misioni paqeruajtës. Ftesa është bërë nga komanda qendrore e cila ka përgjegjësi për një hapësinë të gjerë gjeografike ku përfshihet Lindja e Mesme, një pjesë e Azisë Jugore dhe Afrika verilindore. Pra nuk po flasim për ndonjë angazhim në ndonjë shtet



Marrëveshja është me gardën e shtetit të IOWA-s në SHBA

FSK krahas ushtrisë amerikane merr pjesë në misionet paqeruajtëse

FSK, përkatësisht një njësi e saj do të marrë pjesë në misione paqeruajtëse jashtë vendit krahas ushtrisë amerikane

të caktuar, por për një hapësinë të gjerë gjeografike", -thotë ministri në detyrë Quni.

Forca e Sigurisë së Kosovës në bazë të një ligji të miratuar në kuvendin e Kosovës funksionon si një ushtri, ndonëse emrin nuk e ka ushtria e Kosovës. Kjo për faktin që përfaqësuesit e komunitetit serb në kuvendin e Kosovës nuk lejuan ndryshimet e nevojshme kushtetuese që FSK-së do t'ia ndërronin emrin nga FSK në ushtri e Kosovës. Por kjo sipas ministrit Anton Quni nuk e pengon FSK-në që të ushtrojë funksionet e saja si një ushtri e një vendi. "Përprojekta e parë e udhëheqësve politikë ishte që tranzicioni i FSK-së të trajtohet me dispozita kushtetuese dhe pasi që u konsumuan të gjitha

përprojekjet që të binden edhe deputetët e komunitetit serb kjo nuk ndodhi. Atëherë kaluam në opsionin B që pa e ndryshuar emërtimin e FSK-së, nëpërmes ligjit FSK të mandatohet edhe me mision ushtarak. Tash FSK nuk ka asnjë pengesë që të funksionojmë si ushtri, edhe pse ka shtete të Europës dhe më gjerë që ende kanë dilema, por kjo çështje është një çështje e brendshme e çdo shteti dhe ne si shtet edhe veprojmë".

Por, a mund të operojë Forca e Sigurisë së Kosovës në veri të Kosovës, të banuar me shumicë serbe dhe ku kjo trupë nuk është e mirëpritur? "Ne kemi një marrëveshje me KFOR-in, ta quaj marrëveshje gjentelmene. Nuk është FSK-ja që të demonstrojë forcë, por është forcë që do të jetë e të

Në një ceremoni ushtarake, në prezencën e autoriteteve civile dhe ushtarake, në bazën Camp dodge, të Johnston, të shtetit të Iowa-s, është realizuar ceremonia parazbarkuese e grupit të parë 734 Regional Support Group të Gardës Kombëtare të IOWA pjesë e të cilit do jenë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare. Me këtë rast, në emër të Republikës së Kosovës, MM/FSK Kolonel Ilir Qeriqi, Atashe i Mbrojtjes në Ambasadën e Kosovës në SHBA iu drejtua me një fjalë rasti ushtarëve të rreshtuar në këtë ceremoni ku edhe prezantoi letrën e derguar nga KOMFSK Gjenerallejtenant Rahman Rama ku theksoi se partneriteti disavjeçar ka arritur pikën më të lartë të bashkëpunimit; si një mundësi unike e moment historik për FSK-në për të kontribuar në misionet paqeruajtëse përkrah Ushtrisë Amerikane. Ai ka shprehur mirënjohjen për mbështetjen në zhvillimin e kapaciteteve, që Ushtria Amerikane i ka dhënë FSK-së si dhe partneritetin strategjik.

Edhe Senatorja Amerikane znj. Joni Ernst dhe Gjenerali Corell, komandant i Gardës Kombëtare të Iowa-s, e kanë cilësuar si një moment historik dhe kanë vlerësuar lart bashkëpunimin disavjeçar ndërmjet Gardës Kombëtare të Iowa-s dhe FSK-së. I pranishëm në ceremoni ishte edhe z. Artan Duraku Konsull i Përgjithshëm në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Iowa-s. Republika e Kosovës, shprehë gatishmërinë më të lartë dhe njëkohësisht mbetet shumë falënderuese për mbështetjen e vazhdueshme dhe për

Në bazën Camp dodge, të Johnston, të shtetit të Iowa-s, SHBA

Moment historik: Ushtarët e FSK në angazhimin e parë ndërkombëtar

Forca e Sigurisë së Kosovës po kontribuon në ruajtjen e paqes dhe sigurisë botërore

mundësinë që i është dhënë FSK-së për të kontribuar në ruajtjen e paqes dhe sigurisë botërore.

Me kërkesë të Ministrisë së Mbrojtjes, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Vendimin për bashkë-dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë në misionin e parë paqeruajtës, jashtë vendit, si pjesë e Gardës Kombëtare të Iowa-s, sipas ftesës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kontingjenti i FSK-së jashtë vendit do të jetë pjesë e misionit në ofrimin e mbështetjes për stabilitet rajonal dhe operacione paqeruajtëse në regjionin e Komandës Qendrore Amerikane-U.S. Central Command (USCENTCOM). Krahas përkushtimit të vazhdueshëm për të avancuar aftësitë dhe kapacitetet operacionale, FSK po arrin sukseset e saj të mëdha edhe në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar duke fuqizuar në vazhdimësi subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. Besimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të përfshijë FSK-në në misionet ndërkombëtare paqeruajtëse, konfirmon edhe

njëherë përkrahjen për Kosovën duke e konsideruar si një faktor të rëndësishëm në ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon e kudo në Botë. Kosova mbetet e përkushtuar për bashkëpunimin me SHBA-në dhe partnerët strategjik në orientimet e saj euro-atlantike.

Në fjalën e tij, me 5 janar 2021, në seancën e Kuvendit të Republikës së Kosovës Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni, ndër të tjera theksoi: "...është një momentum shumë i veçantë për Kosovën, që përveç një mundësie historike ku FSK radhitet përkrah SHBA-ve dhe partnerëve strategjikë për të kontribuar në paqen dhe sigurinë në nivelin ndërkombëtar; njëkohësisht është sikur një reflektim që të shohim prapa dhe të shprehim falënderimin dhe mirënjohjen shumë të lartë për mbështetjen e pakushtuar nga të gjithë partnerët tanë, të cilët arritën në Kosovë, 20 vjet përpara, me të njëjtin mision, për të vendosur dhe ruajtur paqen dhe sigurinë në Kosovë".

gjithë qytetarëve të Kosovës dhe ne jemi duke punuar që mos të ketë rezistencë në veri dhe të mos ketë ndonjë situatë që mundet të keqkuptohet dhe të merret si ndonjë atak ndaj ndonjë komuniteti. Kështu që kemi një marrëveshje me KFOR-in për angazhim në veri dhe çdo herë nëse është e nevojshme ne në bashkëpunim me KFOR-in do të jemi në veri. E kuptojmë sensitivitetin dhe posaçërisht opinionin e krijuar në veri rreth FSK-së, dhe nuk kemi dëshirë të krijojmë përshtypje që prezencja jonë në veri do të atakojë ndonjë komunitet. Pra kjo kërkon kohë derisa të krijohet një besueshmëri e FSK-së në veriu e Kosovës ndonëse ne

i kemi kompetencat që të operojmë në tërë territorin e Kosovës", -thotë Anton Quni. Kohë më parë menjëherë pas miratimit të ligjit për FSK-në në kuvendin e Kosovës, u zhvillua një fushatë nga autoritetet e Serbisë që u kërkonin pjesëtarëve të komunitetit serb që të largohen nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Sipas ministrit në detyrë të FSK-së, Anton Quni, kjo ndikoi që disa pjesëtarë të largohen nga FSK. "Ka qenë një periudhë kur pjesëtarët e komunitetit serb në FSK, në forma të ndryshme kanë përjetuar presione dhe shantazhe të ndryshme nga Beogradi por edhe nga fqinjët e tyre serb këtu brenda Kosovës, ku rezultonte edhe me ar-

restime të tyre kur bënin kalime kufitare nga Kosova për në Serbi ku janë ndaluar edhe nga zyrtarët e policisë dhe shërbimi sekret serb. Një pjesë e këtyre pjesëtarëve u janë nënshtruar këtyre presioneve dhe kanë kërkuar që të lirohen nga detyra, por shumica prej tyre vazhdojnë të shërbejnë në FSK dhe janë lojalë ndaj kësaj trupe. Ne jemi deklaruar që në fillim kur është themeluar FSK, që së paku 10% e pjesëtarëve të saj të jenë nga pakicat kombëtare në Kosovë dhe këtu flasim për ngritjen e një force profesionale multietnike nga të gjithë qytetarët e Kosovës", -thotë Quni.



Në Kazermën "Adem Jashari" u organizua ceremonia e përmbylljes së vitit të dytë të tranzicionit të FSK-së. Në këtë ceremoni morën pjesë ministri i Mbrojtjes, z. Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjeneralleteniant Rahman Rama, drejtori i NALT-it, gjenerali Frank Best, gjeneralë dhe oficerë të lartë të FSK-së, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësues të NALT-it, atashe dhe këshilltarë ushtarak ndërkombëtar. Në fjalën e tij, ministri Quni, pasi përshëndeti të pranishmit dhe uroi për sukseset e arritura gjatë realizimit të planit dyvjeçar të tranzicionit të FSK-së, tha: "Sot shënojmë 2 vjetorin e lançimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, andaj ndjehem krenar dhe i privilegjuar, që si Ministër i Mbrojtjes të konstatoj se përgjatë kësaj periudhe kemi arritur që të realizojmë pjesën më të madhe të aktiviteteve për këtë periudhë planifikuese, e në disa fusha e komponentë, edhe t'i tejkalojmë ato". Më tej, ministri Quni, shtoi se: "Krahas këtyre sukseseve, brenda kësaj periudhe është avancuar sistemi i duhur i hartimit dhe zbatimit të politikave të mbrojtjes në fushën e planifikimit, programimit, modernizimit e standardizimit të forcave, bashkëpunimit ndërkombëtar e integrimi euroatlantike, inteligjencës dhe sigurisë, sistemit të integruar të burimeve materiale, infrastrukturave e mbështetjes logjistike".

Komandanti i FSK-së, gjen-



Ministria e Mbrojtjes dhe FSK

Mbyllet viti i dytë i tranzicionit të FSK-së

Nënshkruhen dokumentet Doktrimore që janë bazë e zhvillimit dhe ngritjes së kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

eralleteniant Rahman Rama, në fjalën e tij tha: "Kjo ditë shënon kalimin nga një fazë administrative, doktrinare dhe konceptuale në një fazë të ndërtimit të aftësive teknike, taktike dhe luftarake në nivel të njësisve operacionale. Konsideroj, që, pa marrë parasysh sfidat me të cilat jemi përballë, si: tërmeti në Shqipëri, pandemia globale, përmytjet dhe shkurtime e vazhdueshme buxhetore, ne kemi arritur që jo vetëm të përmbushim detyrat e parapara në këtë fazë, por edhe t'i tejkalojmë pritshmëritë tona". Ndërsa, drejtori i NALT-it, gjenerali Best, përgëzoi Ministrinë dhe FSK-në. "Ju përgëzoj për atë që është arritur deri më tani. Veçanë-

isht ju përgëzoj për qasjen tuaj transparente, angazhimin tuaj për mbikëqyrjen civile, qasjen tuaj multi-etnike dhe theksin mbi drejtësinë dhe sundimin e ligjit. Ishte një nder dhe gëzim për të gjithë ne, në NALT, t'iu ndihmojmë dhe t'iu këshillojmë mbi hapat e ndërmarrë me të gjitha mjetet dhe aftësitë që kemi në dispozicion. NALT-i do të vazhdojë të jetë në krahun tuaj. Ne do të qëndrojmë të përkushtuar ndaj mandatit tonë; për këshilla, lidhje dhe trajnime". Ceremonia u përmbyll me nënshkrimin e dokumenteve Doktrimore nga komandanti i FSK-së, gjeneralleteniant Rahman Rama, që janë bazë e zhvillimit dhe ngritjes së kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Forcat e kërkim-shpëtimit në ndihmë të banorëve nga përmbytjet

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), pas reshjeve të vazhdueshme dhe vërshimeve në gjithë territorin e Kosovës, me njësitet e specializuara për reagim në kriza, ekipet e kërkim-shpëtimit dhe të xhenios, u doli në ndihmë qytetarëve dhe institucioneve shtetërore në përballimin e situatës, me fokus të veçantë në shpëtimin e jetës së njerëzve. Pas vërshimeve të para, FSK-ja ka marrë masat për të vlerësuar situatën në terren, duke angazhuar Kompaninë për Operacione me Civilë, në nivel vendi. Janë pranuar kërkesat e para për mbështetje nga Komuna e Gjakovës, përmes Institucioneve Qeveritare për t'i mbështetur autoritetet civile, për zhvendosjen dhe strehimin e 55 qytetarëve në Aeroportin e Gjakovës. Në ditët në vazhdim, ekipet e kërkim-shpëtimit kanë intervenuar në fshatin Kuzmin të Fushë Kosovës, ku kanë shpëtuar 3 qytetarë në ngujuar në shtëpitë e tyre. Operacionet e FSK-së, kanë vazhduar edhe gjatë diteve të janarit, për t'iu dalë në ndihmë qytetarëve dhe institucioneve në përballimin e situatës emergjente. FSK-ja i ka dalë në ndihmë Policisë së Kosovës, në pengimin e përmbytjes së objektit të Forenzikës të Policisë së Kosovës, ku u angazhuan ekipet Xheniere të Gardës Kombëtare, gjithashtu kanë intervenuar edhe në Klinikën e Pulmologjisë në QKUK-së, ku kanë penguar përmbytjen e objektit. Njësitet e kërkim-shpëtimit në ujëra, gjatë ditës dhe natës kanë vepruar në rajonin e Drenasit, në fshatrat Poklek, Shtrubullojë e Komaran, ku kanë shpëtuar 43 qytetarë të ngujuar në shtëpitë e tyre. Ekipet

FSK, në gjendje gatishmërie 24 orë në 7 ditë të javës për të intervenuar me kapacitetet e saj operacionale, duke iu përgjigjur kërkesave që vijnë nga institucionet shtetërore



e kërkim-shpëtimit, kanë shpëtuar dhe evakuuar 3 banorë të fshatit Volljak të Klinës. Ekipet profesionale të FSK-së, kanë realizuar operacione të kërkim-shpëtimit edhe në komunën e Fushë Kosovës, Vushtrrisë dhe Prizrenit, ku kanë shpëtuar dhe evakuuar 16 persona. FSK-ja është në gjendje gatishmërie 24 orë në 7 ditë të javës për të intervenuar me kapacitetet e saj operacionale, duke iu përgjigjur kërkesave që vijnë nga institucionet shtetërore. Vërshimet kanë shkatërruar edhe infrastrukturën rrugore, ku janë dëmtuar disa

ura. FSK-ja me ekipet e Xhenios, kanë bërë vlerësimin e urës së dëmtuar në fshatin Dobroshec të Drenasit dhe urës në fshatin Hajnoc të Kamenicës, me qëllim të ngritjes së urave të lëvizshme të FSK-së për të mundësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve. Forca e Sigurisë së Kosovës është e përgatitur për t'iu dalë në ndihmë institucioneve të Kosovës, dhe të gjithë qytetarëve në raste të situatave emergjente si në kërkim-shpëtim në ujëra, male dhe kërkim-shpëtim urban.





SHTETET E BASHKUARA TË ANGAZHUAR PËR MBROJTJEN KOLEKTIVE

“Ky është fillimi i një kapitulli të ri për Aleancën transatlantike”

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg zhvilloi mbrëmjen e 26 janarit 2021, një bisedë telefonike me Joe Biden, Presidentin e Shteteve të Bashkuara. Ai e përgëzoi Presidentin për inaugurimin e tij, i cili ishte një demonstrim i fuqishëm i forcës së demokracisë së Amerikës dhe vlerave që ndajmë dhe fillimi i një kapitulli të ri për Aleancën tonë transatlantike.

Z. Stoltenberg përshëndeti fokusin e Presidentit Biden në rindërtimin e aleancave, duke theksuar se NATO është vendi ku evropianët dhe amerikanët takohen çdo ditë dhe se së bashku, ne mund të përballemi me sfida që askush nga kombet tona nuk mund të përballon vetëm. Ata ranë dakord të punojnë së bashku në përgatitjen e Samitit të NATO-s në Bruksel më vonë këtë vit, ku udhëheqësit do të marrin vendime për ta bërë Aleancën tonë të fortë edhe më të fortë.

Ata diskutuan një varg sfidash



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s bisedë telefonike me Presidentin e SHBA Biden

me të cilat përballen aleatët e NATO-s, të tilla si lufta kundër terrorizmit ndërkombëtar, përfshirë Afganistanin dhe Irakun, trajtimin e një Rusie më këmbëngulëse dhe adresimin e implikimeve për sigurinë tonë të ngritjes së Kinës. Ata gjithashtu pohan synimin e tyre për të punuar së bashku në sfida të tjera globale të tilla si ndryshimi i klimës dhe pandemia. Ata theksuan nevojën për të mbajtur vrullin për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes, për të mbajtur kombet tona të sigurta në një botë të paparashikueshme dhe të vazhdojnë të punojnë shumë ngushtë së bashku.

Shtëpia e Bardhë deklaroi nga ana e saj se Presidenti Joseph R. Biden, Jr bisedoi (26 janar 2021) me, Jens Stoltenberg, Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së

Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Presidenti falënderoi Sekretarin e Përgjithshëm për udhëheqjen e tij të palëkundur të Aleancës dhe përcolli qëllimin e tij për t'u konsultuar dhe punuar me aleatët në gamën e plotë të shqetësimeve të përbashkëta të sigurisë, duke përfshirë Afganistanin, Irakun dhe Rusinë. Presidenti Biden ripoi angazhimin e Shteteve të Bashkuara për mbrojtjen kolektive sipas Nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe nënvizoi angazhimin e tij për forcimin e sigurisë transatlantike. Presidenti theksoi gjithashtu rëndësinë e vlerave të përbashkëta, konsultimit dhe aftësive për të forcuar parandalimin dhe për t'iu kundërvënë kërcënimeve të reja dhe në zhvillim, duke përfshirë ndryshimin e klimës dhe sigurinë globale të shëndetit.

Gjenerali afro-amerikan Lloyd Austin, Sekretari i Mbrojtjes i SHBA-së

Senati amerikan konfirmoi javën që kaloi gjeneralin afro-amerikan në pension 67 vjecarin Lloyd Austin si Sekretar të ri të Mbrojtjes, i cili bëhet afro-amerikani i parë në këtë detyrë. Votimi përfundoi 93 me 2 në Senatin prej 100 anëtarësh, shumë më tepër sesa shumica e thjeshtë e kërkuar. "Gjenerali Austin ndan bindjen time të thellë se vendi ynë është më i fortë kur udhëheqim jo vetëm me shembullin e fuqisë sonë, por edhe me fuqinë e shembullit tonë. Përgjatë shërbimit të tij të dedikuar dhe për shumë kohë që kemi kaluar në Shtëpinë e Bardhë dhe me trupat tanë jashtë shtetit, Gjenerali Austin ka treguar udhëheqësi shembullore, karakter dhe komandë. Ai është tejet i kualifikuar për t'u përballur me sfidat dhe krizat që kemi aktualisht", - ka thënë presidenti i Amerikës, Joe Biden, në deklaratën e tij.

Presidenti i zgjedhur Biden e ka njohur gjeneralin që në periudhën kur udhëhoqte trupat amerikane dhe të koalicionit në Irak dhe zoti Biden ishte nënpresident.

Ndërkohë që vetë Austin në Twitter ka shkruar se e ka privilegj që të shërbejë si Sekretari i parë Afro-Amerikan në SHBA. "Është një nder dhe një privilegj të shërbej si Sekretari i 28 i Mbrojtjes i vendit tonë dhe unë jam veçanërisht krenar që jam afrikano-amerikani i parë që mbaj këtë pozitë. Le të shkojmë në punë," - ka shkruar Austin.

Menjëherë pas konfirmimit, zoti Austin bëri të premtën e javës që kaloi, më 22 janar 2021, një vizitë në Pentagon. Të enjten, të dyja dhomat e Kongresit ranë dakord të hiqnin një pengesë ligjore duke bërë të mundur që zoti Austin, i cili ka shërbyer si ish-komandant i forcave amerikane në Lindjen e Mesme dhe Azinë Jugore, të emërohej në postin civil pas më pak se shtatë vitesh prej largimit të tij nga ushtria. Administrata e zotit Biden njoftoi të



Presidenti amerikan Joe Biden: "Gjenerali Lloyd Austin është tejet i kualifikuar për t'u përballur me sfidat dhe krizat që kemi aktualisht"

enjten se do të kërkojë zgjatjen me pesë vjet të traktatit me Rusinë mbi kontrollit e armëve, të quajtur "New Start". Traktati, i cili i kufizon Shtetet e Bashkuara dhe Rusinë duke u përcaktuar të dislokojnë jo më shumë se 1,550 armë me mbushje bërthamore si dhe u vendos kufizime në dislokimin e sistemeve të mbrotjes nga raketat, pritet të skadojë në muajin shkurt.

Lloyd Austin ka lindur më 8 gusht 1953 në Alabama dhe u rrit në Thomasville, Georgia. Ai ka shërbyer si ushtarak për 41 vjet. Ai u diplomua në Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara (West Point) me një diplomë Bachelor të Shkencave në 1975, ku ai ishte komandanti i kompanisë i G1. Më vonë fitoi një diplomë Master i Arteve në arsimin si këshilltar nga Kolegji i Edukimit i Universitetit Auburn në 1986 dhe një Master në Administrim

Biznesi për menaxhim biznesi nga Universiteti Webster në 1989. Ai është i diplomuar në kurse themelore dhe të përparuara: Oficeri i Këmbësorisë, Kolegji i Komandës e Shtabit të Përgjithshëm dhe Kolegji i Luftës së Ushtrisë.

Gjenerali Lloyd Austin, ushtaraku i lartë me katër yje, shërbeu në 2012 si i pari afrikano-amerikan që bëhej zëvendës shef i shtabit të ushtrisë. Një vit më pas, ai u vu në krye të Komandës Qendrore Amerikane ku filloi të hartonte dhe zbatonte strategjinë ushtarake amerikane për të sprapsur ekstremistët e Shtetit Islamik në Irak dhe Siri. Ai doli në pension në 2016 pas 41 vitesh në ushtri dhe sic shkruan New York Times "është shumë i respektuar në të gjithë Ushtrinë". Gjatë këtyre viteve ka shërbyer në bordet e Raytheon Technologies, Nucor dhe Tenet Healthcare.





NGA FRANK SHKRELI

Një kapitull i ri për Aleancën Transatlantike NATO

Ditën e betimit të Presidentit të ri të Shteteve të Bashkuara, Z. Joe Biden dhe Zëvendës presidentes Kamala Harris, më 20 Janar, 2021, Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës Transatlantike, NATO, Z. Jens Stoltenberg, në emër të Aleancës që ai drejton, uroi udhëheqsit e ri të Amerikës, duke u shprehur se, "Kjo ditë shënon një kapitull të ri për Aleancën transatlantike."

"Lidhja midis Amerikës së Veriut dhe Evropës është gurthemeli i sigurisë sonë dhe një NATO e fortë është mirë si për Amerikën e Veriut ashtu edhe për Evropën. Për më shumë se 70-vjet, Aleanca jonë transatlantike ka garantuar lirinë, paqën dhe sigurinë për popujt tanë. Udhëheqja e SHBA në NATO i ka shkruar Sekretari i Përgjithshëm, Z. Jens Stoltenberg, Presidentit Joe Biden, "Mbetet thelbësore, ndërsa punojmë së bashku për të mbrojtur demokracinë tona, vlerat tona të përbashkëta dhe rendin ndërkombëtar, të bazuar në rregulla dhe ligje." Në letrën e tij, drejtuari Shefit të ri të Shtëpisë së Bardhë, me rastin e inaugurimit të tij presidenti i Amerikës, udhëheqsi i NATO-s përmendi disa prej sfidave me të cilat përballen, së bashku, aleatët e kësaj organizate ushtarake, sfida siç janë kërcënimi që paraqet Kina ndaj sigurisë botërore, terrorizmi, gjendja në Rusi, në Afganistan dhe në Irak.

"Askush prej nesh nuk mund të përballen me këto sfida vetëm, por së bashku në NATO, ne përfaqësojmë një miliard njerëz dhe gjysmën e fuqisë ushtarake dhe ekonomike të botës. Kështuqë, unë pres që të bashkëpunoj ngushtë me Presidentin Biden dhe ta mirëpres atë në Samitin e NATO-s në Bruksel më vonë këtë vit", përqëndrimi i të cilit do të jetë nisma "NATO-2030", me qëllim për ta bërë Aleancën tonë edhe më të fortë dhe më të aftë për tu përballur

me problemet në të ardhmen, është shprehur Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Z. Stoltenberg në urimin e tij drejtuar Presidentit të ri të Shteteve të Bashkuara, Z. Joe Biden.

Siç duket, në një përpjekje për të siguruar pa vonesë aleatët e NATO-s për mbështetjen serioze të administratës së re amerikane ndaj Aleancës ushtarake transatlantike, edhe Sekretari i ri i Mbrojtjes në kabinetin e Presidentit Biden, Z. Lloyd J. Austin III, nuk humbi asnjë minutë, por me të arrijtur në Pentagon, ditën që emërimi i tij u miratua nga Senati, telefonata e tij e parë drejtuar një udhëheqsi botëror ishte biseda me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Z. Stoltenberg, për të rithekësuar rëndësinë që Shtetet e Bashkuara i kushtojnë Aleancës NATO.

Sipas një njoftimi nga Zyra e shtypit e Pentagonit, të dy udhëheqësit e lartë ushtarakë biseduan për rëndësinë e mbrojtjes së vlerave të përbashkëta, mbi gjëndjen aktuale të sigurisë në botë, mbi përpjekjet për të pasur një NATO të fortë në të ardhmen dhe mbi misionet e vazhdueshme të Aleancës në Irak dhe në Afganistan.

Më vonë, udhëheqësi i Pentagonit, Z. Lloyd J. Austin III zhvilloi gjithashtu një bisedë telefonike edhe me Ministrin britanik të Mbrojtjes, Z. Ben Wallace. Sipas Pentagonit, dy zyrtarët e lartë të mbrojtjes amerikane dhe britanike, "rithekësuan rëndësinë e marrëdhënive të veçanta midis dy vendeve tona" dhe shkëmbyen mendime mbi përballimin me çështjet strategjike të interesit të përbashkët, përfshirë kërcënimet nga Kina dhe Rusia.

Dy ditë para inaugurimit të Presidentit Joe Biden në Washington, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Z. Jens Stoltenberg në një takim virtual në Paris ka folur për të ardhmen e NATO-s dhe për marrëdhëniet midis NATO-s dhe Amerikës-ndërsa është shprehur se, "NATO është e vetmja organizatë ku Evropa dhe Amerika Veriore bashkohen çdo ditë", duke shtuar se kjo aleancë, "përbën një platformë unike", e cila përdoret për të biseduar mbi çështje që i përkasin sigurisë së përbashkët në përgjithësi, çështje me të cilat-sipas Sekretarit

të Përgjithshëm të NATO-s, Z. Stoltenberg: "As Amerika, as Evropa nuk mund të përballen vetëm", me këto sfida pasi janë çështje që as njëra palë vetëm nuk mund t'i zgjidhin në mënyrë të kënaqëshme, pa bashkëpunim dhe bashkërendim me njëra tjetrën. Sikur të dy palët donin të theksonin për botën rëndësinë e këtij bashkëpunimi dhe hapjen e një kapitulli të ri në marrëdhëniet midis Washingtonit dhe NATO-s, njoftohet se sot Presidenti Joe Biden dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s zhvilluan një bisedë telefonike.

Jam i bindur se Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Z. Stoltenberg e di se Presidenti Joe Biden është një mbështetës i vjetër i Aleancës ushtarake NATO, si due i lidhjeve të ngushta të kësaj aleance me Shtetet e Bashkuara dhe të lidhjeve transatlantike në përgjithësi midis Shteteve të Bashkuara dhe Evropës. Ekspertët besojnë se pas katër vjetë marrëdhëniesh të ftohta midis ish-administratës Trump dhe NATO-s, administrata e re në Washington e kryesuar nga Presidenti Biden pritet që të bashkëpunojë ngushtë me Sekretarin Stoltenberg dhe me NATO-n, në përgjithësi, për të forcuar mëtej lidhjet midis Amerikës veriore dhe Evropës. Gatishmëria nga të dy palët, për hapjen e një kapitulli të ri në marrëdhëniet midis NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara, vihet re nga komunikimet tepër të ngrohta dhe të sinqerta të ditëve të para midis udhëheqësve më të lartë të administratës së re në Washington dhe Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Z. Jens Stoltenberg.

Ndoshta është e tepërt të thuhet se marrëdhëniet e ngushta midis Shteteve të Bashkuara dhe NATO-s janë edhe në interesin e Shqipërisë, si anëtare e NATO-s, por edhe në interesin e Kosovës që aspiron antarësimin eventual në NATO. Lidhjet e forta midis Washingtonit dhe NATO-s janë jetike edhe për interesat shqiptare në përgjithësi përfshirë sigurinë due lirinë e tyre-kur të merret parasysh ndërhyrja e kësaj organizate ushtarake e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara-për herë të parë në historinë e saj-në luftën kundër Serbisë për të çliruar Kosovën.


NATO dhe sfida 5G

Përgatiti: MSC MIMOZA GOLIKJA

Polemika për teknologjinë 5G erdhi në qendër të vëmendjes në fillim të vitit 2019. Shumë aleatë u shqetësuan për sigurinë e komunikimeve të ardhshme tregtare dhe ushtarake brenda Aleancës, kryesisht, por jo vetëm, për shkak të rreziqeve të paraqitura nga furnizuesit jo aleatë. Pas muajsh diskutimesh dhe debatesh, udhëheqësit e NATO-s që u takuan në Londër në dhjetor 2019 theksuan rëndësinë e "sigurisë së komunikimit, duke përfshirë 5G" dhe njohën "nevojën për t'u mbështetur në sisteme të sigurta dhe elastike". Andrea Gilli që është Studiues i Lartë në Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s, ku ai punon për çështje që lidhen me ndryshimet teknologjike dhe inovacionin ushtarak, për NDC, kohët e fundit, botoi një Brief Policy mbi NATO dhe 5G në të cilën ai diskuton çështjen në thellësi më të madhe duke shprehur pikpamjet e tij. Po kështu edhe Francesco Bechis, një anëtar i ri në Fondazione De Gasperi në Romë dhe gazetar në Formiche, ku ai mbulon marrëdhëniet transatlantike, si dhe çështjet e mbrojtjes dhe inteligjencës ka kënvështrimin e tij lidhur me NATO-n dhe sfidat e 5G.

Çfarë është 5G?

5G është gjenerata e pestë në komunikimet mobile. Në vitet 1980, 1G aktivizoi thirrjet zanore; me-sazhet mbërritën me 2G në vitet 1990; 3G solli multimedial, tekst dhe të dhëna të kufizuara në internet



në vitet 1990 dhe fillimin e viteve 2000; dhe, në fund të viteve 2000, të dhënat e vërteta me qasje në informacionin dinamik duke përdorur pajisje të ndryshme u mundësuan nga 4G dhe LTE (olution Evolucioni Afatgjatë), një standard për përmirësimin e shpejtësive pa tel të brezit të gjerë për të përmbushur kërkesën në rritje). Me ardhjen e rrjeteve 5G, komunikimet mobile do të shndërrohen në një model rrënjësisht të ndryshëm të përqendruar në dendësi të lartë, vëllim të madh, shpejtësi jashtëzakonisht të lartë (20x), vonesë të ulët ose vonesë në transferimin e të dhënave (10x) dhe efikasitet të energjisë. Nga komunikimet e celularëve në celular siç janë të mbështesë jo vetëm bisedat me zë dhe dixhital, por edhe ndarjen masive të të dhënave telefoni në telefon, 5G do të mundësojë kalimin në komunikimet makinë në makinë.

Kjo do të ndodhë në kohë reale, e cila karakterizon internetin e gjërave, telemjekësinë, drejtimin e qyteteve inteligjente, si dhe performancën e makinave autonome.

Pse 5G doli në qendër të vëmendjes në 2019?

Ndërsa komunikimet 5G u bënë një çështje e debatuar ashpër publike dhe politike në fillim të vitit 2019, rruga për në 5G filloi vite më parë falë përparimit në teknologji si dhe marrëveshjeve shumëpalëshe të standardizimit. Përparimi teknologjik përfshin ndryshime në modelimin e të gjithë rrjetit, të cilat lejojnë rritjen e efikasitetit spektral përmes rrugëve të shumta të sinjalit (MIMO: Multiple Input, Multiple Output). Përparimi në inxhinierinë elektromagnetike mundëson transmetimin efikas të të dhënave shumë elastike ndaj

reflektimit dhe ndërhyrjeve (formimi i rrezeve dhe OFDM: multipleksimi ortogonal i ndarjes së frekuencës). Përparimet në softuer ndihmojnë në ofrimin e një cilësie më të mirë të komunikimeve duke përdorur algoritme si në origjinal ashtu edhe në rrjedhën e të dhënave të marra (kodimi polar). Marrëveshjet për standardet dhe çështjet teknike të arritura në forume të ndryshme-përfshirë Kongresin Botëror të Mobile të organizuar nga Sistemi Global për Shoqatën e Komunikimeve Mobile dhe në Bashkimin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit-i mundësuan të gjithë ekosistemit industrial të shkojë përpara në mënyrë kolektive. Si rezultat, deri në fund të tetorit 2019, 50 operatorë celularë kishin nisur shërbime komerciale 5G në 27 vende. Për më tepër, midis 2018 dhe 2019, disa vende evropiane duke përfshirë Finlandën, Italinë dhe Spanjën mbajtën ankande të spektrit me shumë banda 5G - hapi kryesor për hapjen e rrjeteve 5G.

Pse ka rëndësi?

Katër arsye kryesore në lidhje me telekomunikacionin qëndrojnë në themel të vëmendjes së shtuar ndaj 5G. Së pari, telekomunikacioni është duke folur gjerësisht për një teknologji mundësuese, e cila mund të çojë rritjen ekonomike në të gjithë ekonominë. Modelet e parashikimit parashikojnë për shembull se rrjetet 5G do të shtojnë trilionat dollarë me vlerë ekonomike në ekonominë ndërkombëtare. Ashtu si 4G lëshoi një valë të madhe të transformimit teknologjik - nga iPhone dhe Google maps në Instagram dhe Whatsapp përmes Uber dhe Snapchat - rrjetet 5G pritet të japin efekte të ngjashme. Së dyti, telekomunikacioni zakonisht dominohet nga një avantazh i lëvizësit të parë: hyrësit e hershëm mund të marrin vlera të mëdha ekonomike, duke lënë pak hapësirë për konkurrentët. Aktorët - nga kompani në vende - kanë një nxitje të fortë për të konsoliduar pozicionin e tyre dhe për të maksimizuar kthimet ekonomike. Së treti, telekomunikacioni mbart një dimension strategjik: shpejtësia, cilësia dhe sasia e informacionit janë thelbësore për të konkurruar në botën dixhitale. Përfundimisht, duke pasur parasysh qëndrueshmërinë e informacionit në

ekonomitë moderne, telekomunikacioni konsiderohet gjerësisht dhe me të drejtë konsiderohet një industri strategjike. Kompanitë transferojnë informacione private, dhe shpesh të ndryshme të të dhënave, përfshirë materialin e klasifikuar. "Telekomunikacioni i gjeneratës së ardhshme do të ndikojë në çdo aspekt të shoqërisë, nga transporti te kujdesi shëndetësor, si dhe operacionet tona ushtarake", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në Takimin e Ministrave të Mbrotjtjes në Bruksel më 25 tetor 2019.

5G dhe Kina

Një tjetër arsye e rëndësishme që 5G ka tërhequr vëmendje të veçantë është se lojtarët kryesorë në këtë teknologji nuk janë kompanitë perëndimore, japoneze ose koreano-jugore por më tepër kompani me bazë në Kinë si Huawei dhe ZTE.

Disa faktorë shpjegojnë rritjen e operatorëve kinezë në këtë fushë. Njëra është ekspertiza dhe përvoja që ata fituan me ofertën e tyre të dështuar për të hyrë në konkurrencën 3G mbi një dekadë më parë. Pas kësaj, qeveria kineze filloi investime të mëdha publike në këtë fushë dhe zhvilloi një strategji koherente, ndërsa kompanitë private kryen kërkime dhe patentuan teknologjitë e tyre themelore. Kompanitë kineze gjithashtu gëzojnë një avantazh konkurrues, veçanërisht kur i afrohen tregjeve të huaja në 5G: në vend, ato mund të mbështeten në një disponueshmëri të gjerë të fibrave, vendosje të mëdha të qelizave të vogla, një disponueshmëri më të lartë të spektrit në brezat me frekuencë të ulët dhe pjekurinë e 4G, si dhe një treg i jashtëzakonshëm i brendshëm dhe kosto të ulët të prodhimit. Kompanitë kineze, japoneze dhe koreano-jugore kanë luajtur prej kohësh një rol të rëndësishëm në tregjet e telekomunikacionit në të gjithë botën. Në fakt, Huawei dhe ZTE nga Kina, si dhe Nec (Japoni) ose Samsung (Koreja e Jugut) janë furnizuesit kryesorë në rrjetet aktuale 4G. Sidoqoftë, roli i kompanive kineze në komunikimet 5G ka një konotacion shumë të ndryshëm. Me 5G, që përfshin komunikime masive makinë me makinë, mbrojtja kibernetike

rrethore nuk do të jetë më efektive pasi do të jetë e pamundur të jepet hyrje ekskluzivisht në pajisjet e autorizuara. Si rezultat, rreziku dhe ashpërsia e mundshme e sulmeve rriten në mënyrë eksponenciale. Gjithashtu, roli më i rëndësishëm i softuerit në virtualizimin e rrjetit do t'u japë integruarve të pajisjeve (d.m.th. kompani potencialisht kineze) hyrje më të gjerë dhe më të thellë në operacionet e rrjetit (d.m.th. të dhëna), duke ngritur kështu pyetje serioze në lidhje me besimin dhe besueshmërinë. Me fjalë të tjera, ndryshimet në teknologji kanë implikime të rënda politike, veçanërisht sepse kompanitë kineze kanë lidhje të drejtpërdrejta politike me qeverinë e tyre, përfshirë edhe komunitetin e inteligjencës. Politika e brendshme e të dhënave të mëdha të Kinës, bazuar në mbikëqyrjen masive dhe privatësinë e kufizuar, është në kundërshtim me sistemet e vlerave, etikës dhe ligjit të vendeve të tjera. Dhe së fundmi, kompanitë kineze janë akuzuar vazhdimisht në vitet e fundit për vjedhje të pronës intelektuale dhe përdorim të spiunazhit kibernetik për të hyrë në informacionin e pronarit. Testet në pajisjet elektronike kineze shpesh kanë zbuluar gjithashtu dobësi të sigurisë, duke përfshirë dyer të pasme që mund të çojnë në transferimin e drejtpërdrejtë të të dhënave në Kinë.

Aleatët e NATO-s dhe 5G

Deri në dhjetorin e kaluar, NATO nuk kishte marrë asnjë qëndrim në lidhje me komunikimet 5G. Edhe pas Takimit të Udhëheqësve në Londër, asnjë politikë ose pozicion i vetëm nuk është shfaqur me të vërtetë. Duke parë përgjigjen e aleatëve, mund të identifikojmë pesë grupe kryesore: të interesuarit, ligjvënësit, të pavendosurit, skeptikët dhe adoptuesit e hershëm.

Të interesuarit

Deri më sot, Shtetet e Bashkuara janë i vetmi vend i NATO-s që ka ndërmarrë hapa efektive për të kufizuar hyrjen në rrjetin e saj 5G nga kompanitë kineze si Huawei ose ZTE. E rëndësishmja, megjithatë, ndalimi i administratës amerikane i shpallur në maj 2019 nuk ka hyrë ende në fuqi për shkak të zgjatjeve

90-ditore që janë rinovuar katër herë. Kongresi ka miratuar disa projektligje me konsensus të gjerë dypartiak, të tilla si i ashtuquajti "akti gris dhe zëvendëso" (nënshkruar nga ligji nga Presidenti Trump në Mars 2020), të cilat detyrojnë Huawei dhe kompani të tjera kineze të qëndrojnë në kontrolle më të rrepta të sigurisë raste të tjera, mbështesin kompanitë perëndimore në konkursin 5G. Në të njëjtat linja, në maj të vitit 2020, Departamenti i Tregtisë i SH.B.A. - së njoftoi një ndryshim në Listën e saj të Entitetit, duke e nënshtruar Huawei-në ndaj kërkesave individuale të licencimit për eksportet. Duke synuar blerjen e gjysmëpërçuesve nga Huawei, vendimi synon të kufizojë rëndë konkurrencën e kompanisë. Huawei përfundimisht konfirmoi se një ndryshim i tillë do të vinte në rrezik mbijetesën e tij. Në mënyrë të ngjashme, Departamenti i Shtetit i ShBA filloi "5G Clean rrjetet", një plan për vendosjen e një "rruge të pastër" për aleatët e Shteteve të Bashkuara për të përjashtuar shitësit kinezë nga rrjetet e tyre.

Ligjvënësit

Disa aleatë, të tillë si Italia, nuk kanë vendosur ndalim për prodhuesit kinezë të pajisjeve 5G por tashmë janë zotuar për rregullore më të rrepta. Në fund të vitit 2019, qeveria italiane miratoi një ligj që krijon një "Perimetër Kombëtar të Sigurisë Kibernetike" i cili nga ana e tij prezantoi rregulla dhe procedura më të rrepta për të vlerësuar sigurinë e pajisjeve 5G. Gjermania përshtatet në të njëjtën kategori. Pavarësisht nga një debat i pasionuar i brendshëm, Qeveria Federale nuk pritet të ndalojë kompanitë kineze nga rrjeti i saj 5G. Deutsche Telekom tashmë ka njoftuar se do të vazhdojë të punojë me ofruesit kinezë 5G.

Të pavendosurit

pozicionet e disa vendeve të NATO-s kanë evoluuar me kalimin e kohës, duke miratuar në mënyrë progresive një qëndrim më të rreptë.

Republika Çeke nënshkroi një deklaratë të përbashkët me Shtetet

e Bashkuara për sigurinë 5G në 6 maj 2020, duke deklaruar qëllimin "për të forcuar bashkëpunimin tonë në 5G" dhe për të përcaktuar nëse rrjeti është "subjekt, pa rishikim të pavarur gjyqësor, ndaj ndikimit të huaj të padrejtë". Në mënyrë të ngjashme, pas një faze fillestare vlerësimi në janar 2020, qeveria greke ngadalësoi vendosjen e infrastrukturës 5G për shkak të "sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së infrastrukturës kritike të vendit". Mbretëria e Bashkuar është një shembull tjetër. Fillimisht, në janar 2020, qeveria britanike njoftoi një mbulim prej 35 përqind për pjesëmarrjen e Huawei në "pjesën jothelbësore" të rrjetit 5G, ndërsa e ndalon atë plotësisht nga "pjesa thelbësore". Më vonë, në maj të vitit 2020, Downing Street miratoi një pozicion tjetër, duke propozuar një "Klub 5G" me 10 demokraci (vendet e G7 së bashku me Australinë, Indinë dhe Korenë e Jugut) për të krijuar furnizues alternativë të pajisjeve 5G dhe teknologjive të tjera për të shmangur mbështetjen në Kinë.

Skeptikët

Shumica dërrmuese e aleatëve nuk kanë ndaluar ose kufizuar rolin e kompanive kineze në infrastrukturën e tyre 5G. Në Francë, për shembull, Orange dhe Vodafone tashmë zgjedhën Ericsson (Suedi) dhe Nokia (Finlandë) për rrjetet e tyre 5G. Sidoqoftë, të dy qeveria dhe komuniteti i inteligjencës kanë sinjalizuar se ata nuk shohin ndonjë arsye të vlefshme për të përjashtuar ofruesit e tjerë të huaj. Në mënyrë të ngjashme, qeveria belge njoftoi se do të vendoste kufizime vetëm për "furnizuesit jo të besueshëm". Aleatë të tjerë, të tillë si Kanadaja, deri më tani nuk kanë marrë asnjë vendim për kompanitë kineze.

Adoptuesit e hershëm

Më në fund, një grup tjetër i vendeve kanë miratuar tashmë teknologjinë kineze 5G dhe, duke pasur parasysh kostot e larta të zëvendësimit të infrastrukturës, nuk ka gjasa të tërhiqen. Brenda NATO-s, këto janë Hungaria dhe Spanja. Sidoqoftë, disa adoptues të hershëm, megjithëse nuk janë vende të NATO-s, janë të rëndë-

sishëm për Aleancën ose disa prej aleatëve të saj. Në Evropë, këto përfshijnë Irlandën, një anëtare të BE-së, dhe Serbinë, një anëtar i ardhshëm i mundshëm i BE-së dhe Zvicra. Midis Shteteve të Gjirit, shembuj të tjerë janë Bahreini, Kuvajti, Omani, Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, të cilat në shkallë të ndryshme presin baza ushtarake ose personel të aleatëve të ndryshëm të NATO-s. Në Azi, Indonezia dhe Filipinet janë ndër vendet që kanë adoptuar teknologjinë 5G të Huawei.

Ku tjetër?

Diskutimi për 5G do të vazhdojë në muajt dhe vitet e ardhshme, dhe çështja ka të ngjarë të marrë më shumë rëndësi pasi komunikimet ushtarake fillojnë të kalojnë në 5G. Në të ardhmen, veçanërisht për NATO-n, do të jetë me rëndësi qendrore të shfrytëzohen këto mundësi të reja teknologjike për komandimin dhe kontrollin, komunikimet, si dhe për qëllime të tjera. Pa komunikime 5G, do të jetë e vështirë të shfrytëzohen plotësisht të dhënat e mëdha, inteligjenca artificiale dhe informatika cloud në fushën e betejës.

"Është e rëndësishme që të gjithë aleatët të jenë të rrjedhshëm me diskutimin dhe të kuptojnë implikimet e këtij tranzicioni: në nivelet ekonomike, politike dhe ushtarake. Kjo është e nevojshme për të siguruar ofrimin e trajnimit, si dhe zhvillimin e koncepteve të reja të operacioneve dhe ndryshimet e duhura në prokurimin dhe strukturën e forcës. Në të njëjtën kohë, debati duhet të informohet nga konsiderata të shëndosha teknike, ekonomike dhe strategjike (përfshirë kohezionin brenda Aleancës). Për këtë arsye, arkitekturat modulare, në të cilat ndërfaqet e hapura mundësojnë që pajisjet nga shitës të ndryshëm të integrohen së bashku, mund të bëhen një mundësi e vlefshme në vitet në vijim për të pajtuar kërkesat dhe konsideratat e ndryshme. Pa një lojtar të vetëm dominant, kjo zgjidhje mund t'i lejojë aleatët të arrijnë sigurinë pa cenuar efikasitetin e tyre ekonomik, të kenë qasje në një rrjet komunikimi efektiv dhe elastik pa ndërprerje të furnizimit".

Dëshmorët e ditës së parë të pushtimit dhe ditës së parë të LANÇ-it

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Durrësi i lashtësisë, i historisë, i qytetërimit dhe kulturës shqiptare ka përjetuar edhe ditë pushtimi, sikurse e premtja e zezë të 7 Prillit 1939. Shqipëria u sulmua pabesisht nga Italia fashiste. Ishte pikërisht vendi që sipas marrëveshjes së pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve (me 58 vende antare) në vitin 1921 ishte "vendi garant" për pavarësinë e Shqipërisë. Italia jo vetëm që nuk përmbushi as vendosjen e paqes, as korrigjoi parregullsitë, por e çoi edhe më thellë problemin me agresionin fashist të 7 prillit, që kërkonte vendosjen e varësisë politike, ekonomike dhe ushtarake të Shqipërisë ndaj Italisë, që në fakt ishte një realitet që kishte ndodhur sa nga domosdoshmëria e shtetit shqiptar për të mbijetuar ekonomikisht, por dhe nga nevoja e klasës udhëheqëse shqiptare të kohës që kërkonte të gjente përkrahje nga Italia. Dhe Italia erdhi, por me trupa ushtarake, sepse i kishte ngelur "daramet" që më 1920-tën. Por djemtë e popullit ishin patriotë dhe atdhetarë që me pushkë kishin pritur çdo pushtues, që dinin "t'ua skuqnin kokën" pushtuesit. Prandaj ata nuk e kursyen gjakun edhe këtë herë. Prandaj edhe sheshi i parë i pushtimit, skela e Durrësit do të skuqej nga gjaku që në genin arbëror rronte zgjuar liria dhe antifashizmi. Dëshmorët e Atdheut të rënë në ditën e parë të LANÇ-it, në Durrës janë: Mujo Ismail Cakuli (Ulqinaku) (1896-7.4.1939) shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim nr. 1749 datë 9.9.1946; Hamdi Liko Dollani (1903 Jançë-Sulovë, Gramsh-1939 Durrës) shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim nr. 36 datë 9.5.1974; Haxhi Mustafa Tabaku (1909 Durrës-1939 Durrës) shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim nr. 212 datë 17.10.1981; Ismail Isuf Reçi (1917 Krujë-1939 Durrës) shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim nr. 194 datë 23.07.1984; Ramazan Halil Velia (1915 Homesh, Dibër-1939 Durrës) shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim nr. 50 datë 30.06.1972; Hamit Selman Veshko (1917 Gumenicë, Vlorë-1939) shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim nr. 97 datë 22.9.1972; (vlarë tek Skela dhe tek shkolla e marinës ka pasur edhe një pllakatë); Isak Selim Metalia (1878 Strikçan, Dibër-1939 Durrës) shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim nr. 50 datë 30.06.1972; Ibrahim Ramë Osmani (1918 Bllacë, Dibër-1939 Durrës) shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim nr. 50 datë 30.06.1972; Hysen Koçi (Kallço) (Durrës) shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim të ish-komitetit Ekzekutiv të Këshillit popullor. Ndërsa nga Saranda, Berati e Shkodra kanë rënë në fushën e nderit: Mitro Vaso Dhimërtika (1915 Nivicë Sarandë-1939 Sarandë), shpallur dëshmor i

Kushtuar dëshmorëve të Atdheut të rënë në ditën e parë të LANÇ-it, më 7 prill 1939 në Durrës dhe të dokumentuar në arkivat shqiptare, por edhe në librin zyrtar të dëshmorëve: Mujo Ismail Cakulli (Ulqinaku), Hamit Liko Dollani, Haxhi Mustafa Tabaku, Hysen Koçi (Kallço), Isak Selim Metalia, Ramazan Halil Velia, Ismail Isuf Reçi, Ibrahim Ramë Osmani, si dhe dëshmorëve Hamit Veshko (Vlorë), Mitro Vaso Dhimërtika (Sarandë), Tonç Gjon Toma (Shkodër), Zenel Abedin Bllana (Berat), Izet Hysen Shahu (Ersekë)

Atdheut me vendim nr. 166 datë 27.12.1977; Zenel Abedin Bllana (1905 Mbolan, Berat-1939 Breshovë, Berat), shpallur "Dëshmor" me vendim nr. 110 datë 16.12.1972), Tonç Gjon Toma (1913 Shkodër-1939 Shkodër), shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim nr. 139 datë 3.4.1993, Izet Hysen Shahu (1897, Kozel-1939, Ersekë) 42 vjeçar shpallur dëshmor me Vendim të Komisionit Qendror të statusit "Dëshmor i Atdheut" nr. 44 datë 30.12.2004. Që të gjithë ranë për Atdhe në ditën e parë të LANÇ-it që është dhe dita e parë e Luftës Antifashiste europiane, që historia i ka dokumentuar si të rënë e parë antifashistë në Shqipëri por këta janë edhe dëshmorët e parë europianë. Moshë mesatare e tetë dëshmorëve të rënë në Durrës në ditën e parë të pushtimit ishte mjaft e re. Nga tetë dëshmorë, që ranë në Durrës, një ishte nga Ulqini, një nga Kruja, një nga Gramshi, një nga Vlora, dy nga Durrësi, tre dibranë, punëtori Isak Metalia 61 vjeçar, Ibrahim Osmani 21 vjeç dhe Ramazan Velia 24 vjeç. Isak Metalia nga Strikçani i Dibrës kishte lënë në fshat tre fëmijë dhe gruan e tij dhe prej vitesh punonte si hamall në Portin e Durrësit. Më 7 prill u rindez sërish kënga patriotike: "O djem nrëmbeni pushkët/ Ja vdekje, ja liri..." dhe "armë, armë..." ishte refreni i ditës. Isak Metalia u deklaroi shokëve: "Unë e kam nda mendjen me luftue, për vendin tim. U thoni fëmijëve të mi se vdiqa për Shqipërinë", që ishin edhe fjalët e tij para se të ndërronte jetë. Ideat e tyre atdhetare u quajtën ashtu sikurse ishin në të vërtetë të shenjtëruara dhe u përmbushën me fitoren e luftës nga partizanët shqiptarë, që u renditën në anën e duhur të historisë, me amerikanët, britanikët e rusët, që bënë të përgjunj fashizmi dhe nazizmi dhe bota të merrte frymë e lehtësuar. Për këtë tematikë të ditës së parë të luftës kanë shkruar mjaft autorë si: Arben Puto, Bernd Fischer, Moikom Zeqo, Pëllumb Xhufi, Xhevdet Shehu, Gjergj



Velo, Dalan Buxheli, Bernard Zotaj, Dorian Koçi, Blerim Kore, Abedin Bici, Merenglen Kasmi, Bashkim Qeli, Bardhosh Gaçe, Skënder Spahiu, Izet Shahu, Thanas Gjika si dhe studiues, historianë e gazetarë të tjerë.

Pushtimi që paralajmëroi fillimin e Luftës së Dytë Botërore

Më 7 Prill 1939, rreth orës 4:30 nisi sulmi ushtarak për pushtimin e Shqipërisë. Kronikat e kohës flasin që rreth 40 mijë trupa ushtarake, 400 aeroplanë lufte, 300 tanke të lehtë, 173 luftëanije, të cilat sulmuan në katër drejtime strategjike: Durrës, Vlorë, Shëngjin dhe Sarandë. Drejtimi kryesor i mësymjes u përqendrua me më shumë trupa nga qyteti i Durrësit si një qytet strategjik nga ku mund të kalonin më me lehtësi trupat e tjera që do të zbarkonin më vonë, por edhe se kryeqyteti, Tirana, ishte pak km larg Durrësit. Italianët pushtues me zjarr dhe hekur u përpoqën të nënshtrojnë shqiptarët për herë të dytë brenda një shekulli, por edhe këtë qëllim se arritën asnjëherë. Qyteti i Durrësit me luftën e tij hyri në analet e historisë si vendi i parë në Evropë që luftoi dhemb për dhemb me pushtuesit fashiste dhe që i dha edhe Evropës dëshmorët e parë të kësaj lufte. Por rezistencë pati edhe në gjithë bregdetin e qyteteve të tjera. Shqiptarët nuk e kishin humbur tiparin themelor të mbrojtjes së identitetit dhe lirinë, por nga ana tjetër Benito Musolini në mënyrë ironike do shprehej: "Nuk e meriton lirinë një popull, që nuk është gati të vdesë për të!". Por Duçja do ta provonte në shtatorin e 1943-shit se "sa i vllente lëkura". Shqiptarët, nuk ishin sikurse deklaronte Musolini: "një ishull i vogël njerëzish me zakonet e tyre të lashta, që hanin bukën e thekrës, pinin qumështin e dhive, këndonin luginave baladat e të parëve të tyre", por pas humbjes së Piaçentinit më 1920-tën, humbja e shtatorit 1943 do të ishte akoma më e hidhur për ushtrinë italiane. Më 7 prill italianët deklarorin 12 të vvarë, ndërkohë që historiografia jonë në pesë dekada fliste për rreth 200 italianë të vvarë e të plagosur në Durrës dhe 700 në të gjithë Shqipërinë (që nuk është e dokumentuar). Nga ana tjetër edhe numri i shqiptarëve të vvarë në ditën e parë të luftës ndoshta ka qenë edhe më i madh. Në fakt që të katërt "brezat e mbrojtjes" në mënyrë sektoriale nga Shkumbini në Milot nga nënkolonel Shaban Bega, nga Miloti në Shkodër nga nënkolonel Kyçik Ullugaj (oficer biellogardist), nga Shkumbini deri në brigjet e Vjosës nënkolonel Faik Guku, nga Lumi Vjosa deri në Sarandë kolonel Ali Riza Topalli dhe me përqëndrim vetëm në Durrës nga Major Abaz Kupi (komandant i xhandarmërisë në Durrës) dështuan në të gjithë frontet. Ndërkohë që "Historia e popullit shqiptar" botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, shkruhet që: "zbarkimi fashist filloi në orën 4:30 të mëngjesit dhe vetëm mbas orës nëntë të mëngjesit italianët hynë në Durrës. Qëndresat e paorganizuar në Rrashbull, tek Shkëmbi i Kavajës, pa folur saktësisht me shifrat e të vvarëve dhe të të plagosurve në ditën e parë të pushtimit. Nga ana tjetër në Shëngjin, luftëtarët shqiptarë thyen dy përpjekje për të zbarkuar. Po ashtu dhe gjatë rrugës për në Lezhë, në Bushat, Barbullush, Bërdicë dhe Beltojë e në hyrje të qytetit të Shkodrës, pushtuesit ndeshën në një qëndresë sikurse edhe në Koplik. "Në Vlorë u vra një komandant kompanie dhe

një ushtar si dhe disa të plagosur. Rezistencë pati edhe në Panaja dhe Bestrovë...", por në fakt i dokumentuar është dëshmori Hamit Veshko. Fakt është se në ditën e parë të pushtimit brigjet shqiptare u lanë me gjakun e bijve patriotë të Shqipërisë. Rezistencë fashizmi deri në këtë kohë kishte ndeshur vetëm në Abisini, Spanjë dhe Shqipëri. Për sfidën e parë të rezistencës në Evropë ndaj nazifashizmit që bënë këta bij, shkruan edhe faqet e shtypit demokratik në Angli e gjetke. Ato paralajmëruan popujt e botës për tragjedinë në afrim që i priste dhe treguan se si luftohet mënyra fashiste. Të rënë e 7 prillit 1939 janë: Mujo Ulqinaku, Hamit Dollani, Haxhi Tabaku, Hysen Koçi, Isak Metalia, Ramazan Velia, Ismail Reçi, Ibrahim Osmani, si dhe dëshmorët Hamit Veshko, Mitro Dhimërtika, Zenel Bllana, Tonç Toma dhe Izet Hysen Shahu. Nga dëshmorët e ditës së parë të luftës në tekstet e historisë së Shqipërisë përmendj Mujo Ulqinaku, të cilit iu dha titulli i dëshmorit dhe heroit dhe ju ndërtua një monument pranë portit të Durrësit, por shtatë dëshmorët e tjerë ngelën anonimë duke i renditur tek "e të tjerë". Në bazë të dokumenteve brenda datës 10 prill, gjithçka mbaroi. Në çdo qytet shqiptar, në çdo qendër administrative, mbi rrënojat në tym, u shfaq flamuri italian tricolor, si "ngadhënjim lavdie". Skenat që fëmijët të qajnë mbi kufomat e nënave të mbuluar në gjak, duke vretur gjithë urrejtje "ushtarë trimosha", me pendë me ngjyra majë kapeleve, ishin në fakt skena tronditëse. Era e tymit të barotit të 101 të shtënave me topa në Tiranë më 5 prill, që lajmëronin ardhjen në jetë të princit trashëgimtar, paskishin qenë "sinjali" i largimit të "udhëheqjes", që la mbrapa gjëmimin e topave të Duçës që ofronin për shqiptarët, "jetë të lumtur", që kishin "çliruar popullin shqiptar nga zgjedha e një mbreti anadollak shtypës dhe despot". Në Durrës dhe në të gjithë Shqipërinë, pati jo vetëm rezistencë por edhe gjak shqiptarësh, që është e njohur dhe e vërtetë, sepse e vërteta dhe e drejta shkëlqen si meteor lirie të ardhmen, prandaj dëshmorët janë me vlerë të njëlojtë dhe të barabartë në panteonin kombëtar.

Pushtimi, Diplomacia e mekur dhe reagimi mediatik

Durrësi me luftën e bijëve të Shqipërisë hyri në analet e historisë si vendi i parë në Evropë, i cili luftoi dhemb për dhemb me pushtuesit fashistë dhe që i dha edhe Evropës dëshmorët e parë të kësaj lufte. Urdhëri i pushtimit të Shqipërisë ishte lëshuar që më 31.3.1939 për trup ekspeditiv fashiste të kryesuar nga Gjeneral Alfredo Guzzoni. Për fazën e parë të pushtimit, ai kishte një divizion këmbësorie, katër regjimente bersalierësh, tri batalione të mekanizuara, të mbështetura nga pesë batalione këmbësorie me artilerinë dhe repartet e shërbimit. Trupat mbështetëse ishin baraz me një divizion. Në mbështetje të sulmit që skuadra ajrore A, e përbërë nga tre divizione ajrore të cilat i komandonte gjeneral Prikolo. Një divizion me 4 regjimente aerotransportuese, një divizion me tre regjimente aeroplanësh bombardues, një regjiment bombarduesish tokësorë dhe një regjiment gjuajtësish të shoqëruar nga hidrovalantë e aeroplanë të tjerë plotësues. Diplomatikisht fqinjët ishin dakord me pushtimin. Edhe të mëdhenjtë e planetit ishin të përgjumur. Ambasadori gjerman në Romë, Makenzen, i ka lënë të kuptojë Musolinit se "Gjermania është e gatshme të njohë çdo veprim ushtarak të Italisë ndaj Shqipërisë", bisedë kjo e zhvilluar më 17.3.1939. Nismës diplomatike të fashistëve italianë për pushtimin e Shqipërisë u është përgjigjur pozitivisht edhe diplomacia e mbretërisë së Beogradit. Ambasadori italian në Beograd më 5 prill kishte zhvilluar një bisedë me ministrin e jashtëm të mbretërisë Jugosllave, ku "Jugosllavia mbështeste interesat italiane në Shqipëri dhe se italianët do të dërgonin kontigjente të mëdha trupash në afërsi të kufirit shqiptaro-jugosllav. Fuqitë e tjera të botës ishin një zë i shuar në errësirën e luftës që po afronte.

Sipas Bernd Fischer, kryekëshilltari i ministrit fashist G. Ciano, Filippo Anfuso, ka deklaruar: "Sikur shqiptarët të kishin pasur një brigadë të armatosur mirë, do të na kishin hedhur në Adriatik". Nga ana tjetër 1939-a ishte vit i zhvillimeve politike e diplomatike të vullshme ballkanike dhe europiane. Në planin diplomatik Britania e Madhe si fuqi botërore dhe diplomatike, ka udhëhequr sipas parimit të shumëcituar nga Çerçilli: "Nuk ekzistojnë miqtë tanë të përhershëm, as armiqtë

tanë të përhershëm; ekzistojnë vetëm interesat tona të përhershme". Dhe Shqipëria ishte periferike për nga interesat. Nëse analizojmë detajet e pragpushtimit dhe pushtimit të Shqipërisë, plani ishte miratuar më 8. 1. 1939 nga kryetari i Qeverisë fashiste, Benito Musolini. Ndërkohë që Adolf Hitleri e kishte miratuar pushtimin nga ana e Musolinit, që ta hidhte një këmbë në Ballkan. Planin ishte përgatitur nën drejtimin e Çianos për pushtimin ushtarak të Shqipërisë. Ahmet Zogu mori disa masa kundër planeve italiane. Ambasadori italian në Tiranë protestoi për këto masa, ndërkohë, në Italinë e Jugut u përqendruan forcat ushtarke që do të realizonin pushtimin. Më 25 mars 1939 Ahmet Zogu iu paraqiti një projekt traktat nga qeveria italiane që synonte nënshkrimin e Shqipërisë, por mbreti i kohës e la në heshtje, por plani u përsërit më 2 prill, si ultimatum deri më orën 12, të datës 6 prill. Më 5 prill 1939 Qeveria Shqiptare i paraqiti ministrit italian në Tiranë opsionet kundër pushtimit, ku u kërkua që të përfundohej një konventë ushtarake përfshi edhe rastet dhe rrethanat se kur ushtria italiane mund të vendosej në tokën Shqiptare. Një ditë më pas më 6 prill mbasdite, parlamenti shqiptar e hodhi poshtë ultimatumin e Musolinit, dhe populli shpërtheu në demonstrata dhe i kërkoi qeverisë të organizonte qëndresën, shkuan përpara pallatit mbretëror në Tiranë për të kërkuar armë. Data 6 Prill 1939 ishte e "kopsitur" sipas italianëve, sepse Musolini i dërgon një mesazh personal Mbretit Zog ku i bente të ditur se ultimatumit skadonte në mesditën e po asaj date. Nga ana tjetër të gatsëm ishin edhe kosovarët për t'ju përbashkuar mbrojtjes së Shqipërisë, por qeveria jugosllave iu kundërvu me mbylljen e kufijve të mbretërisë së saj. Mbreti shqiptar kishte bërë të ditur se, "do të vishte opingat për të luftuar në mal", por në fakt mbathi opingat e modës italiane dhe së bashku me familjen e qeverinë e tij e la atdheun në mëshirë të fatit, që të bëhej vendi i parë që pushtohej në Europë. Ditën e pushtimit të vendit më 7 prill 1939 mbreti i shqiptarëve ndoqi planin e Pandeli Evangjelit, për të organizuar një qëndresë jashtë Shqipërisë, edhe pse të gjithë intelektualët dhe shtresat e shoqërisë shqiptare nuk ishin të një mendje. Ka ngelur proverbiale, fjalimi i Mehdi Frashërit në radio "Tirana" në disa gjuhë të botës, fjalim që denoncoi propagandën fashiste që synonte ta pasqyronte pushtimin si "një dëshirë e vet shqiptarëve!". Interesat strategjike të italianëve ishin të njohura: shfrytëzimi i pasurive natyrore të lakmueshme dhe pozita strategjike, kyçe mes lindjes dhe perëndimit, prandaj edhe pushtimi i Shqipërisë ishte një ndër aktet e para agresive fashiste në gjithë botën. Asambleja e 12 Prillit 1939 dhe çdo masë tjetër ishte një format i përligjes së pushtimit 4 vjeçar e 5 muaj (7. 4. 1939 deri më 8. 9. 1943). Në këto situata rreth 1000 atdhetarë shqiptarë e "kishin vendin" në burgjet dhe në ishujt e Italisë. Kishte filluar konfigurimi i hartës gjeopolitike që fuqitë e boshtit dëshironin t'i jepnin botës, prandaj edhe pushtimi i vendit tonë nuk solli kundërshtime të ashpra diplomatike. Kryeministri anglez, Chamberlen (Çembërleri), u shpreh në Dhomën e Komunave se "Anglia nuk kishte interesa në Shqipëri" dhe shkoi ta kalonte fundjavën në Skoci. Fuqitë e tjera të mëdha e njohën pushtimin fashist, me përjashtim të SHBA-së, Turqisë dhe Egjiptit, shtete që vazhduan të mbajnë hapur ambasadat e vjetra të shtetit shqiptar dhe nuk e njohën shtetin e ri kuizling shqiptar, të përfaqësuar nga mëkëmbësi i mbretit të Italisë, Jakomoni, dhe kryeministri shqiptar. Në këto situata shtypi i huaj për qëndresën shqiptare dhe rezistencën antifashiste ishte vetëm disa zëra në të shuar si gazeta franceze "La Croix", që shkroi: "Stërnipërit e Skënderbeut zbrapsin trimërisht pushtuesin dhe deri tani kanë ndaluar çdo zbakim..., shqiptarët i treguan gjithë botës se si e mbrojnë lirinë e tyre".

Gazeta "Pravda" e Moskës dënonte sulmin prej banditi të Italisë fashiste kundër Shqipërisë, si prologu i "zgjerimit të agresionit fashist në Ballkan". Ngjarjet patën jehonë edhe Algjeri, Siri, Liban, Francë, ku qarqe përparimtare e krahasonin pushtimin e Musolinit në Shqipëri me pushtimet e Adolf Hitlerit. Vatikani përkrahu sulmin dhe kur ushtria italiane shkeli tokën shqiptare, Papa Piu XII, i "bekoi" për misionin e tyre "çlirimtar". Papa drejtoi lutje "për paqen", "për mbrojtjen e katolicizmit", lutje që ja drejtonte zotit, por pa dënuar agresorët. Fuqitë e mëdha e sakrifkuan Shqipërinë në prag të LIIB, mbyllën sytë përpara bishës

fashiste shtypjes së demokracisë së qytetërimit evropian, që ishte një njollë e zezë dhe një turp për "europianët e civilizuar". Gazeta angleze "The Daily Telegraph": "Shqipëria foli me një gjuhë të cilën Evropa e kishte humbur zakonin ta dëgjonte. Shqiptarët refuzojnë të nënshtrohen dhe vazhdojnë luftën...". Francezi Hubert Bouchet: "E pashë të vdesë Shqipërinë", por gjaku i dëshmorëve dhe lufta e madhe antifashiste në fakt nuk e la vendin të vdiste në rrobëri por triumfoi në liri. Edhe pse pushtimi "u pranua", gjaku u derdh nga atdhetarët dhe idealistët që Shqipërinë e donin me zemër. Hamit Selman Veshko, 22 vjeçar nga Gumenica e Vlorës, do lëshonte kushtrimin: "Kush e do Atdheun, të vijë në Vlorë, se po del Italia!", për të mbetur lapidar nderi i përjetshëm; ndërsa Mitro Dhimërtika 24 vjeçar nga Nivica që ra në Sarandë, me amanetin për brezat: "Mua mos më qani; unë bëra detyrën si atdhetar!". Kështu ranë edhe shumë shqiptarë të tjerë në gjithë brigjet e Shqipërisë dhe në thellësi të tokës mëmë sikurse ishte Izet Hysen Shahu, që shpalloi vullshëm temperamentin e shqiptarit në ato ditë prilli të 1939, që me gjakun e tij, palosi katër armiq dhe mbeti dëshmor i besës dhe qëndresës shqiptare në Ersekën e lavdisë dhe mençurisë shqiptare. Edhe "pensionit patriotik" i qeverisë shqiptare nën pushtimin gjerman ishte tymnajë "përkujdesjeje", për të justifikuar "atdhedashurinë" e qeveritarëve shqiptarë nën pushtim, por që u nxorri mjaft probleme familjeve të dëshmorëve të 7 prillit, menjëherë pas çlirimit, për "shpërblimin e pensionit patriotik" të marrë prej kusilingëve dhe gjermanëve. Në vijim po ndalemi në biografitë e dy prej dëshmorëve të parë të ditës së parë të pushtimit dhe të luftës antifashiste:

Nënoficeri nga Ulqini që shkroi epope trimërie e qëndrese!

Mujo Ulqinaku ishte njëri ndër luftëtarët e parë më të shquar, i cili më 7 prill 1939 organizoi qëndresë të armatosur kundër pushtimit fashist italian. Kush ishte Mujo Ulqinaku? Ai ishte lindur më 1896 në Ulqin në familjen e një detari të varfër, por me tradita atdhetare. Që në moshë të vogël hyri ishte ndihmës detar dhe më vonë punoi si detar në Shkodër e në Durrës. Me gradën e nënoficerit në një nënrepart të marinës në Durrës, ditën e agresionit fashist italian kundër Shqipërisë u vu menjëherë në krye të detarëve të braktisur nga oficerët tradhtarë dhe organizoi me ta e me vullnetarë të tjerë qëndresën e armatosur në portin e Durrësit. Mujo Ulqinaku luftoi me trimëri e guxim të rrallë, duke vrarë e plagosur dhjetëra fashistë. Ra në luftim të pabarabartë në mbrojtje të atdheut, më 7 prill 1939 duke u bërë shembull i lartë patriotizmi e atdhedashurie. Në mëngjesin e 7 prillit, ushtria fashiste italiane, me rreth pesëdhjetëmijë ushtarë sulmoi vendin tonë, duke zbarkuar në Durrës, Vlorë, Shëngjin dhe Sarandë. Në Durrës, ushtria e vogël shqiptare e drejtuar nga kapteri i marinës Mujo Ulqinaku i bëri qëndresë pushtuesit. Ushtarët italianë zbarkuan në bregun e Durrësit, por u detyruan të zbrapseshin në det mbasi në breg i pritit mitrolozi i Mujo Ulqinakut që mbronte trojet e veta. Ushtarët italianë zbarkuan disa herë në breg dhe po aq herë edhe u zbrapsën. Por ushtria italiane ishte e shumtë në numër dhe Mujo nuk mund t'i bënte ballë për shumë kohë veçse sa që gjallë, ata nuk kaluan dot. Në këtë mbrojtje të truallit të vet Mujo Ulqinaku ra heroikisht dhe u bë kështu dëshmor i parë i atdheut në luftë kundër pushtuesit fashist. Burimet e kohës bëjnë të ditur se qytetarët e Durrësit thonin se italianët kishin lënë disa dhjetëra vetë edhe pse në dekada flitej se pati një numër të konsiderueshëm me të vrarë. Italianët deklarojnë se kishin vetëm dymbëdhjetë të vrarë (nuk ishte hera e parë e lojës me shifrat që bëjnë ushtritë ndërluftuese). Sikurse numri i shqiptarëve të vrarë ka qënë mbase më i madh. Në portin e Vlorës nuk pati ndonjë qëndresë të madhe, por trupat motoçikliste italiane ranë në pritë në rrugën jashtë qytetit, ku pësuan humbje në njerëz. Zbakimi në Shëngjin u kundërshtua nga një grup jo më shumë se dyzetë vetësh, gjatë luftimeve dhe pati disa të vrarë. Rruga për në kryeqytetin e Shqipërisë ishte e lirë në gjithë drejtimet. Rezistenca popullore antifashiste, e 7 prillit, e braktisur nga mbreti, ngeli spontane dhe në ditën e parë të luftës dhanë jetën duke luftuar në atë ditë historike për kombin, Mujo Ulqinaku dhe shtatë dëshmorë të tjerë.

Akti heroik i tij është tashmë i dokumentuar dhe memorizuar në kujtesën e kombit shqiptar. Fjalët e tij janë burim atdashedurie: "Tradhtia e ka mbuluar vendin tonë! Ne na takon të luftojmë për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë... të betohemi vëllezër, se s'do të kursejmë as gjakun, as jetën tonë për mbrojtjen, e Atdheut!". Mbrojtjen e truallit arbëror në portën e parë të Adriatikut e skuqën me gjakun e dëshmorëve që shkruan "liri" në flamurin e kombit. Në kuadrin e 25 vjetorit të çlirimit të Atdheut, më 1969, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH me dekret nr.4600 datë 22.11.1969, i dha Mujo Ulqinakut titullin e lartë "Hero i Popullit". Me vendim nr. 1749, datë 9.9.1946, të ish-Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit Durrës, Mujo Ulqinaku është shpallur "Dëshmor i Atdheut", me motivacionin: "Duke luftuar me armë në dorë deri sa dha jetën për mbrojtjen e truallit shqiptar kundër pushtimit fashist Italian, më datën 7 prill 1939". Me vendim nr. 15, datë 31.10.2003 Komisioni Qendror i Statusit "Dëshmor i Atdheut", i ka njohur Mujo Ulqinakut statusin "Dëshmor i Atdheut". Në kuadrin e 70-vjetorit të çlirimit të Atdheut Presidenti i Republikës me dekretin nr. 8826, datë 28 nëntor 2014 i ka akorduar "Medalja e Artë e Shqiponjës"; ndërsa me rastin e 75 vjetorit të çlirimit të Atdheut Presidenti i Republikës me dekretin nr. 11366, datë 24.11.2019 ka dekoruar Mujo Ulqinakun me "Dekoratën e Flamurit Kombëtar", me motivacionin "Për heroizmin, trimërinë dhe sakrificën më sublime në mbrojtje të sovranitetit territorial të atdheut, lirisë dhe pavarësisë së Shqipërisë, si shembull monumental i patriotizmit dhe atdheadashurisë, si simbol i mbrojtjes së dinjitetit kombëtar, si model i ushtarakut që i qëndron deri në fund betimit para Flamurit Kombëtar". Aktit heroik të Mujo Ulqinakut (emri "Mujo" rrjedh nga emri qëndror i Eposit Shqiptar të Kreshnikëve) i kushtohet busti i vendosur pranë kullës së kalasë së Durrësit, emrin e tij e mbajnë rrugë, anije, shkolla etj. Emrin e tij e mbajnë një shkollë në Durrës, një rrugë në Tiranë, një në Fier; që prej vitit 2005 me vendimin e Kuvendit Komunal një rrugë në Ulqin mbart emrin e tij dhe një rrugë në Prishtinë. Në vitin 1979 Kinostudjua "Shqipëria e Re" i kushtoi një dokumentar "Lufton Mujo Ulqinaku", që i kushtohet mbrojtjes së Durrësit.



Dëshmori gramshiot Hamit Dollani në barikadën e parë të luftës antifashiste

Djemtë e Gramshit kanë qenë të pranishëm në të gjitha ngjarjet madhore të kombit, në të gjitha luftrat për mbrojtjen e truallit, lirisë dhe pavarësisë. Një ndër djemtë që ka hyrë në histori si pjesë e dëshmorëve të ditës së parë të pushtimit është edhe Hamit Liko Dollani, që në fakt është ndër të parët dëshmorë të Luftës së Dytë Botërore në Europë. Ai ka rënë para 82 vjetësh dhe është dëshmor i qëndresës së madhe antifashiste të 7 prillit 1939. Ai ishte lindur më 1903 në fshatin Jançë, në Sulovë të Gramshit. Fëmijërinë e kaloi në varfëri të madhe, por në një familje patriotike. Kur ishte 9 vjeç, në vitin e pavarësisë më 1912-ën, nëna e tij ndërroi jetë, ndërsa kur u bë 14 vjeç, bashkë me babain Likon, endej si argat nëpër dyert e familjeve të pasura për të siguruar bukën për familjen e tij. Kur mbushi 17 vjeç kërkoi të gjente punë krahu si punëtor. Me anë të një miku të familjes punësohet në furrat e gëlqeres afër qytetit të Korçës. Pas 3 vitesh aty u bë njeriu më i dashur për shokët dhe me ato pak të holla që siguronte mbante të atin dhe vëllezërit e tij më të vegjël. Kjo i shtoi respektin tek fisi e bashkëfshatarët. Në 1923 do të gjendej ushtar. Tashmë 20 vjeçar ishte rritur, forcuar dhe burrëruar më shumë. Në 1924 me garnizonin e Shkodrës dhe shokët e tij marrshojnë drejt Tiranës për mbrojtjen e Revolucionit Demokratik të Qershorit në përkrahje të Fan Nolit. Pas kthimit nga ushtria do ta gjejnë përsëri në Korçë në shoqëri të ndryshme punëtoresh. Në 1928 e marrin përsëri në ushtri si rezervist në një kurs në qytetin e Vlorës ku njihet e bëhet shok me Mujo Ulqinakun. Pas kësaj më 1931 e pranojnë si xhandar në armën e xhandarmërisë. Më vonë

Hamiti do të njëjhej me patriotë, nacionalistë e demokratë të shquar, si Riza Cerova etj. dhe shpesh do të gjenden dhe do të ecin në një rrugë të përbashkët. Në Tiranë do ta gjejnë në një nga grupet antizogiste të Lëvizjes së Fierit 1935 që veprome aty për hapjen e burgjeve, por me gjithë dyshimet kjo nuk u vërtetua. Më vonë transferohet në një postë të xhandarmërisë në Bërzhitë të Tiranës ku dhe këtu nuk i ndërpreu lidhjet me shokët, veçanërisht me Mujo Ulqinakun. Në fillim të 1939, Hamiti do të sjellë nëntë armë në familje në fshatin e vet, për armatosjen e një skuadre. Ai e ndjente rrezikun e pushtimit fashist dhe përgatitej për rezistencën. Veprimet atdhetare të Hamitit dhe të patriotëve të tjerë gramshiotë bënë që populli i këtij rrethi në ditët e para të prillit të grumbullohej në fshatra e komuna pranë postave të xhandarmërisë dhe në qendër të nënprefekturës për të protestuar fuqishëm ndaj asaj që po përgatitej kllika zogiste me fashistët italianë. Nga Bërzhitë ku shërbente u nis me një mitraloz në krahë dhe municionet e nevojshme për të zënë pozicionin e tij në Durrës atë prill 1939, ku Hamiti aty do të takonte përsëri shokun e tij Mujo Ulqinakun. Kur heshti mitralozi i Hamit Dollanit, Mujo e kuptoi rënien e shokut, por pas pak heshtën dhe armët e tij. Krahas Hamitit në Durrës atë ditë të pushtimit luftuan dhe djem të tjerë gramshiotë, si Hysen Bengasi nga Prrenjasi dhe Selman Dylli nga Lubinja. Hamiti tashmë është pjesë e nëntë dëshmorëve të ditës së parë të luftës në Europë në Luftën e Dytë Botërore. Bashkia e Durrësit dhe e Gramshit e kanë shpallur "Qytetar Nderi" dhe mban titullin me motivacionin "Për patriotizmin dhe sakrificën sublime në qëndresën antifashiste të 7 prillit 1939", mban dhe titullin

"Mirënjohja e qytetit" nga Bashkia dhe Shoqata "Durrësi", por dhe unaza e qytetit të Gramshit ka emrin "Hamit Dollani" dhe sigurisht që meriton edhe një bust. Dhe Komuna Tunjë e ka shpallur "Nderi i Komunës", në fshatin Katërlis është vendosur pllaka përkujtimore në nderim të tij si dhe është dekoruar me medaljen e Trimërisë. Në kuadrin e 75 vjetorit të çlirimit të Atdheut është nderuar me "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" një figurë emblematike dhe të shquar të rezistencës Antifashiste shqiptare, që jeton në memorien tonë kolektive si histori e sakrificave sublime të dëshmorëve tanë. Motivacioni për "Dekoratën e Artë të Shqiponjës", është sinjifikativ: "Për veprimtarinë e tij patriotike dhe trimërinë e treguar gjatë luftës kundër pushtuesve fashistë, si luftëtar i orëve të para, duke sakrifikuar edhe jetën për lirinë e vendit". Hamit Dollani është pjesë e ndërgjegjes së kombit, sepse ra ndër të parët në llogoren e parë të luftës, prandaj edhe populli e përjetësoi në këngë: "Re dëshmor i orës së parë/O Hamit, o legjendar! /Të nderon Sulova trime/Që të rriti me thërrime". Hamit Dollani është shpallur me titullin e lartë "Dëshmor i Atdheut" me vendim nr. 36 datë 9.5.1974. Shqiptarët dhe mbarë shqiptaria nderojnë dëshmorët e të gjitha kohërave, që meritojnë përkujtim e nderim pa dallim kohe, besimi, krahine, ideje, sikurse janë ata që derdhën gjakun të parët për mbrojtjen e truallit shqiptar, që në ditën e parë të luftës. Djemtë që ranë në Durrës nuk ishin viktima të pushtuesit, por vetë ndërgjegjia e kombit shqiptar ashtu sikurse ishte Lufta Nacionalçlirimtare një legjendë e gjallë në çdo fshat, lagje, rrugë, qytet, ku ka lënë fuqishëm gjurmën e saj të gjakut dhe të trimërisë. Ishin luftëtarët e saj e në radhë të parë ata që e pritën me puskhë armikun që në breg të detit, që e bënë luftën të shenjtë dhe heroike të popullit tone, që e bënë luftën të përjetëshme në memorie të kombit me gjakun e derdhur. Është detyrë dhe detyrim i çdo shqiptari që në çdo vënd që të kalojë, të thotë: "Këtu është luftuar fuqishëm për truallin shqiptar nga antifashistët shqiptarë! Këtu është derdhur gjak për lirinë e Shqipërisë!". Sakrificat e mëdha të shqiptarëve për të fituar lirinë mbeten një ideal i pavdekshëm dhe i trashëgueshëm sepse kështu mbrohet gjakun i dëshmorëve të shtatë prillit dhe qindra të tjerëve që jetën e falën për Atdheun, për Shqipërinë.



Forcat e Armatosura në ndihmë të banorëve në zonat e përmbytura

